

SKEMAT E VLERESIMIT

PROVIMET ME ZGJEDHJE, PERGJIGJET E SAKTA PER TE GJITHA TEZAT

MAS: Do marrin pikë edhe përgjigjet e përafërta.
Skema është orientuese për maturantët

▶ FAQE 16-18



HETIMET

VRASJA E TAN CUKUT, NE KERKIM 2 PERSONA QE PAGUAN EKZEKUTIMIN

Policia dhe prokuroria janë në ndjekje të financuesve, dyshohen se janë nga Fieri e Vlora

▶ FAQE 10

[SHQIPTARJA.com]

Lexoni
Dëgjoni
Shikoni
EDICIONI MULTIMEDIAL



Kjo gazetë përdor
teknologjinë
QR-CODE

ÇMIMI 30 LEKË

VITI VII - NR.146

E SHTUNË, 24-06-2017

www.shqiptarja.com

MBYLLLET FUSHATA JA GABIMET QE U ÇOJNE NE BURG DITEN E ZGJEDHJEVE

Nis sot heshtja zgjedhore, të gjitha pakujdesitë që përbëjnë vepër penale, nga fotografimi i votës tek përdorimi i celularit. Frikë nga shitja e komisionerëve, partitë nuk dorëzojnë emrat, KQZ jep alarmin



**EDI RAMA: EDHE DETI
TE BEHET KOS, LSI NUK VJEN
ME NE PUSHTET**




**BASHA: REPUBLIKA E RE,
NJE PAKT TE RI MES POLITIKES
DHE QYTETAREVE**



**ILIR META: MAVIA
DO TE IKI, EDI RAMA I THOTE
PD-së "ME SHPETO"**

▶ FAQE 2-9



HISTORIA

Kalaja e Micojtit ose Qytetja e re e Dukagjinit

Historia e veçantë, u ndërtua nga turqit rreth vitit 1547 për të ruajtur rrugën e Shkodrës

▶ FAQE 20-21



DENIMI PER TRUKIMET Skënderbeut i hiqet titulli, gjobë dhe zbritje pikësh

Korçarët: Do ta ankimojmë në CAS. Titulli kampion i sezonit të kaluar i kalon Partizanit

▶ FAQE 19

Frikë nga shitja e komisionerëve, partitë nuk dorëzojnë emrat

6 qarqet problematike ku nxehen partitë: Shkodër, Lezhë, Fier, Korçë, Durrës dhe Elbasan

ESIONA KONOMI
TIRANE

Një ditë përpara zgjedhjeve, partitë politike nuk ka plotësuar vendet e tyre në qendrat e votimit me komisionerë, duke rrezikuar që të bllokojnë nisjen normale të votimit ditën e nesërme. Pas alarmit disa ditë më parë, Shqiptarja.com u interesua pranë përfaqësuesve politikë të disa KZAZ-ve në gjashtë qarqet më të nxehta ku mungojnë komisionerët dhe mësoi se, partitë, nga frika se mos komisionerët do të shiten apo blihen nga kundërshtarët politikë, emrat do të mbahen surprizë deri ditën e fundit. Të njëjtat burime bëjnë me dije, si në opozitë ashtu edhe në mazhorancë, se përfaqësuesit e partive do të ndryshojnë edhe në ato zona ku janë emëruar tashmë. Kodi Zgjedhor nuk ka ndonjë pengesë për moslejimin e zëvendësimit të komisionerëve, duke ju lënë dorë të lirë partive të ndryshojnë emrat në çdo moment, të sjellin individë të patrajtuar, e mbi të gjitha të ndikojnë si të duan procesin zgjedhor, të cilin edhe mund ta ngadalësojnë përmes të tilla manovrave. LSI dhe PDIU thuhet janë të përfaqësuar në të gjithë vendin, teksa në Fier, Elbasan, Durrës, Korçë, Lezhë dhe Shkodër, që "përleshja" elektorale është më e fortë, edhe PS dhe PD nuk kanë depozituar emra. Thuhet në të gjitha KZAZ-të problematike, është e dukshme mungesa e komisionerëve nga ana e Partisë Republikane. Edhe në zgjedhjet e vitit 2015, Partia Republikane, në mungesë të njerëzve në të gjithë Shqipërinë u bë arsye që votimi të fillonte me vonesë në disa zona. Edhe dje, KQZ ka ngritur alarmin për këtë situatë, përmes një deklarate të zëdhënësës së KQZ-së, Drilona Hoxhaj. "Në zbatim të nenin 100 të Kodit Zgjedhor, nesër, ditën e shtunë, fillon shpërndarja e materialeve zgjedhore nga KZAZ-të drejt Qendrave të Votimit, procesi

ZONAT KU MUNGOJNË KOMISIONERËT	
QARKU SHKODËR	
KZAZ 2	Mungojnë emrat e PS, PD dhe PR
KZAZ 3	Mungojnë emrat e PR
KZAZ 4	Mungojnë emrat e PD dhe PS
KZAZ 5	Mungojnë emrat e PD, PS dhe PR
QARKU LEZHË	
KZAZ 12	Mungojnë emrat e PR
KZAZ 13	Mungojnë emrat e PR
QARKU ELBASAN	
KZAZ 47-48-50	Mungojnë emrat e PD, LSI, PS dhe PR
KZAZ 49	Mungojnë emrat e PD
QARKU DURRËS	
KZAZ 21	Mungojnë emrat e PD, LSI, PS dhe PR
KZAZ 22, 23, 24	Mungojnë emrat e PR
QARKU FIER	
KZAZ 56	Mungojnë emrat e PD, PR,
QARKU KORÇË	
KZAZ 67	Mungojnë emrat e PD, PS, PR

i cili duhet të përmbyllet 15 orë para hapjes së votimit. Ky proces i rëndësishëm po vihet në rrezik partitë politike të cilat nuk po depozitojnë propozimet për komisionerët e qendrave të votimit. Edhe pse jemi në

limitet e fundit kohore për të bërë emërimet e komisionerëve të qendrave të votimit, nga informacioni i përditësuar rezultojnë se 16 KZAZ nuk kanë përmbyllur emërimet e anëtarëve të KQV-ve", -tha

Drilona Hoxhaj, zëdhënëse e KQZ-së. Konkretisht: në qarkun Shkodër, nuk kanë emëruar anëtarët e KQV-ve në KZAZ numër 2 PS, PD, PR. Në KZAZ PR nuk ka dorëzuar listën emërore me dokumentacionin shoqëruar për komisionerët. Në KZAZ 4 mungojnë emrat e PD dhe PS. Në KZAZ 5 PD, PS, PR nuk kanë dorëzuar listën emërore me dokumentacionin shoqëruar për komisionerët. Në Qarkun Lezhë, nuk ka emëruar anëtarët e KQV-ve në KZAZ 12 dhe 13 Partia Republikane. Në Qarkun Elbasan, në KZAZ 47-48-50- PD, LSI, PS, PR nuk kanë dorëzuar listën emërore me dokumentacionin shoqëruar për komisionerët, ndërsa në KZAZ 49 mungojnë komisionerët e PD. Në qarkun Durrës, KZAZ 21 mungojnë përfaqësuesit e PD, LSI, PS, PR, ndërsa në KZAZ 22, 23, 24 PR nuk ka dorëzuar listën emërore me dokumentacionin shoqëruar për komisionerët. Në qarkun Fier, pranë KZAZ 56 mungojnë emrat e PD dhe PR. Qarku Korçë ka probleme vetëm në KZAZ 67, ku PD, PS, dhe PR nuk kanë dorëzuar listën emërore me dokumentacionin shoqëruar për komisionerët. Komisioni



Procesi

330 vëzhgues të huaj monitorojnë nesër zgjedhjet parlamentare

Vetëm një ditë pas mbajtjes së zgjedhjeve parlamentare në Shqipëri, vëzhguesit ndërkombëtarë dhe OSBE/ODIHR që monitorojnë procesin zgjedhor do të dalin në një konferencë për shtyp ditë e hënë në datën 26 qershor. Misioni ndërkombëtar i vëzhgimit të zgjedhjeve përbëhet nga 330 vëzhgues nga 43 vende, duke përfshirë 255 vëzhgues afatgjatë dhe afatshkurtër të vendosur nga OSBE/ODIHR-i, 36 parlamentarë dhe punonjës nga Asambleja e OSBE-së, 25 nga APKE dhe 11 nga PE-ja. "Deklarata do të paraqitet nga Roberto Battelli, Koordinator i Posaçëm dhe udhëheqës i misionit të vëzhguesve afatshkurtër të OSBE-së, pasuar nga Paolo Corsini, Kreu i delegacionit të APKE, Marietta Tidei, Kreu i delegacionit të Asamblesë së OSBE-së, Eduard Kukan, Kreu i Delegacionit të PE-së dhe Ambasadori Peter Tejler, Kreu i Misionit të Vëzhgimit të Zgjedhjeve të OSBE/ODIHR-it", thuhet në njoftimin e OSBE/ODIHR. Mësohet se konferenca do të zhvillohet në orën 14:30 të së hënës.

Qendrori i Zgjedhjeve i kërkon partive politike që të mos bëhen pengesë për administrimin e procesit zgjedhor, dhe të

dorëzojnë urgjentisht listat emërore për komisionerë të QV-ve me dokumentacionin përkatës pranë KZAZ-ve.

Tritol zyrës së LSI-Durrës, Koka: Vepër e zagarëve të Rilindjes

PS: Keqardhje, por dyshojmë se LSI inskenoi vetë ngjarjen tek zyra elektorale

Dy ditë përpara votimit, është shënuar një incident elektorale në qytetin e Durrësit. Një zyrë elektorale e LSI është shpërthyer me tritol tek dera, pak pasi kishte përfunduar mitingun përmbyllës i kësaj partie në qytetin bregdetar. Në orët e para të mëngjesit,

Policia u njoftua se gjatë natës duke gdhirë e premtja, në lagjen Nr. 18 ka shpërthyer një sasi lënde plasëse, në pjesën hyrëse të zyrës elektorale të një subjekti politik. Menjëherë u ngrit grupi hetimor dhe u shkua në vendngjarje, ndërsa mësohet se zyra i përket partisë së LSI. Nga këqyrja e vendit të ngjarjes u evidentua se ishte vendosur një sasi e vogël lënde shpërthyes dhe për pasojë janë shkatëruar vetëm dëme materiale. Për veprime më të specializuara në lidhje me llojin dhe sasinë e lëndës plasëse po kryhen veprimet nga ekspertët anti-eksploziv. Paraprakisht dyshohet se lënda e përdorur

është tritol. Uniformat blu nën drejtimin e Prokurorisë së Rrethit po kryejnë të gjitha veprimet e duhura hetimore me qëllim identifikimin, kapjen e autorëve dhe zbardhjen e plotë të ngjarjes. Kryetari i LSI për qytetin e Durrësit, Lefter Koka u shpreh para zyrës elektorale të partisë të dëmtuar nga një shpërthim me eksploziv, se kjo është vepër e Policëve të Rilindjes. "Askush nuk mund të ndalë vullnetin e qytetarëve të ndershëm durrsakë! As Zagaret e Rilindjes! Kjo është vepër e policëve të Rilindjes", -tha Koka i cili shtoi me tej se: "Durrësi është shquar dhe unë gëzoj respekt maksimal për bashkëqytetarët e mi dhe për

socialistët e vërtetë. Këto veprime nuk janë as nga durrsakë, as qytetarë të Durrësit, por janë zagarë të Rilindjes". Në një reagim të saj, Partia Socialiste e Durrësit shpreh keqardhjen për deklaratat e LSI që akuzon PS-në mbi shpërthimin me eksploziv të një zyre elektorale në qytetin e Durrësit. Në një njoftim për shtyp, PS e Durrësit shpreh se, nxitimi për të akuzuar, më së shumti, ngre dyshimet për një ngjarje të inskenuar nga vetë LSI. "Në radhë të parë dënojmë ngjarjen e sotme dhe distancohemi nga ky akt i turpshëm vandal. Kërkojmë nga organet ligjzbatuese hetimin dhe zbardhjen sa më të shpejtë të ngjarjes, e cila nuk i shërben as-



Zyra e LSI ku shpërthue tritol

pak zhvillimit normal të procesit zgjedhor. Shprehim keqardhje që LSI ende pa u kryer asnjë hetim nga organet ligjzbatuese nxiton të akuzojë. Nxitimi për të akuzuar, më së shumti, ngre dyshimet për një ngjarje të inskenuar nga vet LSI me synim përdorjen e saj për qëllimet elektorale të ditës", -thuhet në deklaratë. Më tej, PS bën thirrje që organet përkatëse të zbardhin ngjarjen sa më parë, ndërsa shton se asnjë tentativa

për tensionim të situatës nuk do të fitojë terren në qytetin bregdetar. "Asnjë tentativë për tensionimin e situatës nuk do mund të dalë me sukses pasi fushata në tërësi ka qenë e qetë dhe pa probleme. Qytetarët e Durrësit e refuzojnë dhunën dhe tensionin pasi duan të shkojnë të qetë drejt kutive të votimit për të shprehur me votë vullnetin e tyre të lirë", -përfundon deklarata.



NË FOTO:
Mbledhje e
Komisionit
Qendror
Zgjedhjeve

ESIONA KONOMI
TIRANE

Partitë politike janë qysh prej orëve të para të mëngjesit të sotëm në heshtje zgjedhore, heshtje e cila do të mbarojë nesër, pasi të jenë mbyllur të gjitha qendrat e votimit. Gjatë ditës së sotme partive nuk ju lejohet të bëjnë fushatë, teksa nesër, shqiptarët do të vendosin për legjislaturën e 9-të parlamentare. Kësaj here shqiptarëve ju duhet të zgjedhin një nga 18 partitë e regjistruara në fletën e votimit, ku çdo parti garon me vete dhe jashtë koalicioneve. Në këto zgjedhje, për shkak të dinamikës politike dhe ngujimit të opozitës në çadër, nuk është regjistruar asnjë koalicion zgjedhor. Në bashkinë e Kavajës do të ketë zgjedhje dyfishe, pasi këta qytetarë do të zgjedhin edhe kryetarin e ri të bashkisë, pas shkarkimit të Elvis Roshit për shkak të ligjit të dekriminalizimit.



Detajet

KAVAJA

Në bashkinë e Kavajës do të ketë zgjedhje dyfishe, pasi këta qytetarë do të zgjedhin edhe kryetarin e ri të bashkisë, pas shkarkimit të Elvis Roshit për shkak të ligjit të dekriminalizimit.

VOTUESIT

Të drejtën e votës e kanë 3.452.308 shtetas. Ndër ta, 136.651 zgjedhës votojnë për herë të parë. 51 % e zgjedhësve janë meshkuj dhe 49 % femra. Në listën e përditësuar është ulur numri i shtetasve pa adresë të përcaktuar dhe i publikimeve.

mitingjeve ose i veprimtarive të tjera zgjedhore të subjekteve zgjedhore”, -thuhet në Kodin

Sot heshtje zgjedhore, Shqipëria vendos nesër për 4 vjet

Sot dhe nesër ndalohet fushata dhe propaganda nga partitë dhe kandidatët



Zgjedhor. Qendrat e votimit do të hapen në orën 7 të mëngjesit dhe do të mbyllën

në orën 19:00. “1. Kur data e zgjedhjeve caktohet ndërmjet 31 marsit dhe 15 tetorit,

qendrat e votimit hapen në orën 7:00 dhe mbyllën në orën 19:00. 3. Askush nuk mund të votojë pas orës së mbylljes së qendrave të votimit, me përjashtim të zgjedhësve që presin për të votuar në kohën e mbylljes, sipas procedurave të parashikuara në këtë Kod”, -thotë Kodi Zgjedhor. Të drejtën e votës e kanë 3.452.308 shtetas. Ndër ta, 136.651 zgjedhës votojnë për herë të parë. 51 % e zgjedhësve janë meshkuj dhe 49 % femra. Në listën e përditësuar është ulur numri i shtetasve pa adresë të përcaktuar, i publikimeve, e po ashtu edhe i votuesve mbi 100 vjeçarë. Nga lista e re janë hequr gjithashtu emrat e personave që vuajnë dënimin në burgje, sipas përcaktimeve të ligjit, në kuadër të ‘dekriminalizimit’. Sipas të dhënave, rreth 2000 të burgosur nuk do të votojnë për shkak të këtij ligji. Më shumë se 900 të dënuar me të drejtë vota nuk kanë mundësi të votojnë nesër, për shkak se dokumentet e tyre si ID apo pasaportat janë të grumbulluara dhe sekuestruara nga prokuroritë dhe gjykatat e pa to ata nuk mund të ushtrojnë të drejtën e votës. Pas interesimit zyrtar pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, konfirmohet kjo shifër e lartë teksa do të votojnë rreth 4 mijë të dënuar. Teksa kemi pyetur zyrën e zëvendëskryemistres që drejton task-forcën e monitorimit të problemeve zgjedhore bëhet me dije ky informacion zyrtar. “Nga Avokati i Popullit u ngrit shqetësimi për rreth 900 të dënuar që nuk kanë mundësi të votojnë për arsye se i kanë dokumentet e identifikimit nëpër komisarate apo prokurori, apo edhe për një pjesë të tyre që e kanë të pamundur pajisjen me karta identiteti pasi duke qenë se vuajnë dënimin nuk kanë të ardhura për të paguar tarifën për pajisjen me to. Për kategorinë e fundit të të dënuarve janë marrë masa për mbulimin e tarifës së aplikimit nga buxheti i shtetit, por raportim më i hollësishëm do të bëhet në mbledhjen e radhës së Task-Forcës”, -sqaron zonja Mandija. Në listën përfundimtare për zgjedhjet e 25 Qershorit 2017 janë 1.489 persona që kanë mbushur moshën 100 vjeç, të bllokuar në listën e zgjedhësve me metoda informatike.

Zgjedhjet

Ja procedura e votimit, gabimet që nuk duhet të bëjnë shqiptarët

Mos fotografoni votat, mos përdorini celularin në dhomën e fshehtë, shkoni në burg

Qendrat e votimit do të hapen në orën 7 të mëngjesit dhe do të mbyllën në orën 19:00. Askush nuk mund të votojë pas orës së mbylljes së qendrave të votimit, me përjashtim të zgjedhësve që presin për të votuar në kohën e mbylljes. Por cilat janë rregullat që duhet të ndjekë kushdo që do të ushtrojë nesër të drejtën kushtetuese të votës?

VOTIMI

Pas hyrjes në qendrën e votimit zgjedhësi thotë emrin dhe paraqet para KQV-së një nga dokumentet zyrtare të vlefshme të identitetit me të dhëna biometrike, si letërnjoftim apo pasaportë. Një prej anëtarëve, i caktuar me vendim të KQV-së, kontrollon zgjedhësin në të dy duart, në çastin e paraqitjes para KQV-së dhe para marrjes së fletës së votimit, nëse është timbruar ose jo me lëndën e posaçme. Në rast se zgjedhësi është timbruar, anëtar i KQV-së ia bën të ditur menjëherë këtë fakt anëtarëve të tjerë të KQV-së, të cilët e verifikojnë menjëherë. Emri dhe mbiemri i këtij zgjedhësi shënohen në Librin e Protokollit të Mbledhjeve të KQV-së dhe atij nuk i jepet fletë votimi. Kryetari, pasi verifikon se të dhënat e identitetit të zgjedhësit përputhen me të dhënat në listën e zgjedhësve dhe se zgjedhësi është i njëjtë me personin në dokumentin e identitetit, shënon në listën e zgjedhësve llojin dhe numrin e serisë të dokumentit të identitetit dhe i heq vizë emrit të zgjedhësit në këtë listë. Zgjedhësi nënshkruan në listën e zgjedhësve anash emrit të tij. Fleta e votimit vuloset në pjesën e pasme të saj me vulën e KQV-së dhe vulën e kryetarit të KQV-së. Kur është vendosur përdorimi i SEN-it, sipas këtij Kodi, fleta vuloset vetëm me vulën e KQV-së. Zgjedhësi timbroset në dorën e majtë nga

një anëtar i caktuar me vendim të KQV-së me një lëndë të posaçme, të dukshme me shikim të lirë dhe që nuk hiqet për jo më pak se 24 orë, me qëllim shmangien e votimit me shumë se një herë dhe më pas i jepet fleta e votimit. Në rast se zgjedhësi nuk pranon të timbroset me lëndën e posaçme, atij nuk i jepet fleta e votimit dhe identiteti i tij mbahet shënim në Librin e Protokollit të Mbledhjeve të KQV-së. Pasi merr fletën e votimit, zgjedhësi hyn i vetëm në dhomën e fshehtë dhe në fletën votimit shënon në krah të emrit të subjektit zgjedhor apo partisë pjesëtare të një koalicioni shenjën “x” ose “+” apo një shenjë tjetër që tregon qartë zgjedhjen e bërë prej tij. Zgjedhësi, pasi bën shënimin në fletën e votimit, palos fletën e votimit, në mënyrë që shenja të mos jetë e dukshme, por të paktën një nga vulat në pjesën e pasme të fletës të jetë e dukshme. Zgjedhësi, pasi del nga dhoma e fshehtë, e hedh fletën e votimit në kutinë përkatëse të votimit dhe largohet nga qendra e votimit.

PENALIZIMET

Kodi Penal u ashpërsua në fund të majit, duke e dënuar me burg fotografimin e votës. Neni 327 i këtij Kodi, që flet për shkeljen e fshehtësisë së votimit thotë: “Shkelja e rregullave që garantojnë fshehtësinë e votimit nga ana e zgjedhësit, nëpërmjet fotografimit të fletës së votimit, ose

filmimit të saj, ose dokumentimit me çdo mjet dhe formë të mënyrës sesi ka votuar, shfaqjes së tyre tek persona të tjerë, përbën vepër penale dhe dënohet me burgim nga tre muaj deri në tre vjet. Shkelja e rregullave që garantojnë fshehtësinë e votimit nga ana e personave të ngarkuar me zgjedhjet, përbën vepër penale dhe dënohet me burgim nga gjashtë muaj deri në tre vjet. Nxitja me ose pa shpërblim, ose detyrimi i zgjedhësit për të shkelur rregullat që garantojnë fshehtësinë e votimit, sipas paragrafit të parë të këtij neni, përbën vepër penale dhe dënohet nga një vit deri në katër vjet me burgim.” Ndaj, duhet bërë kujdes, që as për kënaqësi personale të mos fotografohet vota. Edhe dhënia e kartave të identitetit dënohet. Neni 331/a i Kodit Penal thotë: “Marrja ose përdorimi i paligjshëm i dokumenteve të identifikimit. Dhënia e dokumentit të identifikimit me qëllim përdorimin e tij në mënyrë të paligjshme për zgjedhje, garantimin e mospjesëmarrjes në votime, për të ndikuar në mënyrën e votimit, ose për çdo qëllim tjetër të paligjshëm që lidhet me zgjedhjet, përbën vepër penale dhe dënohet me burgim nga një vit deri në tre vjet. Marrja e dokumentit të identifikimit të shtetasve të tjerë, me qëllim përdorimin e tij në mënyrë të paligjshme për zgjedhje, moslejimin për të votuar, për të ndikuar në mënyrën e votimit, ose për çdo qëllim tjetër të paligjshëm që lidhet me zgjedhjet, përbën vepër penale dhe dënohet me burgim nga një deri në pesë vjet”.



dormi i paligjshëm i dokumenteve të identifikimit. Dhënia e dokumentit të identifikimit me qëllim përdorimin e tij në mënyrë të paligjshme për zgjedhje, garantimin e mospjesëmarrjes në votime, për të ndikuar në mënyrën e votimit, ose për çdo qëllim tjetër të paligjshëm që lidhet me zgjedhjet, përbën vepër penale dhe dënohet me burgim nga një vit deri në tre vjet. Marrja e dokumentit të identifikimit të shtetasve të tjerë, me qëllim përdorimin e tij në mënyrë të paligjshme për zgjedhje, moslejimin për të votuar, për të ndikuar në mënyrën e votimit, ose për çdo qëllim tjetër të paligjshëm që lidhet me zgjedhjet, përbën vepër penale dhe dënohet me burgim nga një deri në pesë vjet”.

Edi Rama mbyll nga Vlora derën koalicionit me LSI-në

Mesazhi i qartë i Kryeministrit Rama: "S'do jetë në pushtet sikur deti të bëhet kos, lëreni, mos lajthitni bashkë me të"

Edi Rama ka zgjedhur mitingun e fundit të kësaj fushate për të dhënë një mesazh të qartë për vijimin e koalicionit të mundshëm pas zgjedhor me LSI-së. Kryeministri tha se Lëvizja Socialiste për Integrim, nuk do të jetë më në pushtet edhe sikur deti të bëhet kos. "Unë ua them vlonjatçe, çamëve të Vlorës, nëse në fletën e votimit, në vend që ta bëni flamur kuqezi e bëni biletë mikrobusi për dashin e Havasë, jazëk ju qoftë. Je anëtar i LSI-së, aq më keq dhe aq më mirë. Lëre sot atë parti në lajthitjen e saj dhe mos lajthitni bashkë me atë që nëse të gjeti një punë të merr kuotë mujore nga rroga. Nëse ta premtojnë një punë sot, të gënjejnë, sepse çiflig në shtet për ta nuk do të ketë më të paktën për katër vjet dhe sikur deti i skelës të bëhet kos. Të ofrojnë hallvë në këmbim të votës, mos e refuzo, por votën që ke për Shqipërinë, mos e bëj hallvë për tepsinë e tyre", tha Rama. Kryeministri Edi Rama, ishte i pranishëm dje edhe në Himarë në mbyllje të fushatës elektorale të PS, nga ku sulmoi Vangjel Dulen. Ai tha se Dule tradhtoi partinë dhe minoritetin grek duke u bashkuar me PD-në, dhe se për këtë nuk duhet t'i jepet asnjë votë nga minoriteti. "Me vjen keq sepse kemi pasur miqësi, po jemi ftohur se Vangjeli vajti te Luli dhe mendoj se unë nuk do takoj me Lulin. Dulja nuk meriton asnjë votë nga asnjë minoritar sepse të gjithë retorikën nacionaliste e ka përdorur vetëm për ndenjësën e tij. Vangjelin e bëmë nënkryetar Kuvendi, mirëpo kur bëmë edhe Idrizin më mori në telefon dhe më tha se nuk rri unë me atë fashistin. Tani rri në autobus me Dashin



ELBASAN

Tërhiqen kandidatët e PAD e PSD: Mbështesim PS

Kandidatët e PAD dhe PSD në Qarkun e Elbasanit janë tërhequr dje nga gara dhe mbështesin Partinë Socialiste në zgjedhjet parlamentare të 25 qershorit. Kanë qenë dy kryesuesit e listave të kandidatëve, Arben Hoxha i aleancistëve dhe Taulant Sinani i socialdemokratëve, të cilët kanë njoftuar tërheqjen nga gara. Vendimi është marrë pas një takimi të zhvilluar këtë të premte në selinë e PS Elbasan, ndërsa i kanë bërë thirrje votuesve të tyre të bashkohen dhe të mbështesin Partinë Socialiste dhe Edi Ramën.

e Havasë. Për karrigen e tij ai tradhtoi minoritarët grek dhe shkoi te PD-ja", tha Rama. Ai

ironizoi edhe nismën e Ben Blushit 1000 euro për çdo lindje. "Ai tjetri ka gjetur front

Fjalimi

Valentina Leskaj tregon takimin e saj me militanten e PD që voton PS

Deputetja emblematike e Partisë Socialiste, e cila pak muja më parë hoqi dorë nga angazhimi parlamentar, Valentina Leskaj, ka marrë fjalën në mitingun përmblyës të Partisë Socialiste në Vlorë. Socialistja ndau me të gjithë të pranishmit në miting një takim që kishte pasur me një grua demokrate, e cila do të votonte PS-në. "Vlora do të jetë e para edhe këtë herë në 25 qershor. Miqtë e mi dua t'ju kujtoj sot se 4 vite më parë, ju kam thënë se i ka ardhur fati në derë, që do ketë deputet Edi Ramën, kryeministrin e vendit. Vlora provoi se ishte me fat, pasi sot kemi një Vlorë të re, të bukur. Do kemi një Shqipëri më të lulëzuar. miqtë e mi dua t'ju them që pardje kam takuar një grua në Vlorë, e cila ishte me PD. ajo më tha: "Unë jam me PD, por para se të jem me PD jam nënë me 3 fëmijë. Por Edi Rama e ka ndryshuar Vlorën dhe nuk e shes të ardhmen e fëmijëve të mi. E shoh që fëmijët e unë të votojnë për Edi Ramën, për PS". Dhe ky është një mesazh i fortë. Unë e di që ju që jeni këtu jeni mbështetësit tanë. Por edhe në këto orë që kanë ngelur duhet të bindim ata që votojnë për PS", tha Leskaj.



pune ai. 1000 euro për çdo lindje", -tha Rama.

RRËFIMI

Edi Rama tregon frikën e tij të madhe si politikan. Në kulmin e fushatës zgjedhore televizioni Italian ka transmetuar një intervistë të kryeministrit shqiptar ku flet për artin dhe politikën. Intervista u realizua në një hotel në Venecia nga Rai.it,

ku Rama merrte pjesë si një prej artistëve në Bienalen 57. Kryeministri zbulon gjithashtu se çfarë programon të bëjë në të ardhmen kur të mos jetë më pjesë e politikës. "Shpresoj që nuk do të humbë sensin e realitetit. Është kërcënim i madh për një politikan të humbë sensin e realitetit dhe ta konsideroj vetën të pa zëvendësueshem. Shpresoj shumë që pasi kam pasur një



jetë prej artisti, një të dytë prej politikani, të kem një të tretë ku do të mund të bëj diçka që të mbledhë përvojat e dy të parave. Dhe një farë mënyrë të më japë kënaqësinë e përcjelljes tek më të rinjtë e asaj që mund të jetë më interesante nga kjo përvojë." Në 11 minuta reportazh, shfaqen pamje

dita normale e punës e kryeministrit, me këmbët mbi tavolinën e mbushur me lapsa, takimet me bashkëpunëtorët më të afërt, si dhe një historik i rrugëtimit të tij politik që nga viti 2000

si kryebashkiak i Tiranës. Gjatë intervistës Rama flet dhe për artin e tij dhe orët e shkëputjes nga politika. "Nuk janë skulptura sipas meje, por janë zhgarravina në tredimensional. E bëj këtë gjatë kohës kur normalisht politikanët bëjnë not, sport apo diçka tjetër. Dhe unë e bëj ndonjë te shtunë ose të diel të qetë në atelienë e një mikut tim. Bën pjesë tek puna ime sepse të paktën për ato orë që duhet të merrem me zhgarravinat tredimensionale me baltë në duar, nuk mund të prek celularin tim. Që është diçka jashtëzakonisht e shëndetshme." Në edicionin e 2017-s të Bienales së Artit në Venecia, Edi Rama prezanton në formën e një muri një përzgjedhje të krijimtarisë së tij.

Ben Blushi: LIBRA do të jetë surpriza e këtyre zgjedhjeve

LIBRA ka mbyllur fushatën e saj me një miting elektorale në Tiranë, mbajtur te Pedonalja në Tiranë. Mitingu në prani të mbështetësve të partisë së deputetit Ben Blushi u zhvillua me pjesëmarrjen edhe të dy këngëtarëve, vëllezërit korçarë Endri dhe Stefi. Në nisje të mitingut, gjatë fjalës para mbështetësve, Blushi ka theksuar se "dy këngëtarët e njohur janë LIBRA si gjithë njerëzit e lirë të Shqipërisë". Gjatë fjalës, Blushi premtoi se LIBRA nuk është vetëm rruga e re, por ajo do të jetë surpriza e këtyre zgjedhjeve dhe

fuqia e shtresës se mesme te vendit. Sipas deputetit Blushi, kreut të partisë, LIBRA premtonte të çojë njerëzit e zakonshëm në Parlament duke qenë i bindur se ata do votojnë një ligj të ri për pronat. "Do dyfishojmë buxhetin e arsimit, do rrisim minimumin jetik për 500 mijë shqiptarë, do ulim taksat për shtresën e mesme dhe do nxjerrim kazinotë jashtë qyteteve", - kane qene disa nga deklaratat e forta te bëra nga Blushi gjatë prezantimit te programit te tij para shqiptareve nga takimi i fundit elektorale.



SHOQËRIA PËRMBARIMORE "616/A" SHPALL PËR SHITJE NË ANKANDIN E DYTË PASURINË E PALUAJTSHME:

Truall me sip. 120 m² prej të cilave 120 m² ndërtesë, me nr. pasurie 3/392, vol. 15, faq. 82, zona kadastrale nr. 8561 e ndodhur në rrugën "Niko Kovaci", Lagjja nr. 1, Korçë .

Pasuria shpallet me vlerë fillestare **6,048,000 lekë** (gjashtëmilionedyzetëetëmijë).

ANKANDI ZHVILLOHET DITËN E HËNË , 17 KORRIK 2017

Personat e interesuar mund të paraqiten në adresën Lagjja Nr.3, Rruga "Andon Xoxe", Pogradec ose të kontaktojnë në numrin 0682223020 ose në e-mail: shoqeria616a@gmail.com



Kukës

Mimi Kodheli përplasat me Beçajn e LSI për gradimin e ushtarakëve



Gradimi i rreth 100 ushtarakëve nga Ministria e Mbrojtjes është kthyer në një përplasje mes kandidatit të PS-së, Mimi Kodheli dhe asaj të LSI-së, Selvi Beçaj. Pas lajmit të gradimit të ushtarakëve kuksianë, Beçaj e ka cilësuar si akt të neveritshëm. “E neveritur lexova këtë denoncim! Sado tollona, sado grada e para të fusni në lojë, populli i Kukësit, Hasit dhe Tropojës do ju japë përgjigjen që meritoni. Qytetarët ju kanë dhënë me qindra shanse dhe sot jemi qarku më i varfër në Shqipëri ndaj me datë 25 do votohet LSI dhe Selvi Beçaj në të gjithë Malësinë për të sjellë një shans për të gjithë shqiptarët dhe Shqipërinë!”, -shprehet ajo. Menjëherë reagoi Kodheli. “I bëj thirrje të gjitha grave që marrin pjesë në fushatën elektorale edhe kësaj që merr pjesë këtu tek kjo fushata jonë, ta mbajë gjuhën kur bën komente se nuk e ka idenë fare për çfarë po flet! Sigurisht që zoti do t'i falë se shumëkush nuk di çka bën, jam e sigurt për këtë. Kështu që meqë është për pak gra, i ftoj këto gratë të mos merren me Ministrinë e Mbrojtjes se nuk kuptojnë për çfarë flasin”, -tha Kodheli.

STUDIO PËRMBARIMORE “SPEED SOLUTION” NJOFTON SHPALLJEN E ANKANDIT 2 PËR:

“Apartament”, me sip 71,6 m², me nr.pasurie 2/9+2-19, Z.k.8260, Volumi 4, faqe 249 me adresë Rr.“Irfan Tomini” TIRANË. Kjo pasuri është hipotekuar në favor te BANKA E TIRANËS sh.a. Çmimi me të cilin fillon ankandi është **23 520 (njëzet e tre mijë e pesëqind e njëzet) Euro.**

Ankandi do të zhvillohet më datë **26.06.2017, Ora 16:00**, pranë Studios Përmbarimore “SPEED SOLUTION” me Adresë: Bulevardi “Gjergj FISHTA” Kulla. 1, Kati, 2. Nr.3, Tiranë.

Për çdo informacion mund të kontaktoni
cel. 0693041355, email: speed.solution@yahoo.com

LSI mbyll fushatën në Fier, Meta: Rama i thotë PD-së “më shpëto”

“Mos i hipni fëmijët tuaj në autobusin mavi. Socialistët e vërtetë nuk janë mavi”

Lëvizja Socialiste për Integrim mbylli zyrtarisht fushatën elektorale duke zgjedhur qarkun e Fierit. Përpara mbështetësve të LSI, ish-kryetari i kësaj force politike dhe njëherazi presidenti i ardhshëm, Ilir Meta, thumboi kryeministrin Edi Rama se po i kërkon ndihmë PD-së dhe Bashës për të shpëtuar nga rezultati zgjedhor. Meta kujtoi se LSI zgjodhi Fierin për mbylljen e fushatës pasi mbështetja e saj më e madhe është pikërisht në këtë qark. Sipas Metës, Fieri është kryeqyteti i socialistëve, por jo i mavisë, siç e quajti ai PS-në. “Jo rastësisht mitingun e fundit e lamë këtu në Fier, në kryeqendrën historike të socialistëve dhe të progresistëve. Asnjëherë ky shesh s’ka qenë kaq i madh, kaq i bukur dhe me kaq të rinj dhe të reja. Asnjëherë ky shesh s’ka qenë kaq i kuq dhe me kaq shumë shpresë. Kjo ndodh se këtu nuk janë bashkuar vetëm anëtarët e LSI por këtu janë shumë më tepër, janë gjithë socialistet e ndershëm të Fierit që u mashtruan nga partia. Mavia e tmerruar besoj e dëgjuaat dje i bëri thirrje PD për ta ndihmuar. Tani i thonë PD aman na shpëto. Na shpëto nga ky uragan mbarëpopullor. Mavia tani do iki njëherë e përgjithmonë nga drejtimi i Shqipërisë se përfaqëson drejtimin më të vjetër, shtypës ndaj qytetarëve të thjeshtë. Mos i hipni fëmijët tuaj në autobusin mavi”, -u shpreh Meta. Ai iu referua edhe dhunimit të një të riu anëtar të LRI, në fshatin Zharrëz. Meta fajësoi socialistët dhe theksoi se këto ngjarje fierakeve iu kujtojnë dhunën e Berishës në 94-ën në Libofshë. “Këtu janë gjithë ata që e kuptuan se mavia punon për oligarkinë dhe xhepat e saj, ata që se pranojnë dot dhunën presionin për të mos votuar për alternativën që duan. Janë ata që dhuna ndaj një 18 vjeçari në Zharrëz, që u godit pabesisht nga kreu i mavisë atje në Zharrëz, me projektin e të 9-it në listë. Nuk mund të pranojnë fierakët se iu kujton dhunën që Berisha bëri në ‘94 në Libofshë”, -deklaroi Meta.

KUÇOVA

Lëvizja Socialiste për Integrim zhvilloi një takim elektorale me qytetarë të Kuçovës, ku kandidatët për deputetë të qarkut Berat prezantuan programin e LSI-së. I pranishëm në këtë takim ishte edhe kryetari i Kuvendit, Ilir Meta, i cili theksoi se shqiptarë kanë nevojë për t’u përfaqësuar nga intelektualë, kanë nevojë për energji pozitive, mirënjohje dhe solidaritet. Kandidatja për deputete LSI-së në qarkun e Beratit, Llambriola Misto, në fjalën e mbajtur para qytetarëve të Kuçovës, tha se Lëvizja Socialiste për Integrim është partia e rinisë dhe se rinia është e ardhmja e Shqipërisë. “Partia e të rinjve është LSI-ja. Sepse nga 170 mijë vende të reja pune që do të hapim në 4 vitet e ardhshme 100 mijë do të jenë vetëm për rininë, sepse prioriteti i LSI-së është e ardhmja e rinisë dhe jo e ardhmja e kriminelëve.



Në Berat

Nasip Naço denoncon tek ndërkombëtarët: Po blihen vota

Letër Lallës e Lu-së: Krimi ka dalë në rrugë, policia është fshehur

Me një letër drejtuar Ministrisë së Brendshme, Prokurorit të Përgjithshëm, Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, Ambasadorit të SHBA, përfaqësuesve të OSCE/ODIHR, kryesuesi i listës së LSI-së në Berat, denoncon se në këtë qark po blihen vota. “Krimi si asnjëherë ka dalë në rrugët e Beratit dhe Policia e Shtetit është struktur nëpër zyra dhe po funksionon vetëm policia e “Rilindjes” e cila është përgjigjur thirrjes së kryeministrit për të zhveshur uniformën e shtetit dhe për të dalë e për të grumbulluar vota së bashku me botën e krimin. Paqur për vota që nga Kandidatët e “Rilindjes” tashmë të damkosur me vulën e turpit duke blerë vota. Ndërkohë që organet ligjzbatuese duhet ta kishin mbaruar detyrën e tyre vijon presioni e kërcëni-

mi me armë i anëtarëve dhe simpatizantëve të Lëvizjes Socialiste për Integrim”, -thotë Naço. Ish ministri i drejtësisë, kërkon nga policia ndërhyrje. “I bëj thirrje Policisë së Shtetit në Berat të distancohet nga krimi i rrugës, të mos i japi dorën individëve me precedent penal, të mos rri struktur në zyra por të kryejë detyrën dhe përgjegjësitë që i ngarkon ligji, duke mos u gjuhëzuar në përballje me krimin dhe të deklarojë : - “Të hënë në

26 qershor do t’ju tregoj se çfarë do t’ju bëjë”. Citim ky nga goja e shefave të Policisë në komunikim me kriminelët. Në këto rrethana kur policia e shtetit është struktur në zyra dhe nuk po kryen detyrën e saj jam i detyruar t’iu drejtohem qytetarëve të Beratit ku ju kërkoj të: Regjistroni, filmoni dhe denonconi dhunën apo shitjen e votës të “kurbanëve të Rilindjes” për t’ia vënë në dispozicion Prokurorisë së Krimeve të Rënda dhe të gjithë përfaqësive diplomatike të akredituara në vendin tonë! Qytetarë të Qarkut Berat, anëtarë dhe simpatizantë të Lëvizjes Socialiste për Integrim ju bëj thirrje që dhunës së ushtruar ndaj jush t’i ktheni përgjigje me votën e lirë të dielën dhe t’i jepni një shans të ardhmes së fëmijëve tuaj”, -përfundon letra e Nasip Naços.



Unë kam një ëndërr që t’i rikthej vlerat qytetit tim dhe t’ju jap një shans të gjithëve ju. Votoni LSI, votoni nr. 1! Më jepni një shans dhe unë do tua kthej në një shans për familjet tuaja”, - deklaroi Misto. Ndërsa, kandidatja tjetër e LSI-së, Silva Caka, theksoi se të rinjtë duhet të marrin në dorë fatet e vendit dhe duhet të marrin shanset për të ndërtuar

Unë kam një ëndërr që t’i rikthej vlerat qytetit tim dhe t’ju jap një shans të gjithëve ju. Votoni LSI, votoni nr. 1! Më jepni një shans dhe unë do tua kthej në një shans për familjet tuaja”, - deklaroi Misto. Ndërsa, kandidatja tjetër e LSI-së, Silva Caka, theksoi se të rinjtë duhet të marrin në dorë fatet e vendit dhe duhet të marrin shanset për të ndërtuar

të ardhmen e tyre në Shqipëri. “Janë pikërisht të rinjtë që do të marrin të ardhmen e vendit në dorë dhe duhet të jemi pikërisht ne që duhet t’u japim një shans nëpërmjet politikave, që do të ndjekim për të rinjtë, që të marrin këtë të ardhme në duart tyre. Duke mbajtur LSI në zemër dhe në shpirt jam shumë e bindur që më datën 25 qershor do të votoji për numrin 1, për LSI dhe për të gjithë të rinjtë kudo që ndodhen dhe që përfaqësojnë këtë forcë politike”, - deklaroi Caka.

Për Ramën

"Edi Rama ka katër javë që flet sikur nuk ishte kryeministër por kryetar opozite. E dini si i thonë kësaj apo jo? Ngaqë dëgjonte çadrën për tre muaj filloi edhe ai të flasë si i çadrës".

Partia Demokratike mbylli mbremë fushatën elektorale në vendin e çadrës së ngujimit, në sheshin mes Kryeministrit dhe Kuvendit. Gjatë fjalës së tij, kryetari i opozitës, Lulzim Basha, u shpreh përpara mbështetësve se Republika e Re do sjellë një pakt të ri mes politikës dhe qytetarëve. Basha shtoi se kryeministri Rama flet si kryetar opozite edhe pse ka qenë 4 vjet në pushtet. Kreu i PD theksoi se shqiptarët do ta largojnë Ramën këtë të diel. Basha shtoi se e diela është dita e gjykimit për Edi Ramën. "Republika e re do sjellë një pakt të ri mes politikës dhe qytetarëve. Kurrë më s' do keni kryeministër që shpërfilloi qytetarët, një kryeministër të qejfeve dhe tekave të tij. Ju meritoni dhe do të keni kryeministrin e qytetarëve, kryeministrin e ekonomisë. Sepse ekonomia është çështja kryesore për të cilën vendosim ne këtë diel. Ditën e diel është dita për gjykimin popullor me votë. Edi Rama ka katër javë që flet sikur nuk ishte kryeministër por kryetar opozite. E dini si i thonë kësaj apo jo? Ngaqë dëgjonte çadrën për tre muaj filloi edhe ai të flasë si i çadrës, por ai nuk është i çadrës, nuk është i Republikës së Re, ne do ta largojmë me votë", u shpreh Basha.

PLANI EKONOMIK

Kryetari i Partisë Demokratike, Lulzim Basha, u shpreh mbremë se plani i tij ekonomik ka mbështetjen e Merkel dhe Trump, ndërsa premtoi uljen e taksave. "Plani im ekonomik ka marrë bekimin e Merkel dhe mbështetjen e Trump me taksë të ulëta, me uljen e TVSH-së dhe me Republikën e Re i japim shqiptarëve ekonominë e fortë dhe e nesërmen e sigurt për çdo qytetar. Dita e diel ndan gjithçka. Prandaj ndodhemi në këtë shesh, siç ishit në të gjitha sheshet e Shqipërisë pre tre javë. Ditën e diel mbushini qendrat e votimit, merrini me vete familjarët tuaj. Ju që ende s' e keni vendosur në këto 48 orë të undit, dijeni mirë që jemi shqiptar, jemi krenar që jemi shqiptar, e duam flamurin kuqez, jemi krenar për Ismail Qemalin, por të dielën nuk votohet për Ismail Qemalin, të dielën votohet për Skënderbeun, votohet për prindërit dhe fëmijët tuaj", tha Basha.

PREMTIMET

Basha theksoi edhe një herë se Edi Rama nuk mbajti asnjë premtim. "Në katër vite nuk mbajti asnjë premtim sepse nuk kishte prioritetet hallet dhe problemet e qytetarëve. Mundësia e vetme që Rama iu ka dhënë shqiptarëve është ajo që Gallup konstatoi para një jave, 56 % duan të largohen nga Shqipëria.

NË FOTO: Pjesëmarrja e mbyljes së fushatës së Partisë Demokratike në Bulevardin "Dëshmorët e Kombit"



Basha mbyll fushatën: Të dielën largojmë Ramën

Kreu i Partisë Demokratike: Plani im ekonomik ka marrë bekimin e Merkel dhe mbështetjen e Trump

Në Laç

Kreu i PD: Të dielën nuk votohet për Skënderbeun



Kryetari i Partisë Demokratike, Lulzim Basha ka akuzuar kryeministrin Edi Rama në mitingun përmbyllës në Laç, se nuk ka plan, por vetëm premtime të ricikluara, që dështoi t'i realizonte në 4 vite. Basha u shpreh se Rama nuk do ta ketë kurrë timonin, ndërsa ironizoi me kryeministrin duke thënë se në 25 qershor nuk votohet për Ismail Qemalin dhe Skënderbeun, por për ekonominë. "Rama është pa plan, nuk ka program, vetëm mashtrime. Këto ditë bën thirrje për të votuar për Ismail Qemalin dhe Skënderbeun, por të dielën nuk votohet për Skënderbeun dhe Ismail Qemalin, por për ekonominë", tha Basha. Kryetari i Partisë Demokratike u shfaq euforik para qytetarëve të Laçit. "Nuk ka nevojë të më merrni peng se unë vij me dëshirë këtu, është shtëpia ime, më ka marrë peng Zoti se më ka lind në një ditë me ditën e madhe të Shen Ndout", tha Basha.

Republika e Vjetër na çon në hajatin e krizës, ne do ta mbyllim atë derë dhe dera tjetër që hapim bashkë është vota për numrin 6, është dera për planin ekonomik të vetëm në këto zgjedhje, me TVSH 15%, taksën e sheshtë 9%, 1.5% të xhiros taksën e biznesit të vogël dhe pullën fiskale që do të ndalojë tmerrin e taksidarëve. Vetëm investimet sjellin ekonominë e fortë", tha Basha.

PD MBYLL FUSHATËN NË DURRËS

Partia Demokratike ka mbyllur fushatën elektorale edhe në qytetin e Durrësit, përmes një mitingu elektorale me mbështetës. Në fjalën e tij përpara demokratëve, Lulzim Basha bëri thirrje për ndëshkimin me votë të kryeministrit Edi Rama, pasi sipas tij nuk mbajti premtimet në këto katër vite. "Ditën e diel amfiteatri do të jetë mes përballjes së dy mundësive, mundësisë për të vazhduar me politikën e korrupsionit të Edi Ramës, ose votën për Republikën e Re, ekonominë e fortë dhe të nesërmen e sigurt.

Ekonomia

"Plani im ekonomik ka marrë bekimin e Merkel dhe mbështetjen e Trump me taksë të ulëta, me uljen e TVSH-së dhe me Republikën e Re i japim shqiptarëve ekonominë e fortë dhe e nesërmen e sigurt".

Alojz Peterle

Përfaqësuesi i PPE: Nuhas fitore të PD ditën e diel

Përfaqësuesi i Partive Popullore Evropiane, Alojz Peterle, mori pjesë dje në mitingun përmbyllës së Partisë Demokratike. "Unë jam këtu sepse ne besojmë tek e ardhmja evropiane dhe demokratike për Shqipërinë. Jam i nderuar sot të jem këtu mes jush dhe në emër të presidentit të PPE-së Joseph Dol, i cili kërkon që të dielën ne të fitojmë së bashku. Ne jemi krenar që PD e udhëhequr nga kryetari Basha është anëtare e familjes më të madhe në Evropë dhe ne ndajmë të njëjta vlera për Shqipërinë. Duhet të jeni krenar që keni mes jush dhe në partinë tuaj individë me vizion për zhvillimin e ekonomisë dhe të programit tuaj, ndihuni krenar me ta. Tra dini se ata janë tejet të angazhuar për një të ardhme më të sigurt për një ekonomi më të sigurt, për të ardhme më të mirë për Shqipërinë. Ne jemi krenar që ndajmë tek PPE-së së bashku me PD-në vlerat e demokracisë dhe të drejtësisë", tha përfaqësuesi i PPE-së. Ai shtoi se nuhaste një fitore të PD të dielën. "Unë nuhas fitore të dielën unë shohë energjinë tuaj, fitore. Koha për kryeministrin Basha, koha për një Republikë të Re Faleminderit", u shpreh ai në fjalën e tij.

Ky është një bashkim i madh kundër njeriut që premtoi dhe nuk i mbajti premtimet, që ka prioritet e gabuara dhe për këto vite. Prej 4 vitesh askush nuk kujtohet për pensionistët. Pas 4 vitesh, ai flet tani sikur nuk ishte ai kryeministri, sikur s'i ka ai fajet. Frigoriferët e

shqiptarëve janë bosh, xhepat e shqiptarëve janë bosh. Koha për Ramën ka ikur, ndëshkoheni me votë. Duhet t'i kthejmë dinjitetin vendit, të favorizojmë ekonominë, bujqësinë. Vetëm një koalicion mund ta bëjë këtë, Partia Demokratike, Republika e Re", u shpreh Basha.

Fjalimi

Hasa s'lidh dy fjalë, por Basha e quan shpëtimtar



Idyti në listën e PD-së për Elbasanin, Endri Hasa ka "spikatur" që në daljen e parë publike për pamundësinë e tij për të komunikuar me njerëzit. Në hapje të fushatës u shfaq në podium me një fletë në dorë duke i thurur lavde vetes se ishte më i miri që Elbasani kishte pasur ndonjëherë, por me sa duket, as një muaj fushatë nuk i ka mjaftuar për të rregulluar këtë problem jo të vogël komunikimi. Në ditën e mbyljes së fushatës, Hasa u ngjiti në podium para elbasanasve sërish me një fletë në dorë për një fjalim dy minutësh. Edhe pse e kishte të shkruar, Hasa, i cili është deputet i sigurt në parlamentin e ri, nuk mundi që asnjë fjalë ta thotë të saktë. Videoja ju ilustron qartë dështimin e tij për të qenë i qartë për ata që e ndiqnin. Por pavarësisht kësaj, Basha nuk heq dorë nga zgjedhja e tij. Pasi hipi në podium pas Hasës, Basha e prezantoi atë si shpresa dhe shpëtimin e Elbasanit, kur tha se me ndihmën e Hasës dhe aftësitë e tij do ta kthenin këtë qytet në kryeqytetin e teknologjisë.

Fushata e vetmuar, figurat që braktisën Lulzim Bashën

Tre grupet që qëndruan larg fushatës së drejtuar nga kryetari i opozitës, braktisa e madhe nga qytetarët

ADRIATIK DOÇI
TIRANE

Nuk do të mbahet mend vetëm si fushata më e çuditshme në historinë e pluralizmit, ku tre forcat kryesore akuzojnë njëra-tjetrën për keqeverisjes, duke qenë pjesë e çadrës së qeverisë, por do të mbahet mend edhe si fushata më e vetmuar kryetarit të opozitës, Lulzim Basha. Si rrallë ndonjëherë, në këtë fushatë elektorale, zëri i Lulzim Bashës është i vetmi në shkretëtirën e opozitës shqiptare. Është i tillë për tre arsye. Së pari, rreth 25 figura

janë angazhuar plotësisht në fushatë, për shkak se ata, meqenëse janë pjesë e listës së fituese, pra e kanë siguruar mandatin e deputetit, nuk janë të motivuar. Së treti, disa ish-ministra dhe deputetë, figura të konsumuara të Partisë Demokratike, po mbahen qëllimisht nga Lulzim Basha larg fushatës, për të mos kompromentuar ekipin e ri dhe imazhin që po përploqet të krijojë. Por, braktisja e madhe e Lulzim Bashës ka ardhur nga qytetarët. Gjatë fushatës 3-javore, Partia Demokratike nuk zhvilloi goftë edhe një miting masiv. Basha u braktis në Shkodër, Tropojë, Kukës, Dibër, Lezhë, Tiranë, Durrës dhe në të gjitha qendrat e Jugut.

GRUPI I PARË

Grupi i parë që ka braktisur fushatën elektorale përbëhet nga eksponentë me peshë në Partinë Demokratike, të cilëve Lulzim Basha vendosi t'u ndërprese karrierën politike dhe parlamentare. Pjesë e këtij grupi janë Jozefina Topalli, Majlinda Bregu, Eduard Selami, Ridvan Bode, Astrit Patozi, Arben Imami, Keltis Kruja, Kastriot Islami, Myqerem Tafaj, Genc Ruli etj. Bregu dhe Selami morën pjesë vetëm në mitingun e mbylljes së fushatës. Gjithashtu, në këtë fushatë, për të maksimalizuar energjitë politike të Partisë Demokratike, nuk janë aktivizuar edhe disa figura të tjera, të cilat u përjashtuan nga lista e kandidatëve për deputetë në zgjedhjet e 2013. Nga ky grup, Lulzim Basha

me peshë të Partisë Demokratike, të përjashtuar nga lista e kandidatëve për deputetë, kanë braktisur fushatën e drejtuar nga Lulzim Basha për zgjedhjet parlamentare të 25 qershorit, ndërsa po presin në heshtje humbjen e kryetarit, për të kërkuar rrezimin e tij. Së dyti, disa kandidatë për deputetë, përfshirë edhe kryetarët e partive aleate, nuk

janë hartuar nga Lulzim Basha, pasi janë detyrë e tij dhe se ai nuk ka pasur asnjë rol në hartimin e tyre. Gjithashtu, në raport me kompetencën dhe dorën e lirë për të formuar ekipin e tij, Berisha i ka kujtuar Bashës edhe përgjegjësinë që ka kryetari për rezultatin. Nga ana tjetër, edhe pse pjesë e listës fituese, po ruajnë një profil të ulët mediatik në këtë fushatë, edhe disa eksponentë të tjerë të PD, si Edi Paloka, Genc Pollo, Edmond Spaho, Aldo Bumçi, Arben Ristani etj. Po ashtu, disa nga anëtarët e Kryesisë së PD, si Valbona Mezini, Nevila Xhindi, Besart Kadia, Ardian Turku, Jamarbër Malltezi, Endira Bushati, Laura Vorpsi etj., nuk kanë qenë aktivë gjatë fushatës. Ka edhe disa kandidatë, të cilët pasi kanë siguruar mandatin e deputetit, për shkak të renditjes në listë, nuk janë të motivuar apo janë angazhuar vetëm pjesërisht në fushatë. Ndryshe nga fushatat e tjera, kreu i PDK, Nard Ndoka, kreu i PBDNJ Vangjel Duke dhe kreu u LZHK, Dashamir Shehi, kanë zhvilluar vetëm disa takime sporadike, për shkak se ata do të jenë pjesë e parlamentit të ri, falë renditjes në listë.



Imami & Topalli Furtuna e re në Partinë Demokratike

Dy figura të rëndësishme të Partisë Demokratike, Arben Imami dhe Jozefina Topalli, disa ditë më parë, kërkuar mbledhjen e forumeve të larta të partisë për të shkarkuar kryetarin Lulzim Basha, me argumentin se ka shkelur Statutin e PD, gjatë projektimit, hartimit dhe shpalljes së listës së kandidatëve për deputetë. Megjithatë, pas reagimeve të ditëve të para, të përjashtuarit nga lista ndërprejnë sulmet, për të pritur rezultatin e zgjedhjeve. Nëse Lulzim Basha i humbet zgjedhjet, përpos të tjerave, ai duhet të përballet me një sulm të ri të gardës së vjetër, e cila pritet të kërkojë shkrimin e kryetarit.

ka rikthyer në listën fituese vetëm Enkelejd Alibejan dhe Tritan Shehun. Konkretisht, nuk janë angazhuar në këtë fushatë ose të paktën publikisht, Ilir Rusmali, Ferdinand Xhaferraj, Fatos Hoxha, Mark Marku, Jemin Gjana, Viktor Gumi, Osman Metalla, Selami Xhepa, Adriana Gjonaj, Arenca Trashani, Paulina Hoti, Rajmonda Bulku, Lajla Përnaska etj. Janë rreth 50 ish-deputetë dhe deputetë, të përjashtuar nga listat e kandidatëve në zgjedhjet e 2013 dhe në zgjedhjet parlamentare të 2017.

GRUPI I DYTË DHE I TRETË

Lideri historik, Sali Berisha, ndonëse pjesë e listës fituese të kandidatëve për deputetë në Qarkun e Tiranë, nuk është përfshirë në fushatën e drejtuar nga pasardhësi i tij, Lulzim Basha. Kjo është fushata e dytë elektorale, të cilës Sali Berisha, me vullnetin e tij apo me kërkesë të Lulzim Bashës, i qëndron larg. Berisha ka sqaruar disa herë arsyet politike për mospërfshirjen e tij në fushatë. Po ashtu, ish-kryeministri Sali Berisha është distancuar nga listat e kandidatëve për deputetë të PD-së, duke pohuar se listat

TË PËRJASHTUARIT NGA LULZIM BASHA NË 2017

Jozefina Topalli
Majlinda Bregu
Eduard Selami
Ridvan Bode
Astrit Patozi
Arben Imami
Keltis Kruja
Enno Bozdo
Asllan Dogjani
Kastriot Islami
Myqerem Tafaj
Bedri Hoxha
Roland Keta
Igli Cara
Kozma Dashi
Bedri Mihaj
Arbiola Halimi
Genc Ruli (nuk kandidoi vetë)
Eleina Qirici
Gjergji Papa
Mimoza Hajdarmataj
Albina Deda
Gjovalin Bzhetaj
Irma Kopliku
Liljana Elmazi

TË PËRJASHTUARIT NGA SALI BERISHA NË 2013

Ilir Rusmali
Ferdinand Xhaferraj
Fatos Hoxha
Leonard Demi
Mark Marku
Jemin Gjana
Viktor Gumi
Osman Metalla
Selami Xhepa
Adriana Gjonaj
Arenca Trashani
Astrit Bushati
Vath Tabaku
Fatbardh Kadilli
Fatos Beja
Gjok Uldedaj
Ramiz Çobaj
Ndriçim Babasi
Ilir Bano
Kreshnik Çipi
Lajla Përnaska
Ledina Aliolli
Luan Skuqi
Paulina Hoti
Rajmonda Bulku
Rrahim Çota
Sybi Hida
Vasillaq Ngresi
Ylli Lama
Koço Barka
Aurel Bylykbashi
Mehmet Xheka
Ismail Hoxha
Rajmond Hoxha

DETAJET

Fushata

Do të mbahet mend edhe si fushata më e vetmuar kryetarit të opozitës, Lulzim Basha. Si rrallë ndonjëherë, në këtë fushatë elektorale, zëri i Lulzim Bashës është i vetmi në kampin apo në shkretëtirën e opozitës shqiptare.



Grupi i parë

Grupi i parë që ka braktisur fushatën elektorale përbëhet nga eksponentë me peshë në Partinë Demokratike, të cilëve Lulzim Basha vendosi t'u ndërprese karrierën politike dhe parlamentare.

Studio Permbarmore "SHKRELA" do te zhvilloje Ankandin e Pare per pasurite

a) "Are+Truall + Ndertese", me siperfaqe totale 10,888 m2 nga e cila 10,888 m2 eshte Are, 100 m2 eshte Truall dhe 100 m2 eshte Ndertese, me nr. Pasurie 146/16, vol.2, fq.69, Z.K. 1158, e ndodhur ne fshatin Berdice e Mesme, Shkoder ne pronesi te Fejzi Shefqet Hoxha

Cmimi me te cilin fillon shitja e kesaj pasurie eshte ne vleren 129,200 (njqezind e njezete e nente mije e dyqind) Euro
b) "Are" me nr. Pasurie 333/44, me siperfaqe totale 4,000 m2, vol.5, fq.11, Z.K. 1158, e ndodhur ne fshatin Berdice e Mesme, Shkoder ne pronesi te Fejzi Shefqet Hoxha

.Cmimi me te cilin fillon shitja e kesaj pasurie eshte ne vleren 20,720 (njqezete mije e shtateqind e njezete) Euro
c) "Are" me nr. Pasurie 335/17, me siperfaqe totale 7,210 m2, vol.2,fq.226, Z.K. 1158, e ndodhur ne fshatin Berdice e Mesme, Shkoder ne pronesi te Fejzi Shefqet Hoxha

.Cmimi me te cilin fillon shitja e kesaj pasurie eshte ne vleren 25,920 (njqezete e pese mije e nenteqind e njezete) Euro
d) "Are" me nr. Pasurie 333/23, me siperfaqe totale 4,532 m2, vol.2, fq.201, Z.K. 1158, e ndodhur ne fshatin Berdice e Mesme, Shkoder ne pronesi te Fejzi Shefqet Hoxha

.Cmimi me te cilin fillon shitja e kesaj pasurie eshte ne vleren 16,240 (gjashtembdhjete mije e dyqind e dyzete) Euro
e) "Are" me nr. Pasurie 379/11, me siperfaqe totale 3,000 m2, vol.5, fq.9, Z.K. 1158, e ndodhur ne fshatin Berdice e Mesme, Shkoder ne pronesi te Fejzi Shefqet Hoxha

.Cmimi me te cilin fillon shitja e kesaj pasurie eshte ne vleren 9,600 (nente mije e gjashteqind) Euro

,Ankandi i Pare zhvillohet me dt.28.06.2017, ora 16:00 ne ambientet e Studios Permbarmore Shkrele me adrese: Blv."Zogu i I", Pall. "Agimi", Hy 2, Kt 3, Ap. 5, Tirane, Web: www.shkrelabelaffsoffice.com

KOALICIONI

"Një koalicion me LSI për PS-në është e keqja më e vogël se një koalicion me PD-në. Në rastin e parë kemi një koalicion që ka funksionuar, ndërsa me PD është i panatyrshëm"



Paskal Milo dhe Denis Minga në emisionin "45 minuta" në Report Tv

KOALICIONI

"Një koalicion me LSI për PS-në është e keqja më e vogël se një koalicion me PD-në. Në rastin e parë kemi një koalicion që ka funksionuar, ndërsa me PD është i panatyrshëm"

SEKRETARI I MAS

DAP rrëzon Karabinën, Plarent Ndreca kthehet në detyrë



Pas rrëzimit të bërë para një jave nga KSHC, dje erdhi edhe rrëzimi që DAP-i bën aktit të Ministres teknike të Arsimit dhe Sportit, Mirela Karabina për, pezullimin e Sekretarit të Përgjithshëm të MAS Plarent Ndreca. Sipas DAP, akti ishte absolutisht pa vlerë juridike. Plarent Ndreca, u shkarkua nga detyra me vendim të ministres Karabina me 13 qershor, pasi sipas Ministres ai ishte paraqitur në shkollën e mesme "Shota Galica" në mënyrë të paautorizuar në kohën kur po zhvillohej provimi i maturës. Ndërsa me 19 qershor, Karabina e kallëzoi në polici Ndreca pasi sipas sajë ai kishte hyrë në mënyrë të paautorizuar në Ministri.

"Me hir ose me pahir, PS-LSI do bashkëqeverisin përsëri"

Milo e sheh sërish të majtën në koalicion pas 25 qershorit

Pavarësisht nga tonet e ashpra të kësaj fushate elektorale, kryetari i PDS, Paskal Milo, sheh sërish bashkëqeverisje PS-LSI pas pas 25 qershorit. I ftuar në "45 minuta" me Denis Mingën në Report Tv, Milo tha se ky koalicion është më i natyrshëm sesa një bashkëpunim i PS-së me PD-në, siç edhe është artikuluar mediatikisht, i cili do të kontestohet në radhë të parë nga elektorati i dy forcave politike. "Një koalicion me LSI për PS-në është e keqja më e vogël se një koalicion me PD-në. Në rastin e parë kemi një koalicion që ka funksionuar, ndërsa me PD është i panatyrshëm, ka një hendek, forcat ndahen me njëra-tjetrën, forca sociale

që janë kundër njëra-tjetrës, s'do pritej mirë nga militantët e dy partive. Këtu s'jemi në Gjermani, as në ndonjë vend europian demokratik ku bashkëqeverisja është normë, pranohet, këtu jemi në një Shqipëri të varfër, me shumë korrupsion. Të parët do ishin militantët që s'do pranonin. Me hir ose me pahir, PS-LSI do bashkëqeverisin", u shpreh Milo.

"MANDATI IM PËR PS NËSE RAMA KËRKON NDJESË"

I pyetur për marrëveshjen, PDS-LSI, Milo tha se ka në funksion mbrojtjen e votave. Ndërsa theksoi se mandati i tij në Kuvend do shkoto për qeverinë "Rama" nëse ky i fundit do kërkonte ndjesë për shpërfilljen

ndaj aleatëve, pavarësisht se cili do të ishte vendimi i LSI-së. "Ne kemi marrëveshje me LSI, e cila do kujdeset për ruajtjen e votave për PDS-në. Ka dhe një pikë tjetër për të bashkëpunuar pas zgjedhjeve, nëse partitë tona do vijnë në qeverisjen e vendit. Vendimmarrja është sovraane në përputhje me programin e partisë tonë, me interesat e vendit. Do vendosim në momentin e duhur se me cilin do bashkëpunojë PDS. Nëse Rama kërkon ndjesë publike, po. Mbetemi të hapur për bashkëpunim, patjetër", tha Milo. I pyetur për ndërhyrjen e Greqisë dhe Turqisë në këto prag zgjedhje Paskal Milo u shpreh se: "Bëjnë shumë gabim, është parim ndërkombëtar mosndërhyrja

në punët e brendshme të një shteti. Është e palejueshme dhe padyshim mënyra si janë artikuluar qëndrimet e këtyre dy vendeve, s'mund të lejohet. Dy partitë duhet të mbahen brenda vetes, të ulen, të bashkëpunojnë.

Turqia dhe Greqia kanë mosmarrëveshje brenda vetes për probleme të hapura dhe nuk duhet të ndërhyjnë në punët e brendshme të Shqipërisë. Të rrinë menjandë dhe të presin rezultatit e zgjedhjeve si dhe bashkëpunimin me qeverinë e ardhshme ta bëjnë me interes reciprok. Pse SHBA bëjnë deklarata asnjëanëse dhe nuk marrin anën e askujt? Sepse janë tepër konsequentë në qëndrimet e tyre. As nga BE s'ka qëndrimet të njëanshme".

LETRA E PERSONALIZUAR/ FALENDERON PËR MBËSHTETJEN E BESIMIT NË KËTO 2 VITE

Veliajt: Një lutje nga Kryetari i Bashkisë për qytetarët

Qytetarët e Tiranës kanë marrë dje një letër nga kryebashkiaku Erion Veliaj, përmes të cilës ai i falenderon me mirënjohje për mbështetjen e besimit që i kanë dhënë në këto dy vite, por nga ana tjetër i fton që, të dielën, më 25 qershor, t'i japin një dorë Kryeministrit Edi Rama për një mandat të dytë qeverisës. Në letërën e tij drejtuar të gjitha familjeve të Tiranës, të cilat e zgjedhën kryebashkiak në 2015, Veliaj u shpjegon se vota për Edi Ramën është një votë për më shumë investime në kryeqytet, duke iu kujtuar se falë mbështetjes që Kryeministri i ka dhënë Bashkisë së Tiranës, sot qyteti është më i dashur, më i pastër, më i gjelbër, me kopshte e çerdhe të standardeve më të larta, me parqe, kënde lojërash e hapësira sportive në shumë zona ku, deri dje, për më të moshuarit e për fëmijët,

kishte vetëm makina, gropa, pluhur. "Këndi i Lojërave të Liqeni mundi zhurmën dhe u pasua nga 17 të tjerë nëpër lagje. Pazarit i Ri nuk është më një rrënojë e zhytur në baltë e pisllek, por një nga destinacionet më të bukura të Tiranës. Bulevardi i Ri nuk është më një projekt i braktisur rrugëve dhe tashmë, segmenti i parë i kësaj vepre të madhe të Tiranës ka përfunduar. Parku Olimpik nuk është më një gërmadhë e braktisur, por një mjedis sportiv europian në çdo aspekt, ndërkohë që Sheshi Skënderbeu u është rikthyer qytetarëve, si një zemër e hapur mikpritëse e Shqipërisë së shekullit të ri", shkruan Veliaj. Ai i falenderon personalisht të gjithë qytetarët që i dhanë mundësinë unike për të shërbyer si administrator i kryeqytetit, por sipas tij, arritjet e deritanishme në Tiranë do të ishin të pamundura pa vëmendjen e vazhdueshme

dhe mbështetjen e pakursyer të Edi Ramës! "Me Edi Ramën kryeministër ne do të ndërtojmë 17 shkolla të reja, për t'i dhënë fund mësimin me dy turne; do të hapim Bulevardin e Ri në të gjithë gjatësinë e tij prej 1.7 kilometrash, duke sjellë zhvillim ekonomik dhe duke hapur mijëra vende të reja pune; do të përfundojmë Pyllin Orbital, i cili me mbi 2 milionë pemë të mbjella do të jetë jo vetëm një park i jashtëzakonshëm për qytetarët, por edhe mushkëria e gjelbër e Tiranës; do të ndërtojmë Terminalin Perëndimor dhe Unazën e Madhe, duke i dhënë një zgjidhje të qëndrueshme dhe afatgjatë problemit të qarkullimit në Tiranë. Për të rinjtë do të transformojmë Piramidën në një qendër moderne kulturore, kurse për fëmijët do kemi edhe një Kopësht Zoologjik e Botanik, më të bukurin në



Letra e Erion Veliajt për qytetarët

rajon, e plot të tjera që presin mbështetjen e qeverisë", thotë ai. Por, që ta kemi këtë mbështetje sa më të madhe, shkruan Veliaj, kjo është në dorë të qytetarëve, të cilët në 25 Qershor do të votojnë jo vetëm për Shqipërinë që duam, por edhe për këto projekte

të mëdha e për të ardhmen e Tiranës që duam. "Votoni për Tiranën që duam, me shtet, punë dhe mirëqenie dhe çka ne do të bëjmë së bashku me Edi Ramën, do të jetë shumë më shumë nga çka kemi bërë deri këtu", e mbyll ai letërën për familjet tiranase.

KORÇË

MAS: Shkelje në ndihmën ekonomike, mugon lista e përfituesve

Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, ka konstatuar shkelje në mënyrën e përdorimit të fondeve të ndihmës ekonomike në Korçë, ku mugonte lista emërore e përfituesve të ndihmës ekonomike që prej 4 muajsh. Mungesa e listave të familjeve që përfitojnë nga ndihma ekonomike, sipas Ministres Kërtusha, ngre dyshime për keqmenaxhim financiar, shpërdorim të detyrës apo korrupsion nga ana e punonjësve të përfshirë në proces, dhe se dyshohet se kjo është bërë për të favorizuar individë në mbështetje të fushatës zgjedhore për subjekte të caktuara politike. Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë i ka kërkuar Ministrisë së Financave, nisjen urgjent të inspektimit financiar. Problematika të ngjashme janë vërejtur edhe në Qarqet Tiranë, Durrës dhe Elbasan, për të cilat po bëhen verifikimet e nevojshme përpara se të merren masat përkatëse.

Shpëtim Idrizi mesazh nga Fieri: Mos e shisni të ardhmen

Kreu i PDIU: Nga Fieri nis fitorja e madhe, do të vazhdojë në të gjithë Shqipërinë

→ PËR ZGJEDHJET

Nga Fieri nis fitorja e madhe e PDIU-së, që do të vazhdojë në Shkodër, Lezhë, Tiranë, Elbasan, Durrës, Vlorë, Korçë dhe kudo ku ka shqiptarë patriotë që mendojnë si ne, që kemi "Veç një Atdhe".

për çështjen e shqiptarëve të Çamërisë", tha Idrizi.

FUSHATA

Kreu i PDIU, Shpëtim Idrizi theksoi se shqiptarët duhet të bashkohen rreth përkatësisë, rreth identitetit kombëtar, që fillon nga gjuha dhe nga Atdheu. "Është nga fushatat më të bukura që kemi bërë sepse ne i kemi folur njerëzve me zemër në dorë, i kemi dëgjuar ata. I kemi dëgjuar sepse deri më sot ne kemi parë që politika ka qenë e shurdhët



për ta. I kemi dëgjuar për hallet dhe problemet dhe i kemi folur me zemër në dorë për të gjitha problematikat që ata kanë. Sigurisht që kemi ndjerë që shqiptarët i ka ndarë varfëria, papunësia, padrejtësia e shumë gjëra të tjera. Por ne mendojmë miqtë e mi

që të gjithë si shqiptarë duhet të bashkohemi rreth përkatësisë tonë, rreth identitetit tonë kombëtar, që fillon nga gjuha, nga Atdheu, nga kombi, nga ajo që neve na bën të përbashkët si shqiptarë, e që na jep moton tonë që ne kemi "Veç një Atdhe", u shpreh ai.

NË FOTO: Shpëtim Idrizi gjatë takimit me banorët në Fier

Thirrja

Abaz Hado: Mos votoni për Vangjel Dulen

Kryetari i Shoqatës Çamëria, Dr. Abaz Hado në një letër drejtuar të gjithë shqiptarëve kudo ku janë, që do marrin pjesë në procesin e votimit këtë të diel, bën thirrje që të votohet PDIU-ja, pasi kryetari i kësaj partie ishte i vetmi që ngriti Çështjen Çame në parlamentin e Shqipërisë. Hado shprehet se PDIU-ja është e vetmja parti e që mbrojnë të drejtat e komunitetit çam, e cila është një zemër e një mendje me Çamërinë. Hado ka theksuar se vota për Vangjel Dulen është tradhti kombëtare.



"Ju jeni sot shpirti i fitores sonë sepse keni në dorë me votën tuaj, të pengoni që të mos futet në parlament një antishqiptar dhe një antiçam. Nëse për çdo lloj arsye ju votoni Vangjel Dulen, duhet të kuptoni se me këtë akt ju keni tradhtuar amanetin e të parëve tanë. Sot është ditë e madhe për të gjithë çamët. Kudo që jeni, kur të çoni një lule tek varrezat, ku janë eshtrat e të parëve tanë duhet të jeni me zemër e me mendje për Çamërinë. Ne nuk përulemi, se nuk mund të na ndalin tradhtarët. Ne jemi çamë. Zoti ju bekoftë", ka pohuar Hado.

PREMTIMI

Idrizi u shpreh se grupi parlamentar i PDIU-së në katër vitet e ardhshme do të ndërkombejarizojë dhe do t'i japi zgjidhje minimalisht çështjes ligjore të pronave të shqiptarëve të Çamërisë. "Dua sot t'i drejtohem jo vetëm shqiptarëve të Çamërisë, që për më shumë se 20 vjet ja kemi lënë në duar politikës shqiptare, na ka përdorur si rezervuar votash deri sa ne krijuam partinë tonë që është shtëpia e çdo shqiptari nga Preveza deri në Mollën e Kuqe. E këtu ne nuk do të kemi frikë për të plotësuar identitetin tonë kombëtar. Ne nuk po flasim për ndryshim kufijsh, por aty ku ka shqiptarë ka histori shqiptarë, është pjesë e identitetit tonë kombëtar të cilin do ta ruajmë sepse na përket neve shqiptarëve që mendojmë që kemi "Veç një Atdhe". Ne e kemi marrë çështjen e shqiptarëve të Çamërisë e kemi bërë pjesë të politikës shqiptare, e kemi bërë pjesë të diplomacisë shqiptare, e kemi bërë pjesë të Brukselit zyrtar. E tani kemi luftuar me paradigmën e stigmatizimit. E kemi marrë mitin e Sizifit në krahë e kemi çuar në majë të malit. E tani miqtë e mi unë ju them që grupi parlamentar i PDIU-së në katër vitet e ardhshme do të ndërkombejarizojë dhe do t'i japi zgjidhje minimalisht çështjes ligjore të pronave. Megjithatë unë e di që çështja e shqiptarëve të Çamërisë nuk është çështje pronash, por është çështje vatani dhe ne do t'i shkojmë deri në fund drejtësisë evropiane

VETINGU/ GODINA NË RIKONSTRUKSION, 1 MLD LEKË INVESTIM

Vendimi, zyrat e Vetingut të ish-Lidhja e Shkrimtarëve

Pas miratimit të anëtarëve të organeve të Vetingut, në secënën e jashtëzakonshme të 17 qershorit, qeveria shqiptare ka akorduar një fond prej 1 miliard lekësh për godinën, në të cilën do të ushtrojnë funksionet

stafi i Vetingut. Sipas vendimit të qeverisë, siguruar nga Report TV, organet e Vetingut do të ketë si godinë ish-Lidhjen e Shkrimtarëve, në rrugën e "Kavajës", e cila për disa kohë u përdor dhe si Ministria e Kulturës. Në vendimin numër Nr. 478,

datë 23.6.2017 të qeverisë, akordohet edhe fondi për mbulimin e shpenzimeve të restaurimit të ish godinës së lidhjes së shkrimtarëve, në varësi të Ministrisë së Kulturës, me qëllim akomodimin e organeve të Vetingut. Ndërkaq, ligji për Vetingun

ngarkon qeverinë për të siguruar ambiente për organet e Vetingut, të cilat do të hetojnë rreth 800 gjyqtarë dhe prokurorë, për ligjshmërinë e pasurive, lidhjet me krimin dhe aftësitë profesionale. "Ngarkohet Këshilli i Ministrave që, 30 ditë nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të marrë masat e nevojshme për të pajisur me zyrë institucionet e rivlerësimit, si dhe të krijojë kushtet e nevojshme të punës për zbatimin e gjithë kërkesave të këtij ligji. Me hyrjen në fuqi të këtij ligji, ngarkohet Shkolla e Magjistraturës të miratojë rregullat dhe procedurat e testimit, parashikuar në nenin 42, pika 2, shkronja "b", të këtij ligji. Brenda 30 ditëve nga krijimi i institucioneve të rivlerësimit, mbledhja e anëtarëve të Komisionit, mbledhja e gjyqtarëve dhe mbledhja e komisionerëve publikë kanë detyrimin të miratojnë



rregullat për veprimtarinë e institucioneve përkatëse të rivlerësimit", thuhet në ligjin e Vetingut. Ndërkaq, gjyqtarët kanë nisur një betejë të re në Gjykatën Kushtetuese, me qëllim për të deformuar ligjin e Vetingut. Por, kundër padisë së gjyqtarëve janë pozicionuar me shpejtësi një pjesë e politikës, sidomos Partia Socialiste, Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Bashkimi Evropian

OFERTË PUNËSIMI

Kompania mediatike Shqiptarja.com kërkon të punësojë agjent marketingu që plotëson kriteret e mëposhtme:

PERSONAT E INTERESUAR TË DËRGOJNË CV E TYRE NË ADRESËN:

marketing@shqiptarja.com

TË KETË ARSIM TË LARTË
TË KETË PËRVOJË PUNE
TË JETË I GATSHËM PËR TË PUNUAR NË TERREN

Vrasja e Tan Cukut në kërkim 2 persona që paguan ekzekutimin

Policia dhe prokuroria në ndjekje një nga Fieri e Vlora, dyshohet si financuesit

Marrin tjetër drejtim ngjarjet mbi vrasjen e Artan Cukut. Policia ka shpallur në kërkim 2 persona që dyshohen si pjesë e një bande që Artan Cuku e shkatërroi në kohën kur ishte drejtor i Policisë së Vlorës. Mësohet se Policia ka shpallur në kërkim dy persona një nga Fieri dhe një tjetër nga Vlora, të cilët dyshohet se kanë porositur vrasjen e Artan Cukut. Të njëjtat burime bëjnë me dije se, autori është një prej tyre, kur se vlonjati

bashkëpunëtor. Mendohet se fteraku i ka dhënë Mikel Shallarit një shumë financiare, për ekzekutimin e Artan Cukut. Mendohet se të dy personat e shpallur në kërkim, emrat e të cilëve

Hetimet

Grupi hetimor po vijon punën për zbulimin dhe arrestimin e urdhëruesve të vrasjes, por dyshimet janë se ajo ka ndodhur për shkak të detyrës gjatë kohës kur Cuku ka qenë në krye të policisë së Vlorës, ku ka goditur disa grupe kriminale.

nuk bëhen të ditur për arsye hetimore, kanë vepruar në të njëjtën bandë që u shkatërrua nga kryepolici i Vlorës, Artan Cuku. Të dy personat janë arrestuar në atë kohë, por sërish kanë mundur të

dalin nga qelia.

VRASJA PËR SHKAK TË DETYRËS

Duket se pas daljes nga burgu, ata kanë hartuar planin e hakmarrjes ndaj Cukut.

Në vitin 2012, Cuku rihapi një dosje të rëndë kriminale duke zbuluar bandën e rrezikshme. Thuhet se personi nga Fieri është një ndër personat më të rrezikshëm për Policinë Shqiptare. Kjo pistë që Cuku të jetë vrasë për shkak të detyrës vjen paralel me pistën tjetër, që vrasja e Cukut ka ndodhur për hakmarrje nga familja tropojane, djali i të cilëve u vra në zyrën e Cukut para shumë vitesh. Grupi hetimor po vijon punën për zbulimin dhe arrestimin e urdhëruesve të vrasjes, por dyshimet janë se ajo ka ndodhur për shkak të detyrës gjatë kohës kur Cuku ka qenë në krye të policisë së Vlorës, ku ka goditur disa grupe kriminale, ndonëse prokuroria ka dërguar kërkesën për masë sigurie në gjykatë me akuzën e gjakmarrjes.

I PRANGOSUR AUTORI MIKEL SHALLARI


Policia dhe Prokuroria e kanë të vërtetuar se ekzekutuesi komisarit Artan Cuku është 24-vjeçari nga Kuçova Mikel Shallari. Burime nga grupi hetimor kanë bërë me dije se AND-ja, e tij ka dalë e ngjashme me gjurmët e ADN-së së veshjes që u gjet afër vendit ku ndodhi vrasja. Këto gjurmë janë krahasuar me gjurmët që Shallari kishte në Zvicër, ku ka kryer një dënim për trafik të lëndëve narkotike. Ndërkohë 24-vjeçari nuk ka pranuar autorësinë për ngjarjen si dhe ka refuzuar të bashkëpunojë deri tani me policinë, duke pohuar se nuk ka lidhje me vrasjen e komisarit. Pas arrestimit të Mikel Shallarit, dyshimet e para u ngritën mbi familjen Daka, djali i të cilëve u vetëvra në zyrën e Artan Cukut. Por, babai i Agim Dakës, nëna Prelë Daka si dhe vëllezërit e të ndjerit deklaruan se familja e tyre nuk ka asnjë lidhje me vrasjen e komisar Artan Cukut duke qenë se këtë konflikt e kanë mbyllur para shumë vitesh.

NË KËRKIM

Mendohet se të dy personat e shpallur në kërkim, emrat e të cilëve nuk bëhen të ditur për arsye hetimore, kanë vepruar në të njëjtën bandë që u shkatërrua nga kryepolici i Vlorës, Artan Cuku.



Artan Cuku



Mikel Shallari

OPERACIONI

Futën tek të dënuarit thika e telefona, katër polici në pranga

Ndalohen 4 efektivë të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve Tiranë. Arrestimi i tyre është bërë nga policia e Elbasanit, pasi këta katër efektivë kanë shpërdoruar detyrën. Sipas Policisë, gjatë ushtrimit të detyrës, në ruajtje të personave të dëmtuar në spital, ata kanë lejuar futjen e sendeve të ndaluar nga ana e familjarëve tek të arrestuarit. Në pranga janë vënë Viktor Kalemi, Gëzim Muka, Adriatik Allushi dhe Pali Bushgjokaj, 56 vjeç, të katërt banues në Tiranë, me detyrë efektivë të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve Tiranë. Këta shtetas, u ndaluan pasi, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan me vendim penal më datë 22 qershor 2017, ka caktuar masën e sigurisë "Arrest me burg" për veprën penale "Shpërdorimi i detyrës". Sipas burimeve të policisë, efektivët e policisë së burgjeve kanë lejuar familjarët e të dënuarve, të fusin në dhomat spitalore aparate telefonike, duke i dhënë mundësi të dënuarve të komunikojnë me njerëzit e jashtëm. Njëherësh, në këto ambiente janë future dhe sende të prehta si thika, sende këto që në çdo situatë mund të përdoren nga të dënuarit për të vënë në zbatim një plan arratisje.

Çështja Cez

TIRANE

Ministri i Energjitikës Damian Gjicknuri dhe ish-drejtori i OSHEE Ardian Çela nuk janë paraqitur në senacën e djeshme gjyqësore kundër biznesmenit Kastriot Ismailaj, të akuzuar nga prokuroria e Tiranës për veprën penale të "Mashttrimit me pasoja të rënda". Të dy zyrtarët e lartë ishin thirur nga prokurorja e çështjes Antoneta Sedvarasi për të dëshmuar lidhur me çështjen e Cez, por pyetja e tyre nuk është arritur të rrealizohet. Sipas Gjykatës së Tiranës të dy personat kishin marrë dënim nga fletë-thirja e dërguar me postë, por nuk janë paraqitur për shkak të angazhimeve me fushatën elektorale, të partisë ku ata aderojnë. Tashmë dihet që Damian Gjicknuri është koordinatori i PS në Vlorë njëherësh dhe kandidati për deputet në këtë qark. Gjithashtu edhe ish-drejtori i OSHEE, është angazhuar së tepërmi me fushatën zgjedhore në qarkun e Durrësit. Nisur nga mungesa e tyre për të dëshmuar, trupi gjyqësor vendosi të shtyjë seancën gjyqësore kundër Kastriot Ismailaj, duke caktuar datën 7 korrik 2017. Pritet që në këtë seancë, të paraqiten për të dëshmuar Damian Gjicknuri dhe Ardian Çela. Ata do pyeten nga prokurorai dhe avokatët mbrojtës të Ismailaj, lidhur me kontratat e firmosura mes kompanisë së



Ardian Çela



Damian Gjicknuri

Gjicknuri-Çela, nuk shkojnë për të dëshmuar për Kastriot Ismailaj

Angazhimi në fushatë zgjedhore sjellin shtyrjen e gjyqit në Tiranë

biznesmenit Kastriot Ismailaj me korporatën energjitike Cez. Pagesat që janë kryer mes tyre etj. Momentalisht biznesmeni Kastriot Ismailaj është në gjyq me shtetin Shqiptar në gjykatën e Arbitrazhit, duke i kërkuar një sasi të konsiderueshme parash, pasi ai pretendon se ministria e

Energjitikës dhe OSHEE, ish-Cez-I, kanë prishur në mënyrë të njëanshme kontratën me kompaninë e tij. Kjo çështje vijon të jetë e hapur në gjykatën e Arbitrazhit ndërkohë biznesmeni vijon të qëndrojë në burg, për akuzën e "Mashttrimit me pasoja të rënda".



Kastriot Ismailaj

Abuzim me legalizimet KLSH, kallëzon 3 zyrtarë

Shumë banesa janë ndërtuar mbi rrugë dhe trotuare, ja rastet e abuzimit

ELTON QYNO
TIRANE

Një raport voluminoz i Kontrollit të Lartë të Shtetit ka zbuluar një sërë shkeljes në procedurat e legalizimit të objekteve në Tiranë, ku shumë banesa janë në fazën e legalizimit pavarësisht se janë të ndërtuara në rrugë, trotuare dhe vende të ndryshme publike. Bëhet fjalë për 41 njoalla të zeza në zonën e Drejtorisë ALUIZNI 2 në Tiranë, ku në total janë 204 objekte. Ndërkohë sipas KLSH shumë objekte janë legalizuar ndërkohë pa u plotësuar me dokumentacionin e nevojshëm dosja e aplikuesit, duke përfshirë këto deklarata notoriale të banorëve. Nisur nga kjo situatë, gazeta "Shqiptarja.com" mëson se nga ana e audituesve të Kontrollit të Lartë është rreferuar në prokurorinë e Tiranës, një indicia për ndjekjen penale për "Shpërdorim detyrë" për përgjegjësin e sektorit të hartografisë Arben Sevdari, përgjegjësin e sektorit të Urbanistikës Edvin Konica dhe ish-drejtoreshën e ALUIZNI 2 në Tiranë, Anila Naumi. Çështja ndaj këtyre tre personave që prej muajit Maj ndodhet në prokurorinë e Tiranës. Sipas KLSH këta tre zyrtarë kanë dëmtuar interesat e shtetit dhe favorizuar subjektet private.

DËMI 323 MILION LEKË

Konkretisht nga auditimi i ushtruar në ALUIZNI Tirana nr. 2, në 1660 raste në kualifikimin e objekteve informale, ALUIZNI ka dërguar pranë Bashkisë Tiranë vetëm shkresën për llogaritjen e pagesës e taksës së ndikimit në infrastrukturë, pa marrë konfirmim mbi pagesën e Taksës së Ndikimit në Infrastrukturë për dalje me vendim kualifikimi duke krijuar një mungesë të ardhurash në buxhetin e shtetit në vlerën 32,385,690 lekë. KLSH rekomandon që drejtoria ALUIZNI-t Tirana 2, të plotësojë dokumentacionin tekniko-ligjor të objekteve me lejeve të legalizimit të lëshuara, t'i kërkojë Bashkisë Tiranë vërtetimin mbi llogaritjen e likuidimit e Taksës së Ndikimit në Infrastrukturë për 1660 rastet në vlerën prej 32,385,690 lekë.

NUMRI I LEGALIZIMEVE

Për periudhën nga viti 2006 deri në 28 shkurt 2016, sipas pasqyrave të paraqitura dhe të digjitalizuara për objektet informale kërkesat për legalizim e shtesa anësore e në lartësi në objektet e ndërtuara para vitit 1993 dhe në objektet me leje ndërtimi (vetë deklarime) janë të dokumentuara 13739 kërkesa, nga e cila: për periudhën nga viti 2006 deri në 31 dhjetor 2012 janë të dokumentuara 7219 kërkesa. Nga auditimi u konstatua se 13739 kërkesat cituara më sipër të dhëna janë hedhur

NUMRIN E VETDEKLARIMEVE PER PERIUDHEN 2005 - 2016

NR	DREJTORIA TIRANA 2	
	Vetëdeklarimet sipas viteve	Nr. i Vetëdeklarimeve
1	2005-2006	6849
2	Subjektet me shkelje te lejes nga Bashkia Tiranë	370
3	2013	1236
4	2014	4491
5	2015	780
6	2016	13
TOTALI		13739

NUMRI I LEJEVE TE LESHUARA SIPAS PERIUDHAVE

Nr.	Periudha	Nr. Leje
1	01.06.2009 – 28.02.2012	735
2	01.06.2012- 30.09.2013	1300
3	01.01.2014 – 31.12.2016	2702
4	01.08.2014 – 31.12.2016	2620 (nga te cilat 536 leje janë te Kullat Hawaii)
TOTALI		4737

TOTALI VJETORI I LEGALIZIMEVE

Muajt	Viti 2014	Viti 2015	Viti 2016
	Përditësuar në terren	Përditësuar në terren	Përditësuar në terren
Janar	-	220	44
Shkurt	-	457	48
Mars	-	400	147
Prill	-	450	145
Maj	-	549	302
Qershor	-	579	228
Korrik	-	298	210
Gusht	-	172	180
Shtator	-	362	148
Tetor	-	217	207
Nëntor	52	218	228
Dhjetor	162	172	200
Totali	214	4094	2087

DOKUMENTACIONI

Sipas KLSH shumë objekte janë legalizuar ndërkohë pa u plotësuar me dokumentacionin dosja e aplikuesit, duke përfshirë këto deklarata notoriale të banorëve

në harta vetëm si njoalla dhe në azhurnimet nga Drejtoria ALUIZNI-t Tirana 2 nuk ka saktësime, se sa objekte ka

një njoallë ose sa procedues janë në të njëjtën njoallë të ardhura nga njësitë e Qeverisjes Vendore. Nisur nga të dhënat statistikore të vëna në disponim nga Drejtoria ALUIZNI-t Tirana 2, në total janë gjithsej 28164 objekte të vetë deklaruar duke marrë një mesatare 3 procedues në një njoallë. Të ndara sipas viteve vetë deklarimet rezultojnë: për vitin 2013 gjithsej 21657 objekte të vetë deklaruar, për vitin 2014 gjithsej 1236 objekte të vetë deklaruar; për vitin 2015 janë 4491 objekte të vetë deklaruar; për vitin

TE AKUZUARIT

Përgjegjësi i sektorit të hartografisë Arben Sevdari, përgjegjësi i sektorit të Urbanistikës Edvin Konica dhe ish-drejtoresha e ALUIZNI 2 në Tiranë, Anila Naumi

2016 janë 780 objekte të vetë deklaruar. Nga auditimi u konstatua se vetë deklarimet e përsëritura në vite për të



RASTET E SHKLEJEVE

- Dosja për **Bardhyl Dervishin**
- Dosja për **Zoi Toska**
- Dosja për **Ylli Hysaj**
- Dosja për **Frederik Seitin**
- Dosja për **Petrit Bakiun**
- Dosja për **Hiqmet Pampuri**
- Dosja për **Fatbardh Hoxhën**

njëjtin objekt nuk janë të evidentuara pra si rrjedhojë edhe shifra e vetë deklarimeve nuk ka saktësi. Duhet theksuar se ndryshimet e shpeshta të akteve ligjore e nënligjore të procesit të legalizimit të objekteve informate e kanë lehtësuar ndjeshëm procesin e legalizimit, gjë e cila ka ndikuar dhe në rritjen e numrit të lejeve nga njëra periudhë në tjetrën, kur nga 4737 leje të dhënë për periudhën 7 vjeçare (2009-2016) janë lëshuar mesatarisht 677 leje legalizimi në vit, për periudhën 2014-2016 janë dhënë 1310 leje legalizimi në çdo vit.

AKSIDENTI

Malësi e Madhe përplasen dy makina vdes 40-vjeçari



Një aksident ka ndodhur dje rreth orës 16:00 në rrugën Shkodër-Koplik vendi qujtur Ura Rrjollit, në Malësin e Madhe, ku për pasojë ka humbur jetën shtetasi B. H. rreth 40 vjeç. Në aksident u përfshinë automjeti tip Foristrade Mitsubish me targë AA 629 MO i cili është përplasur me mjetin tip Renault me tragë AA 397 GM. Drejtuesi i Mitsubishi nga Kopliku ka humbur jetën sapo ka mbërritur në Spitalin Rajonal Shkodrës, ndërsa drejtuesi i Renault me inicialet V. R. ndodhet në gjendje të rëndë për jetën. Grupi hetimor është nisur në vendngjarje për sqarimin e plotë të rrethanave të aksidentit.

10 VJET BURG

I dënuar në Itali, arrestohet shqiptari u vinte gjoba qytetarëve



Policia italiane ka bërë të mundur të vërë në pranga një shqiptar, i cili rezultonte i dënuar me 10 vjet burg. Arrestimi i tij ka ndodhur pasi është mësuar se gjobiste qytetarët. Sipas burimeve të mediave italiane, shqiptari është arrestuar në tunelin Mont Blanc. Edhe pse nuk bëhet i ditur identiteti i tij mësohet se shqiptari ishte i dënuar me 10 vjet burg dhe një gjobë prej 8 mijë eurosh. Tashmë atij i kanë mbetur pa shlyer edhe 3 vite e 10 ditë burgim, përveç gjobës. Ndërkohë shqiptari është dërguar në burg në Brissogne.

NA VIZITONI



BUNK'ART 2

EKSPOZITA VIDEO-MUZEALE BRENDË ISH-BUNKERIT ANTI-BËRTHAMOR I MINISTRISË SË BRENDSHME



www.bunkart.al / info@bunkart.al

**HAPUR ÇDO DITË:
10:00 deri 20:00**



**Prenotime:
+355 (0) 67 20 72 905**

**RR. "ABDI TOPTANI"
PRANË MINISTRISË
SË BRENDSHME-TIRANË**



Piktorët më të mirë shqiptarë, ekspozitë dedikuar fëmijëve

Veprat e piktorëve Abdurrahim Buza, Agim Faja, Guri Bulollari dhe Ledia Kostandini në GKA

Krijimtaria e përzgjedhur e katër artistëve Abdurrahim Buza, Agim Faja, Guri Bulollari dhe Ledia Kostandini, këtë herë u dedikohet në mënyrë të veçantë fëmijëve në një ekspozitë në Galerinë Kombëtare të Arteve. E titulluar "Bota e fëmijëve në Galerinë Kombëtare të Arteve", ekspozita i kushtohet krijuesve të vegjël. Kuratorët Esmeralda Dalipi dhe Bujana Demiraj, shprehen se kjo ekspozitë vjen përpara publikut si një "ditar" me ilustrime të realizuara ndër vite, në teknika të ndryshme, nga autorë të specifikave të ndryshme.

Drejtori i Galerisë Kombëtare të Arteve, Artan Shabani e quan një mrekulli faktin që piktorët më të mirë shqiptarë kanë pasqyruar botën e fëmijëve. "Kjo është një ekspozitë që i dedikohet botës së fëmijëve në artin shqiptarë, por dhe bota e fëmijës në pikturën Shqiptare, bota infantile tek adulti, është ajo botë jo e ndotur ajo botë e pastër e hapur e çiltër e kthjellë" tha Shabani.



Guri Bulollari, Artan Shabani dhe Ledia Kostandini

Ndërsa piktori autodidakt Guri Bulollari rrëfen motivet që e kanë frymëzuar për veprat e kësaj ekspozite. "Fëmija më prek në kujtesë në pasionet që ka fëmija, fantazinë që ka fëmija, por duhet ta dishë ta trajtohet, duhet të kesh shumë kujdes, duhet të jesh shumë inteligjent. Të gjithë njerëzit lindin engjëj, por pse behën pastaj të ndryshëm kalojnë në rrugë të keqe, sepse nuk kanë edukatën dhe kujdesin prindërorë" tha Bulollari.

Vepra e piktorit Abdur-

rahim Buza përballë veprës kapricioze të Guri Bulollarit, e bën këtë ekspozitë më të veçantë në komunikim tematik. Më tej është prezantimi i krijimtarisë së Agim Fajës, ilustrues brilant dhe krijues i teksteve letrare për më shumë se 50 vjet në Shqipëri. Fajës i njihen mbi 100 libra të ilustruar për fëmijë dhe të rritur. Përkrah tij gjenden veprat e Ledia Kostandinit, artiste e gjeneratës së re, e cila ilustron përmes mediumit të ri dixhital manual. Të gjithë këta artistë

të shquar të mbledhur së bashku në një ekspozitë në Galerinë Kombëtare të Arteve, bëhen një burim kurioziteti, jo vetëm për fëmijët, por për çdo moshë.

PROJEKTI

"Guri i qytetit të Përmetit" me një ndriçim dekorativ

Një projekt i Ministrisë së Kulturës dhe Institutit të Monumenteve të Kulturës rijetëzoi "Gurin e qytetit të Përmetit", monument kulture, nëpërmjet rikualifikimit të zonës, rivitalizimit e Gurit dhe kthimin e kësaj zone në pikë interesi. "Guri" ndodhet në veri të zonës qendrore të qytetit, është i vendosur në një hapësirë të gjelbër prej 4500 m2. Projekti konsiston në rijetëzimin e monumentit. Ideja kryesore është krijimi i një traseje përgjatë së cilës

do të ketë shkëmbim informacioni kulturor e artistik. Projekti bazohet në krijimin e tri hapësirave kryesore: tuneli, shkallët, rrënoja dhe në evidentimin e vlerave të tyre nëpërmjet ndriçimit dekorativ dhe funksional. Pamjet që ju tregojmë janë nga provat e fundit që mjeshtrat e ndriçimit kanë kryer dhe në mbremje. Tashmë ky ndriçim dekorativ do t'u shfaqet vizitorëve dhe banorëve si një mirëseardhje përmetare kur muzgu bie mbi qytetin e luleve.




Guri i qytetit të Përmetit

"EKRANI I ARTIT"

Formati i Lo Schemo dell'Arte për herë të parë në Shkodër

Art House sjell në korrik festivalin e filmat, 'Ekran i Artit', një përzgjedhje nga Lo Schermo dell'Arte Film Festival. Lo Schermo dell'Arte është një festival ndërkombehtar i filmat i cili organizohet që nga 2008 në qytetin e Firences në bashkëpunim me institucione kulturore, qendra për artin, akademi e universitete italiane e ndërkombehtar. I lindur si një projekt që kërkon të promovojë lidhjet mes artit bashkëkohor dhe kinemasë, në të prezantohen çdo vit filma, dokumentarë mbi artin bashkëkohor të shoqëruar me instalacione video, takime me artistë e kuratorë, rezidenca për artistë ndërkombehtar, produksione dhe shpërndarje të filmave. Në kuadër të bashkëpunimit me Art House, i mbështetur nga Instituti Italian i Kulturës, Tiranë, Ministria e Kulturës Code Partners, formati i Lo Schemo dell'Arte vjen për herë të parë në Shqipëri, në qytetin



e Shkodrës, me një përzgjedhje filmash, dokumentarësh, videosh që janë shfaqur ndër vite në këtë festival. Të ftuarit e veçantë për prezantimin e festivalit janë Silvia Lucchesi,

drejtoreshë e Lo Schermo dell'Arte, e Leonardo Bigazzi, kurator i projektit VISIO. Festivali i Filmit "Ekran i Artit" 7-9 korrik 2017, Art House, Shkodër.



The European Union Delegation to Albania is looking for a

Budget Officer

Functions include initiation of financial transactions, ensuring the conformity of procurements and grants with relevant regulations and preparation of financial reports, statistics and annual audit plans.

For complete information and application, please refer to:

https://eeas.europa.eu/delegations/albania_en

"Jobs & Funds" > "Jobs, Internships" > "Job offers"

We offer:

- Multicultural working environment
- Competitive salary
- Benefits by law

For all questions please refer to https://eeas.europa.eu/delegations/albania_en ("Jobs & Funds") or contact us via DELEGATION-ALBANIA-JOBS@eeas.europa.eu

Deadline for applications: **Monday, 10 July 2017**

I mashtroi ndërtuesi 7 familje "ngujohen" në prokurorinë e Tiranës

"Llanaj na mori truallin e tokës dhe nuk na
dha apartamentet dhe dyqanet që na takonin"

Na mori truallin e tokës dhe nuk na dha apartamentet dhe dyqanet që na takonin. Të futet në burg ndërtuesi". Kështu u shprehën për mikrofonin e "Report Tv" banorët e Unazës së Re nga oborri I Prokurorisë së Tiranës në godinën e së cilës denoncuan ndërtuesin Dritan Llanaj. Banorët e shtatë familjeve denoncuan tek prokurorja Suela Salavaçi ndërtuesin dhe organi i akuzës e thirri për ta marrë në pyetje Llanaj. Ata shprehn se Llanajn e kanë kallëzuar mbi 70 herë për mashtrim dhunë e presion, por ai vazhdon të jetë i lirë dhe pse i ka marrë 7 familjeve mbi 3300 m2 truall duke mos i dhënë asnjë hyrje apo dyqan. Në dalje të godinës, Llanaj tha se nuk ka asnjë deklaram për të bërë mbi çështjen, ndërsa banorët thonë të kundërtën.

BANORËT: E DUAM NË BURG NDËRTUESIN

Banorëve që po protestonin në oborrin e prokurorisë së Tiranës. Ata janë ngujuar në këtë pjesë të oborrit dhe thonë se nuk do të largohen deri në gjetjen e së drejtës së tyre. "Nënshkruam kontratat dhe kanë bërë një kontratë sipërmarrje me ndërtuesin Dritan Llanaj, për të ndërtuar një pallat në tokën e tyre. E kemi kallëzuar penalisht për



Familiarët e mashtruar nga ndërtuesi

dhunë fizike e psikologjike. Ai na ka marrë djersën, pronën e prindërve, ne e besuam dhe

nënshkruam dhe kontratën në prani të noteres, por dhe atë e kemi dërguar për ndjekje pe-



nale, pasi dhe ajo doli nga fjala. Ndaj si qytetarë të rregullt e të ndershëm, që paguajmë taksa

dhe i përgjigjen shtetit deri më 1, ne duam të drejtën tonë. Nuk duam që një individ si

Dritan Llanaj të jetë i qetë, të ndërtojë mbi kokën tonë duke zaptuar çfarë janë tonat dhe të rrahë dhe policinë. Sepse dhe këtë e ka bërë ai"-shprehen banorët.

NJË JAVË KOHË TË NJIHET ME ÇËSHTJEN

Banorët thonë se me kërkuesin e depozituar në prokurori presin që e drejta të jetë në anën e tyre, por prokurorja u ka kërkuar kohë për t'u njohur me çështjen. "Kemi bërë kallzim penal për dhunë, shpërdorim detyre thanë banorët. E kemi çuar në Polici, në Gjykatë. Duam të vendoset para ligjit Dritan Llanaj. Si mundet një njeri që shkel ligjin me të dykja këmbët dhe ligji nuk vepron për të? Ai vijon ende të jetë ndërtues? Prokurorja na dëgjoi dhe tha që kërkon kohë, të paktën 1 javë të njihet me çështjen". Banorët e "Unazës së Re" kanë 1 vit e gjysmë që presin të zgjidhet çështja. Ata kanë protestuar dhe më parë dhe çështja është bërë mediatike, pasi njëra nga banoret ka kërcënuar se do të vetëhidhej nga tarraca e pallatit të ri. Ngjarja u regjistrua me 1 Shkurt ku Enkelejda Ahmetaj, nënë e dy fëmijëve është ngjitur në tarracën e pallatit në ndërtim dhe ka qëndruar për rreth 2 orë aty, duke kërcënuar se do të hidhej. Por pavarësisht ngjarjes që bëri bujë disa muaj më parë, çështja e këtyre banorëve ka mbetur në vend numëro.

KISHIN NGRITUR SKEMË MASHTRIMI PËR TË FITUAR KREDI

"Kredia", pranga shtatë personave përfituan kredi me dokumente false

Shtatë persona kanë përfunduar në prangat e policisë së Tiranës gjatë një operacioni të koduar "Kredia", ndërsa një tjetër është shpallur në kërkim. Në pranga kanë përfunduar shtetasit: Arjel Sulejmanaj, Elsad Zhabjaku, Riselda Hoxha, Albert Shirka, Ertgrent Boshti, Luan Dana, Sonila Berberi. Gjithashtu është bërë

shpallja në kërkim e shtetasit R. H. "Për këta shtetas është arritur të dokumentohet me prova ligjore se në kohë të ndryshme duke përdorur dokumentacione të dyshuara të falsifikuara prej tyre, kanë përfituar kredi konsumatore në shumën të ndryshme pranë një Shoqërie Financiare që ofron kredi"-sëqaron poli-

cia. Pas zbulimit të kësaj skeme mashtrimi me dokumente të dyshuara të falsifikuara, është bërë arrestimi i shtetasve të sipër përmendur. Në cilësinë e provës materiale u sekuestruan dy vula të falsifikuara me logon "Instituti i sigurimeve shoqërore Tiranë", 8 vërtetime të institucionit të sigurimeve

shoqërore të dyshuara të falsifikuara. Materialet procedurale i kaluan Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, në ngarkim të shtetasve të sipër përmendur, për veprat penale, "Falsifikim i dokumenteve, i vulave, stampave dhe formularëve" dhe "Mashtrim me kredi" i kryer në bashkëpunim.



KALLËZIMI NGA BASHKËSHORTI

Largohet nga shtëpia me fëmijët e mitur, në kërkim nëna nga Kamza

Largohet së bashku me fëmijët e mitur jashtë vendit pa lejen e bashkëshortit, policia e Kamzës nis kërkimet për nënë 23 vjeçare me iniciale E.Z. Kallëzimi ndaj të resë është bërë nga bashkëshorti i saj 35 vjeçar se ka marrë fëmijët jashtë kufijve të Shqipërisë, pa lejen e tij. Nga verifikimet paraprake ka rezultuar se prej disa ditësh ajo nuk është gjetur në banesë po ashtu edhe fëmijët, ndërsa



shkak për këtë dyshohet një konflikt mes çifteve. Ngjarja i është referuar Prokurorisë së Tiranës, me akuzën marrja e padrejtë e fëmijës, duke e larguar prej personit që ushtron autoritetin prindëror, dhe po punohet për kapjen e shtetasës E.Z, vjeç 23, banuese në Durrës.

TRIM MURATAJ SHEF KRIMESH NË KRUIJË

Tiranë, shpërthen makina e një Polici të Krimeve të Rënda

Shpërthen me tritol makina e një Polici të krimeve të rënda të Komisarariatit të Kruijës. Ngjarja ndodhi dje rreth orës 03:55, ndërsa njoftimi u bë në numrin e emergjencave 112. Telefonata njoftonte për një shpërthim në rrugën "Kastriotët", në Tiranë. Në adresën e dhënë është konstatuar i dëmtuar në pjesën e përparme automjeti tip Mercedes Benz, në pronësi të shtetasit Trim Murataj, me detyrë oficeri

Policie i krimeve të rënda në Komisarariatit të Policisë Kruijës. Policia bën me dije se, dëmtimi i këtij automjeti ka ardhur si pasojë e shpërthimit të një sasive të vogël lënde plasëse të vendosur në pjesën e përparme të saj. Grupi hetimor po punon për identifikimin dhe kapjen e autorëve të kësaj veprë. Dyshohet se sasia e tritolit është vendosur poshtë makinës së oficerit të krimeve të rënda në Fushë-Kruijë për

ta parlarguar. Policia ka sekuestruar pamjet filmike në zonë, për të zbuluar se kush e ka vendosur tritolin. Ndërkohë pritet të merret në pyetje edhe oficeri i policisë Trim Murataj. Burime nga Policia thonë se qëllimi nuk ka qënë lëndimi i oficerit të policisë, por vetëm parlargimi, pasi tritolit menjëherë sapo është vendosur, është shpërthyer në një orar kur në zonë nuk kishte lëvizje të mjeteve apo njerëzve.




Trim Murataj

Informacioni
Byroja do të ketë informacion jo vetëm mbi borxhet që individët kanë në banka, por edhe faturat e papaguara të energjisë, ujit e telefonit



PROCESI
Drafti është përfunduar dhe u është shpërndarë grupeve të interesit. Menjëherë pas komenteve nga palët e interesuara ai do të hyjë në procedurë miratimi dhe pritet që shumë shpejt byroja të bëhet efektive

FALIMENTIMI
Ka nisur procesi i falimentimit për disa nga 35 kompanitë, që ishin në listën e kreditorëve më të këqij. 20% e 35 kompanive janë për proces falimenti, pra 7, të cilat nuk kanë përballuar dot ristrukturimin



Kreditë
Kredive me probleme në fund të prillit të këtij viti arritën në 16.5%, nga 25% që kishte qenë niveli më i lartë i tyre në shtator 2015

Nisma ligjore: Kërkohet krijimi i Byrosë së Kredive

Do të ketë informacion të hollësishëm lidhur me çdo detyrim që kanë qytetarët

Individët që kanë borxhe të pashlyera jo vetëm në banka, por edhe institucione të tjera publike dhe private do të jenë të identifikuar zyrtarisht. Banka e Shqipërisë ka hartuar një projektligj, i cili i hap rrugë ngritjes së Byrosë Kombëtare të Kredive, njoftoi dje Top Channel. Ndryshe nga regjistri aktual i kredive, byroja do të ketë informacion shumë më të hollësishëm mbi historikun financiar të çdo individ që ka një borxh. Ajo do të përmbajë informacion jo vetëm mbi borxhet që individët kanë në banka, por edhe detyrimet që ata kanë për faturat e papaguara të energjisë, ujit apo dhe faturave të telefonit. Byroja do të funksionojë me sistem pikëzimi, të ngjashëm me atë të patentës. Për individët të cilët nuk janë korrektë në shlyerjen e borxheve apo faturave do të ketë zbritje të pikëve. Ky sistem pikëzimi u mundëson bankave, por edhe institucioneve të tjera financiare, që të kenë një profil të saktë rreziku për çdo qytetarë apo biznes. Bazat për krijimin e byrosë kombëtare të kredive janë hedhur nga një marrëveshje mes Bankës Europiane për Rindërtim e Zhvillim dhe qeverisë shqiptare. Qëllimi i ngritjes së këtij institucioni është ulja e kredive të këqija dhe parandalimi i krijimit të kredive të reja problematike, pasi bankat do ta kenë më të lehtë të evidentojnë qytetarët dhe bizneset që nuk janë korrektë në shlyerjen e borxheve. Burime nga Banka e Shqipërisë thonë se drafti është përfunduar dhe u është shpërndarë grupeve të interesit. Menjëherë pas komenteve nga palët e interesuara



ai do të hyjë në procedurë miratimi dhe pritet që shumë shpejt byroja të bëhet efektive.

KOMPANITË

Ndërkohë, ekspertët e Bankës së Shqipërisë, gjatë prezantimit

ditën e djeshme të Raportit Vjetor të Mbikëqyrjes së vitit 2016, kanë bërë të ditur se ka nisur procesi i falimentimit për disa nga 35 kompanitë, që ishin në listën e kreditorëve më të këqij. Këto kompani nuk kanë arritur që të kalojnë procesin e ris-

trukturimit. 20% e 35 kompanive janë për proces falimenti, pra 7 prej tyre. Më herët, Banka e Shqipërisë kishte bërë të ditur se nga 35 kompani janë ristrukturuar 21 prej tyre. Nga 21 kompanitë e ristrukturuara, 10 prej tyre nuk janë më në vonesë,

duke bërë që ato të dalin përfundimisht nga lista e sipërmarrjeve problematike. Ndërsa për 11 të tjera procesi i ristrukturimit ka ecur, por do të duhet të kalojnë edhe pak muaj derisa ato të dalin nga lista e të këqijve. Më se një vit më parë, Banka e Shqipërisë njoftoi se 35 kompani të mëdha zotëronin rreth 60% të totalit të kredive me probleme në vend. Plani i institucionit monetar qendror për të ulur kredite e këqija, që arritën nivelin më të lartë në gati 25% në shtator 2014 dhe që qëndruan përgjithësisht mbi 20% në 2015-2016, kishte në fokus pikërisht ristrukturimin e këtyre kompanive problematike. Ristrukturimi i të mëdhenjve është një nga arsyet kryesore që ka çuar në uljen e kredive me probleme (NPL) muajt e fundit, të cilat në fund të muajit prill arritën në 16.5%, nga gati 25% që kishte qenë niveli më i lartë i tyre në shtator 2015. Burime nga Banka e Shqipërisë pohojnë se procesi i ristrukturimit ka qenë kompleks dhe për këtë arsye, ai është asistuar nga institucioni monetar qendror. Ristrukturimi ka përfshirë zgjatje të afateve të kthimit të huasë, apo ka pasur dhe raste kur bankat kanë marrë pronësinë e aseteve dhe i kanë dhënë ato me qira. Si rrjedhojë, numri i kompanive të mëdha që kanë nivel të lartë të kredive me probleme aktualisht ka zbritur në 25. Ndërsa 11 janë në proces ristrukturimi, siç u përmend më sipër, mbeten edhe 14 të tjera jashtë këtij procesi. Nga këto 14 sipërmarrje, një pjesë nuk kanë më shpresë për arkëtim, ndërsa për të tjera nuk është gjetur zgjidhje dhe për një pjesë të tyre tashmë ka nisur procesi i falimentimit.

BILANCI / GRUPI I PUNËS ZBULON FATURA TË PASHLYERA NDAJ PRIVATIT

Rikthehen detyrimet e prapambetura të shtetit

Me 320 mln euro të reja, borxhi publik arrin 73% të PBB

Nëse borxhit publik do t'i shtoheshin të paktën 32 miliardë lekë detyrime, që një grup pune në ministrinë e Financave i ka identifikuar si të prapambetura, atëherë ai do të kërcente në 1.098 trilionë lekë, shifër sa 73% e PBB-së. Teksa mandati qeverisës është në fund të tij, buxheti i shtetit mbart detyrime të fshehura në më shumë se 300 milionë euro, të cilat nuk janë përfshirë në treguesin e borxhit publik, i cili, edhe pa këto detyrime, e mbylli vitin 2016 në 71.01% e PBB-së. Grupi i punës është duke hasur në vështirësi pasi institucionet refuzojnë të bëjnë transparente të gjitha faturat e pashlyera dhe shifra nuk është përfun-



dimtare, por duhet të jetë në nivelin 320 milionë euro. Detyrimet e reja janë krijuar nga borxhet që institucionet e shtetit kanë ndaj bizneseve për punime të papaguara në rrugë, rimbursim TVSH-je dhe gjyqe të humbura. Fatura është rënduar edhe nga borxhet e pushtetit lokal dhe faturat e papaguara të energjisë për vitet 2014-2015 nga Entet Publike. Nga shuma 32 miliardë lekë e krijuar deri në fund të vitit 2016, detyrimet ndaj biznesit (rimbursim TVSH-je dhe punimet e papaguara të rrugëve) janë 5.8 miliardë lekë, sipas të dhënave zyrtare nga Autoriteti Rrugor Shqiptar dhe Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve. Nga detyrimet e

reja, 8 miliardë lekë, apo 25%, janë fatura të papaguara të energjinë nga entet publike, kryesisht njësitë e pushtetit vendor me ndërmarrjet e ujësjellësit, sipas të dhënave zyrtare Enti Rregullator i Energjisë. Detyrimet e tjera me vlerë 8.9 miliardë lekë (65 mln euro) rezultojnë si detyrim që pushteti lokal ka ndaj të tretëve për mallra dhe shërbime. Mbi 8 miliardë lekë detyrime të tjera janë fatura që vijnë nga humbja e gjyqeve të shtetit shqiptar me të tretët. Avokati i Shtetit, në bilancin e punës që ka bërë për vitin 2016, njoftoi se çështjet e humbura në gjykatat shqiptare në dem të shtetit janë arritën mbi 8 miliardë lekë, ose 58 milionë euro.

Provimet me zgjedhje, ja përgjigjet e sakta

MAS: Do marrin pikë edhe përgjigjet e përafërta. Skema është orientuese për maturantët

Publikohen përgjigjet e sakta të provimeve me zgjedhje. Më shumë se 40 mijë maturantë u testuan ditën e djeshme, ku dhanë provimet me zgjedhje, që janë një ndër komponentët për tu pranur në Universitet. Gazeta publikon sot çelsin e përgjigjeve të sakta

për lëndët me të zgjedhura nga maturantët, siç janë Sociologjia, Qytetaria, Psikologjia etj.

TESTIT

Testi kishte 20 pyetje, ku 10 prej tyre ishin me alternativa, ndërkohë që 10 të tjera me zhvillim. Të dy provimet maturantët i dhanë për 3 orë,

ndërkohë që kishte masa të repta kontrolli.

DEL TEZA

Por pavarësisht masave, një pjesë e tezave të provimeve me zgjedhje kanë dalë në rrjetet sociale. Tezat janë publikuar në kohën që po zhvillohej provimi. Të njëjtat probleme

janë vërtur edhe në provimet e tjera të maturës shtetërore.

GJUHË-LETËRSIA

Pritet që brenda javës së ardhshme të publikohen notat e provimit të Gjuhë-Letërsisë, ndërkohë që deri me tani kanë dalë vetëm notat e provimit të gjuhës së huaj.



REPUBLICA E SHQIPËRISE
MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SPORTIT
QENDRA E SHËRBIMEVE ARSIMORE

PROVIMI ME ZGJEDHJE I MATURËS SHTETËRORE 2017
SESIONI I

SKEMA E VLERËSIMIT VARIANTI A

Lënda: Gjuhë Angleze (Niveli B2)

READING SECTION

For the open-ended questions, answers may be brief or may be written in full sentences. Accept either provided the information in the key is included. Do not take marks off for incorrect grammar or spelling in a longer answer. Do not accept answers which are too long and contain irrelevant information.

Questions	Answers	Points
1	C	1
2a	At the end of the school year.	1
2b	It is regarded as a major event.	1
3a	They vote before the Prom is held.	1
3b	Because of (Due to) the influence of US TV shows and movies.	1
4a	The night time dance.	1
4b	The Prom.	1
5	A	1
6	B	1
7a	Rin Tin Tin	1
7b	The pet cemetery is usually referred as the dog cemetery. / The dog cemetery.	1
8a	Madame Toussauds	1
8b	The ballroom / the circular ballroom	1
9a	He was adopted by an American soldier in WWI	1
9b	Beautiful old posters advertising magic shows / Posters advertising magic shows	1
10	D	1

©QSHA Gjuhë Angleze (B2) 23 qershor, 2017
Anglisht variantia a, niveli b2, (faqe 1)

USE OF LANGUAGE SECTION

Questions	Answers	Points
11	B	1
12	A	1
13	B	1
14	D	1
15	C	1
16	D	1
17a	unconscious	1
17b	unprofessional	1
17c	obedient	1
18a	looking forward to going on holiday	1
18b	game has been called off by	1
18c	had better shave (get shaved) before	1
19a	them	1
19b	due	1
19c	in	1
19d	more	1

WRITING SECTION

The writing section is scored out of a total of eight points. There are four criteria, each of which receives two points. Candidates whose writing ability for a criterion is considered to be below the minimum acceptable standard for B2 Level receive 0 points for that criterion. Candidates whose writing ability is judged to be at the minimum standard for B2 Level receive 1 point for that criterion. Candidates whose ability for a criterion is considered to be above the minimum level for B2 receive 2 points for that criterion. The number of points for each criterion is added together to give a total score out of eight.

A successful student at minimum B2 level:

- Can write an essay or report which develops an argument, giving reasons in support of or against a particular point of view and explaining the advantages and disadvantages of various options.
- Can write clear, detailed descriptions on a variety of subjects related to his/her field of interest.
- Can write a review of a film, book or play.

©QSHA Gjuhë Angleze (B2) 23 qershor, 2017
Anglisht variantia a, niveli b2, (faqe 2)

Writing Descriptors

Points	Description	Topic Development	Organization	Range	Accuracy
0	Below minimum B2 level	Text is often irrelevant to the task. Text is much too short. The topic is not sufficiently developed and little or no supporting detail is provided.	Ideas are inadequately organized, which may cause confusion for the reader. Only very simple connectors are used, e.g. and, but. There is no introduction and conclusion or they are not relevant.	A limited range of grammar and vocabulary is usually used in attempting to fulfill the task.	Frequent errors occur in both simple and complex structures, and often impede communication. Vocabulary is sometimes used inappropriately.
1	At minimum B2 level	Text is mostly relevant to the task. The topic is sufficiently developed, but without much supporting detail.	Ideas are usually adequately organized. Linking devices are used, often appropriately. There is an introduction and conclusion, but they may not be completely relevant.	A sufficient range of grammar and vocabulary is used in order to fulfill the task.	Errors only occasionally occur in basic structures, but may sometimes occur in more complex structures. Vocabulary resources are often used appropriately.
2	Above minimum B2 level	Text is fully relevant to the task. The topic is fully developed and has appropriate supporting details.	Ideas are clearly organized. Linking devices are mostly used appropriately and effectively. The introduction and conclusion are relevant and effective.	A broad range of grammatical structures and vocabulary is mostly used.	Errors mostly do not occur in basic structures. Errors in more complex structures do not usually impede communication. Vocabulary resources are usually used appropriately.

©QSHA Gjuhë Angleze (B2) 23 qershor, 2017
Anglisht variantia a, niveli b2, (faqe 3)

REPUBLICA E SHQIPËRISE
MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SPORTIT
QENDRA E SHËRBIMEVE ARSIMORE

PROVIMI I MATURËS SHTETËRORE 2017
SESIONI I

VARIANTI A

E enjte, 15 qershor 2017 Ora 10.00

Lënda: MATEMATIKË (GJIMNAZI)

ZGJIDHJE

1. Përgjigjet për pyetjet 1-13.

Pyetja	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13
Alternativa e sakta	A	D	D	C	A	C	D	A	B	C	B	A	B

2. Një mënyrë zgjidhje për pyetjet 14-25

14. 3 pikë

$3^{2-5} = (3^2)^{-3}$
 $3^{2-5} = 3^{4x} \Leftrightarrow x^2 - 5 = 4x \Rightarrow x^2 - 4x - 5 = 0$
 $D = 36$
 $x_1 = 5$
 $x_2 = -1$
 $A = \{-1, 5\}$

©QSHA 1 15 qershor 2017
Matematike gjimnaz (faqe 1)

Matematikë (Gjimnaz) Varianti A

15. 3 pikë

a) Për të studiuar monotoninë e funksionit, studiojmë shenjë e derivatit të parë për cdo $x \in \mathbb{R}$.
 $f'(x) = 6 - 3x^2$
 $f'(x) = 0 \Rightarrow 6 - 3x^2 = 0 \Rightarrow 3x^2 = 6 \Rightarrow x^2 = 2 \Rightarrow x_1 = \sqrt{2}; x_2 = -\sqrt{2}$

Në intervalin $]-\infty; -\sqrt{2}[$ funksioni është zbritës
 Në intervalin $]-\sqrt{2}; \sqrt{2}[$ funksioni është rritës
 Në intervalin $]\sqrt{2}; +\infty[$ funksioni është zbritës

b) 2 pikë

Studiojmë shenjë e derivatit të dytë:
 $f''(x) = -6x$
 $f''(x) = 0 \Rightarrow -6x = 0 \Rightarrow x = 0$
 $f(0) = 0$
 Pika e infleksionit P(0,0)

16. 3 pikë

$(l_{ij}) \perp (d) \Rightarrow k_{ij} \cdot k_d = -1$ Por $k_{ij} = 1 \Rightarrow k_d = -1$
 Pra, $k_{ij} = -1$. Ekuacioni i tangjentes ka trajtën: $y = -x + t$
 Nga kushti i tangjencës së drejtëzës me elipsin kemi: $a^2k^2 + b^2 = t^2 \Rightarrow t = \pm 5$
 Ekuacionet e tangjenteve janë: $y = -x + 5$ dhe $y = -x - 5$

17. 3 pikë

Piramida e rregullt 4-këndore \Rightarrow ABCD katror
 $SO \perp$ pl(ABCD) ku O-qendra e katrorit.
 $SE \perp BC$ (ku SE apotema)
 $SO \perp$ pl(ABCD) $\Rightarrow SO \perp OE$
 $OE \perp$ praj \perp i SE në pl(ABCD)
 $SO \perp OE$ dhe $SE \perp BC$ nga teorema e 3 $\perp \Rightarrow OE \perp BC$
 Nga ndërtimi m(SEO) = 30°. Në trekëndëshin SOE, $OS = \frac{1}{2} SE$, $OS = 4$ cm
 Në Δ kënddrejtë SOE kemi: $OE = SE \cos 30^\circ = 8 \cdot \frac{\sqrt{3}}{2} = 4\sqrt{3}$ cm.
 Në Δ ACB, $OE \perp BC \Rightarrow OE \parallel AB \Rightarrow E$ mesi i BC $\Rightarrow AB = 2 \cdot OE = 8\sqrt{3}$ cm.
 $S_0 = (AB)^2 = (8\sqrt{3})^2 = 192$ cm²
 $V = \frac{1}{3} S_0 \cdot h = \frac{1}{3} \cdot 192 \cdot 4 = 256$ cm³

©QSHA 2 15 qershor 2017
Matematike gjimnaz (faqe 2)

Matematikë (Gjimnaz) Varianti A

18. 3 pikë

Skicojmë grafikët e funksioneve mbi të njëjtin sistem koordinativ:
 $y = 5 - x^2$ parabolë me kulm K(0,5)
 $y = 1$ drejtëz paralele me (OX)

Kufijtë e integrit: $y = 5 - x^2$ dhe $y = 1 \Rightarrow 5 - x^2 = 1 \Rightarrow x = \pm 2$

$S = \int_{-2}^2 (5 - x^2 - 1) dx = \int_{-2}^2 (4 - x^2) dx = (4x - \frac{x^3}{3}) \Big|_{-2}^2 = (8 - \frac{8}{3}) - (-8 + \frac{8}{3}) = \frac{32}{3}$ njësji katror.

19. 1 pikë

a) $y_3 = y_1 + 4d$
 $y_1 = 20$
 $d = -3 \Rightarrow y_3 = 8$

b) 2 pikë

$y_n = y_1 + (n-1)d \Rightarrow y_n = 20 + (n-1)(-3)$
 $y_n = 23 - 3n$
 $y_n < 0 \Rightarrow 23 - 3n < 0 \Rightarrow n > \frac{23}{3} \approx 7.66 \Rightarrow n = 8$

20. 2 pikë

$m_n = \frac{x_1 + x_2 + x_3 + x_4}{4} = 12 \Rightarrow x_1 + x_2 + x_3 + x_4 = 48$
 $m_5 = \frac{x_1 + x_2 + x_3 + x_4 + x_5}{5} = 16 \Rightarrow \frac{48 + x_5}{5} = 16 \Rightarrow 48 + x_5 = 80 \Rightarrow x_5 = 32$ vjec

21. 3 pikë

$E = \{x \in \mathbb{R} / 16 - x^2 \geq 0 \text{ dhe } x > 0\}$
 $K_1: 16 - x^2 \geq 0$
 $16 - x^2 = 0 \Rightarrow x = \pm 4$
 $E_1 = [-4, 4]$
 $K_2: x > 0 \Rightarrow E_2 =]0, +\infty[$
 $B.p.: E = E_1 \cap E_2$
 $E =]0, 4]$

©QSHA 3 15 qershor 2017
Matematike gjimnaz (faqe 3)

Matematikë (Gjimnaz) Varianti A

22. 3 pikë

Që funksioni të jetë i vazhdueshëm në $x=2$, duhet të plotësohen njëherazi 3 kushte:

- $Të \exists f(2), f(2) = 2A - 1$
- $Të \exists \lim_{x \rightarrow 2} f(x)$ dmth $\lim_{x \rightarrow 2} f(x) = \lim_{x \rightarrow 2} (x^2 - 4) = 0$; $\lim_{x \rightarrow 2} (Ax - 1) = 2A - 1 \Rightarrow 0 = 2A - 1 \Rightarrow A = \frac{1}{2}$
- Duhet që $\lim_{x \rightarrow 2} f(x) = f(2) \Rightarrow 0 = 2A - 1 \Rightarrow A = \frac{1}{2}$

Përgjigje: Për $A = \frac{1}{2}$ funksioni është i vazhdueshëm në $x=2$

23. 2 pikë

a)

$$(BC) : \frac{x-x_1}{x_2-x_1} = \frac{y-y_1}{y_2-y_1}$$

$$(BC) : \frac{x-2}{-4-2} = \frac{y+1}{1+1} \Rightarrow 2(x-2) = -6(y+1)$$

$$(BC) : 2x - 4 = -6y - 6 \Rightarrow 2x + 6y + 2 = 0 \text{ ose } x + 3y + 1 = 0$$

b) 3 pikë

$S_{BAC} = \frac{BC \cdot AH}{2}$

$BC = \sqrt{(x_2 - x_1)^2 + (y_2 - y_1)^2}$

$BC = 2\sqrt{10}$ njësi

AH është largesa e pikës A(0;3) nga drejtëza (BC): $x + 3y + 1 = 0$

$AH = \frac{|1 \cdot 0 + 3 \cdot 3 + 1|}{\sqrt{1^2 + 3^2}} = \frac{10}{\sqrt{10}} = \sqrt{10}$ AH = $\sqrt{10}$ njësi

$S_{BAC} = \frac{2\sqrt{10} \cdot \sqrt{10}}{2} = 10$ njësi katrorë

Matematike gjimnaz (faqe 4) 4 15 qershor 2017

Matematikë (Gjimnaz) Varianti A

24. 2 pikë

$n(H) = 6 - 6 = 36$

$n(A) = 15$

$P(A) = \frac{n(A)}{n(H)} = \frac{15}{36} = \frac{5}{12}$

25. 2 pikë

Në ΔABC zbatojmë Teoremën e sinusit.

$$\frac{AC}{\sin 60^\circ} = \frac{BC}{\sin x}$$

$$\frac{\sqrt{3}}{\sin 60^\circ} = \frac{\sqrt{2}}{\sin x} \Rightarrow \sin x = \frac{\sqrt{2} \cdot \sin 60^\circ}{\sqrt{3}}$$

$$\sin x = \frac{\sqrt{2}}{2} \Rightarrow x = 45^\circ$$

Matematike gjimnaz (faqe 5) 5 15 qershor 2017

REPUBLIKA E SHQIPËRIE
MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SPORTIT
QENDRA E SHËRBIMEVE ARSIMORE

PROVIMI I MATURËS SHITËTORE 2017

SESIONI I

VARIANTI A

E enjte, 15 qershor 2017 Ora 10.00

Lënda: MATEMATIKË (GJIMNAZI GJUHËSOR)

ZGJIDHJE

1. Përgjigjet për pyetjet 1-13.

Pyetja	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13
Alternativa e sakte	A	C	B	C	D	A	A	B	C	B	A	B	D

2. Një mënyrë zgjidhje për pyetjet 14-25

14. 2 pikë

$$m = \frac{6 + 8 + (x+2) + 10 + (2x-1) + 2}{6} = 8$$

$$27 + 3x = 48$$

$$3x = 21$$

$$x = 7$$

Matematike gjimnaz gjuhësor (faqe 1) 15 qershor 2017

Matematikë (Gjimnaz gjuhësor) Varianti A

15. 2 pikë

$n(H) = 20$

$A = \{4, 8, 12, 16, 20, 5, 10, 15\}$

$n(A) = 8$

$P(A) = \frac{n(A)}{n(H)} = \frac{8}{20} = \frac{2}{5}$

16. 1 pikë

a)

Piramidë e rregullt 3-këndore $\Rightarrow \Delta ABC$ barabrinjës.

$b = 12 \text{ cm}$

$SO \perp \text{pl}(ABC) \Rightarrow O$ qendra e ΔABC

$S_1 = \frac{P \cdot \text{apotemë}}{2}$

$S_1 = \frac{3 \cdot 12 \cdot 4}{2} = 72 \text{ cm}^2$

b) 3 pikë

$V = \frac{1}{3} S_1 \cdot h$

$S_1 = \frac{b^2 \sqrt{3}}{4} = \frac{12^2 \sqrt{3}}{4} = 36\sqrt{3} \text{ cm}^2$

$SO \perp \text{pl}(ABC)$, SE e pjerret $\Rightarrow OE = \text{proj. } \perp$ i SE

Meqë SE (apotemë) $\perp BC \Rightarrow$ nga T e 3.1: $OE \perp BC$

$OE = \frac{1}{3} AE$ ku $AE = \frac{b\sqrt{3}}{2} = \frac{12\sqrt{3}}{2} = 6\sqrt{3} \Rightarrow OE = 2\sqrt{3}$

Në Δ kënddrejtë SOE: $SO^2 = SE^2 - OE^2 = 4^2 - (2\sqrt{3})^2 = 16 - 12 = 4$

Pra, $SO = 2 \text{ cm}$

$V = \frac{1}{3} \cdot 36\sqrt{3} \cdot 2 = 24\sqrt{3} \text{ cm}^3$

17. 2 pikë

a)

Ekuacioni i thjeshtuar i hiperbolës:

$$\frac{x^2}{5} - \frac{y^2}{4} = 1$$

$a^2 = 5 \Rightarrow a = \sqrt{5}$

$b^2 = 4 \Rightarrow b = 2$

$c^2 = a^2 + b^2 = 5 + 4 = 9 \Rightarrow c = 3$

Matematike gjimnaz gjuhësor (faqe 2) 15 qershor 2017

Matematikë (Gjimnaz gjuhësor) Varianti A

b) 2 pikë

$k_w = k_y = -2$

$(t_y): y = -2x + t$

Nga kushti i tangjencës: $a^2 k^2 - b^2 m^2 = t^2$

$5(-2)^2 - 4 = t^2 \Rightarrow t^2 = 16 \Rightarrow t = \pm 4$

$(t_y): y = -2x \pm 4$

18. 3 pikë

Për të studiuar përkulshmërinë e grafikut të funksionit studiojmë shenjen e derivatit të dytë:

$y' = (x^2 - 3x^2 + x + 7)' = 3x^2 - 6x + 1$

$y'' = (3x^2 - 6x + 1)' = 6x - 6$

$y'' = 0 \Rightarrow 6x - 6 = 0 \Rightarrow x = 1$

Në intervalin $]-\infty; 1[$ grafiku i funksionit është i mysjet

Në intervalin $]1; +\infty[$ grafiku i funksionit është i luget

$f(1) = 1^3 - 3 \cdot 1^2 + 1 + 7 = 6$

Pika P(1;6) është pike infleksioni.

19. 3 pikë

Bashkësia e vlerave të lejuara të x-it është: $\begin{cases} x > 0 \\ 6 - x > 0 \end{cases} \Rightarrow \begin{cases} x > 0 \\ x < 6 \end{cases} \Rightarrow E =]0; 6[$

Për cdo $x \in E$: $\log x = \log(6 - x) \Rightarrow x = 6 - x \Rightarrow 2x = 6 \Rightarrow x = 3$, por $3 \in E \Rightarrow$ Bashkësia e zgjidhjeve $A = \{3\}$

20. 3 pikë

Bashkësia e përcaktimit: $\begin{cases} x \geq 0 \\ 3 - x > 0 \end{cases} \Rightarrow \begin{cases} x \geq 0 \\ x < 3 \end{cases} \Rightarrow E = [0; 3[$

Matematike gjimnaz gjuhësor (faqe 3) 15 qershor 2017

Matematikë (Gjimnaz gjuhësor) Varianti A

21. 2 pikë

$P = 8 \text{ cm} \Rightarrow b = 2 \text{ cm}$

$S = b \cdot h$

$S = 2 \cdot \sqrt{3} = 2\sqrt{3} \text{ cm}^2$

Në kënddrejtë AHD $\Rightarrow \sin \alpha = \frac{DH}{AD}$

$\sin \alpha = \frac{\sqrt{3}}{2} \Rightarrow \alpha = 60^\circ$

pra $m(\widehat{DAB}) = 60^\circ$ dhe $m(\widehat{ABC}) = 120^\circ$

22. 3 pikë

Për $x > 1$, $f(x) = 5 + Mx$ është i vazhdueshëm si funksion i zakonshëm.

Për $x < 1$, $f(x) = x^2 + 1$ është i vazhdueshëm si funksion i zakonshëm.

Që funksioni të jetë i vazhdueshëm në $x=1$, duhet të plotësojë njëherazi 3 kushte:

- $Të \exists f(1): f(1) = 1^2 + 1 = 2$
- $Të \exists \lim_{x \rightarrow 1} f(x)$ pra $\lim_{x \rightarrow 1} x^2 + 1 = 2$; $\lim_{x \rightarrow 1} (5 + Mx) = 5 + M$ duhet $2 = 5 + M \Rightarrow M = -3$ Atëherë $\lim_{x \rightarrow 1} f(x) = 2$
- $f(1) = \lim_{x \rightarrow 1} f(x)$. Për $M = -3$ kemi: $f(1) = 2 = \lim_{x \rightarrow 1} f(x)$

Përgjigje: Për $M = -3$ funksioni është i vazhdueshëm në R.

23. 3 pikë

a)

Për të studiuar monotoninë e funksionit, studiojmë shenjen e derivatit të parë për cdo $x \in R$.

$y'(x) = (1 + 2x - x^2)' = 2 - 2x$

$y' = 0 \Rightarrow 2 - 2x = 0 \Rightarrow x = 1$

Në intervalin $]-\infty; 1[$ funksioni është rritës

Në intervalin $]1; +\infty[$ funksioni është zbritës

Matematike gjimnaz gjuhësor (faqe 4) 15 qershor 2017

Matematikë (Gjimnaz gjuhësor) Varianti A

b) 2 pikë

Ekuacioni i tangjentës ka trajtën: $y - f(2) = f'(2)(x - 2)$

$f(2) = 1 + 2 \cdot 2 - 2^2 = 1$

$f'(2) = 2 - 2 \cdot 2 = -2$

$(t_y): y - 1 = -2(x - 2)$

$y - 1 = -2x + 4$

$(t_y): y = -2x + 5$

24. 3 pikë

Skicojmë grafikët e funksioneve mbi të njëjtin sistem koordinativ:

$y = x^2 + 2$ parabolë me kulm K(0;2)

$y = 6$ drejtëz paralele me (OX)

Kufijtë e integritimit: $y = x^2 + 2$ dhe $y = 6 \Rightarrow x^2 + 2 = 6 \Rightarrow x^2 = 4 \Rightarrow x = \pm 2$

$S = \int_{-2}^2 (6 - (x^2 + 2)) dx = \int_{-2}^2 (4 - x^2) dx = (4x - \frac{x^3}{3}) \Big|_{-2}^2 = (8 - \frac{8}{3}) - (-8 + \frac{8}{3}) = \frac{32}{3}$ njësi katrorë.

25. 3 pikë

$\frac{3x}{2x-2} - \frac{2x}{x-1} = \frac{3x}{2x-2} - \frac{2x(x-1)}{2x(x-1)} = \frac{3x - 2x(x-1)}{2x(x-1)}$

Matematike gjimnaz gjuhësor (faqe 5) 15 qershor 2017

REPUBLIKA E SHQIPËRIE
MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SPORTIT
QENDRA E SHËRBIMEVE ARSIMORE

PROVIMI ME ZGJIDHJE I MATURËS SHITËTORE 2017

SKEMA E VLERËSIMIT TË TESTIT

Lënda: Psikologji

Udhëzime të përgjithshme

- Testi përbëhet në total 40 pikë.
- Testi ka 20 pyetje: 10 me zgjedhje dhe 10 me zhvillim.
- Për pyetjet me zgjedhje përgjigja e saktë vlerësohet me një pikë.
- Për pyetjet me zhvillim janë dhënë modele përgjigjesh të sakta.

Pyetjet me zgjedhje

Numri i Pyetjes	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
Përgjigja e saktë Varianti A	C	D	D	C	B	D	B	D	D	B
Përgjigja e saktë Varianti B	D	B	D	D	B	C	D	D	C	B

Pyetjet me zhvillim

Shënimi:

- Në skemën e vlerësimit të testit, për pyetjet me zhvillim janë dhënë modele përgjigjesh të sakta. Nxënësi do të marrë pikët e merituar edhe nëse ai ka dhënë përgjigje me fjalë të tjera, por që janë brenda kontekstit të përgjigjes së saktë.
- Në pyetjet me zhvillim, ku kërkohen dy, tre apo katër nga të gjitha përgjigjet e sakta të mundshme, në rast se nxënësi ka dhënë një përgjigje të saktë sa i kërkohen nga pyetja, atëherë atij do t'i jepen të gjitha pikët maksimale me të cilat është vlerësuar pyetja.
- Nxënësi do të marrë një pikë sa është vlerësuar pyetja edhe në rast se ai ka dhënë më shumë përgjigje të sakta nga sa i kërkohen.
- Nxënësi merr pikë duke dhënë përgjigje sipas formimit të tij edhe nga lëndët e tjera. Kalimi nga njëra pikë të tjera e një problemi nuk e ndëshkon në pikëzim, pasi ato lidhen me një-tjetrin.

Pyetja 11 3 pikë

- nuk lejon studiuesin që të kuptojë lidhjet shkak-pasojë të dukurive
- sjellja që vëzhgohet nuk mund të përsëritet sa herë dëshiron vëzhguesi
- në mjaft situata është i vështirë për t'u përdorur
- kekon shumë kohë

3 pikë Nëse shkruan saktë tre mangësi;

OSE

2 pikë Nëse shkruan saktë dy mangësi;

1 pikë Nëse shkruan saktë një mangësi;

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Psikologji (faqe 1) 23 Qershor 2017

Skema e vlerësimit të testit Psikologji

Pyetja 12 3 pikë

- ai që ndëshkon duhet ta bëjë të qartë se përse jepet ndëshkimi/cila është në mënyrë specifike sjellja që ndëshkohet
- ndëshkimi duhet bërë menjëherë pas kryerjes së një reagimi të padëshiruar/të jetë në përputhje me fortësinë e reagimit të padëshiruar
- ndëshkimi duhet të jetë i vazhdueshëm/nuk ka efekt nëse një individ i fliet një herë dhe nuk i fliet tjetër herë të tjera për të njëjtën sjellje të padëshiruar
- kur ndëshkohet një sjellje, individit i duhet shpjeguar dhe përfurcuar sjellja alternative pozitive

3 pikë Nëse shkruan tre këshilla;

OSE

2 pikë Nëse shkruan dy këshilla;

1 pikë Nëse shkruan një këshillë;

0 pikë Nëse përgjigjet gabim OSE nuk përgjigjet fare.

Pyetja 13 3 pikë

- për të qenë inteligjent, njeriu ka nevojë për shumë më tepër shkathtësi mendore
- përbehet nga tri shtylla
 - kontekstuale/afërsia e njeriut për të përdorur inteligjencën në situata specifike (është inteligjencë analitike)
 - eksperienciale/afërsia e njeriut për të përdorur përvojën që ka në botën që e rrethon (inteligjencë praktike)
 - komponenciale/mënyra që zgjedh njeriu për t'u marrë me informacionin (krijuese)

3 pikë Nëse shkruan tre aspekte nga teoria;

OSE

2 pikë Nëse shkruan dy aspekte nga teoria;

1 pikë Nëse shkruan një aspekt nga teoria;

0 pikë Nëse përgjigjet gabim OSE nuk përgjigjet fare.

Pyetja 14 3 pikë

- Është e inervuar në mënyrë të përshtatshme për të pikasur temperaturën/ presionin/shtypjen/dhimbjen.
- Përmban fibra të specializuara për të pikasur/transmetuar mesazhet se trupi po ftohet/ngrohet.
- truri njerezor ndërgjegjsohet për situatën dhe kërkohet një vend më të rehatshëm/veshjetë të tjera/ rregullim temperature.

Pyetja 15 2 pikë

- të jetë në një vend sa më të qetë, në mënyrë që atij që hipnotizohet të mos i tërhiqet vëmendja;
- atij që do të hipnotizohet i kërkohet të përqendrojë vëmendjen në një objekt;
- hipnotizuesi sugjestionon atë që do të hipnotizohet lidhur me atë çfarë do të përjetojë;
- hipnotizuesi vë në dukje disa përjetime që e di se do të ndodhin te individit.

2 pikë Nëse shkruan dy nga kushtet;

OSE

1 pikë Nëse shkruan një kusht;

0 pikë Nëse përgjigjet gabim OSE nuk përgjigjet fare.

Psikologji (faqe 2) 23 Qershor 2017

Skema e vlerësimit të testit Psikologji

Pyetja 16 **3 pikë**

- mendon në mënyrë abstrakte/shkon përtej asaj që kapur shqisat
- mendon në mënyrë logjike/përdor fakte dhe ide për të dalë në përfundime të tjera
- mendon në mënyrë hipotetike/ndëron hipoteza dhe vëzhgon mënyrën personale të të menduarit

3 pikë Nëse shkruan tre ndryshime;
OSE
2 pikë Nëse shkruan ndryshime;
1 pikë Nëse shkruan saktë një ndryshim;
0 pikë Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare

Pyetja 17 **3 pikë**

- mohimi/izolimi- njeriu nuk e pranon dot idenë se atij i ka ardhur vdekja/shkohet dhe nuk e beson
- zëmirimi- njeriu vlon nga inati që do t'i duhet të ikë dhe nga zilia që të tjerët do të jetojnë
- marrveshja- njeriu bën marrëveshje me veten për t'u sjellë në mënyra të caktuara/lutet të marrtoje ose shkolloje dike

3 pikë Nëse shkruan tre faza;
OSE
2 pikë Nëse shkruan dy faza;
1 pikë Nëse shkruan një fazë;
0 pikë Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare

Pyetja 18 **4 pikë**

- është e qëndrueshme;
- ndikon në të gjitha përshypjet/ njohjet tona për atë person më vonë;
- është më ndikues /mbresëlënës se informacioni i fundit;
- predispozohemi në prishshmëri tona ndaj tij.

4 pikë Nëse shkruan katër karakteristikat e kërkuara;
3 pikë Nëse shkruan tre karakteristikat e kërkuara;
2 pikë Nëse shkruan dy karakteristikat e kërkuara;
1 pikë Nëse shkruan një karakteristikë të kërkuar;
0 pikë Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.

3 23 Qershor 2017

Psikologji (faqe 3)

Skema e vlerësimit të testit Psikologji

Pyetja 19 **3 pikë**

- vëmendja tek sjellja që kryen modeli;
- të mbash mend atë që bën modeli;
- të riprodhosh atë që bën modeli;
- forca e modelit;
- personaliteti i atij që mëson;
- situata, etj.

3 pikë Nëse shkruan tre kushtet;
OSE
2 pikë Nëse shkruan dy nga kushtet;
1 pikë Nëse shkruan një kusht;
0 pikë Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.

Pyetja 20 **3 pikë**

- çdo stimul që rrit mundësinë e përsëritjes së një reagimi që kryhet para tij.
- ndjimi/imazh (pamor, dëgjimor ose i prekjes)/mendime dhe emocione që përjeton njeriu gjatë gjumit.
- paafësia për të kujtuar informacionin për arsye të traumave fiziologjike.

3 pikë Nëse shpjegon tre konceptet;
OSE
2 pikë Nëse shpjegon dy nga konceptet;
1 pikë Nëse shpjegon një koncept;
0 pikë Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.

4 23 Qershor 2017

Psikologji (faqe 4)

REPUBLIKA E SHQIPËRIË
MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SPORTIT
QENDRA E SHËRBIMEVE ARSIMORE

PROVIMI ME ZGJEDHJE I MATURËS SHTETËRORE 2017

SKEMA E VLERËSIMIT TË TESTIT

Lënda: Qytetari
Udhëzime të përgjithshme

- Testi përban në total 40 pikë.
- Testi ka 20 pyetje: 10 me zgjedhje dhe 10 me zhvillim.
- Për pyetjet me zgjedhje përgjigja e saktë vlerësohet me një pikë.
- Për pyetjet me zhvillim janë dhënë modele përgjigjesh të sakta.

Pyetjet me zgjedhje

Numri i Pyetjes	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
Përgjigja e saktë Varianti A	B	C	A	D	B	B	D	C	C	D
Përgjigja e saktë Varianti B	C	B	A	C	C	D	D	B	B	D

Pyetjet me zhvillim

Shënim:

- Në skemën e vlerësimit të testit, për pyetjet me zhvillim janë dhënë modele përgjigjesh të sakta. Nxënësi do të marrë pikët e merituar edhe nëse ai ka dhënë përgjigje me fjalë të tjera, por që janë brenda kontekstit të përgjigjes së saktë.
- Në pyetjet me zhvillim, ku kërkohen dy, tre apo katër nga të gjitha përgjigjet e sakta të mundshme, në rast se nxënësi ka dhënë sa përgjigje të sakta sa i kërkohen nga pyetja, atëherë atij do t'i jepen të gjitha pikët maksimale me të cilat është vlerësuar pyetja.
- Nxënësi do të marrë sa pikë sa është vlerësuar pyetja edhe në rast se ai ka dhënë më shumë përgjigje të sakta nga sa i kërkohen.
- Nxënësi merr pikë duke dhënë përgjigje sipas formimit të tij edhe nga lëndët e tjera. Kalimi nga njëra pikë të tjetra e një problemi nuk e ndëshkon në pikëzim, pasi ato lidhen me njëri-tjetrin.

Pyetja 11 **3 pikë**

- mbrojtja e pronësive/privat/publike;
- mbrojtja e bashkëpronësive/ligjore/me vullnet të lirë(ortakeri) etj.
- kontratrat/qratë/shit-blejjet/huatë bankare (të zakonshme mes njerëzve), etj.
- trashëgimia ligjore/testamentar/ dhurimi, etj.

Shënim: Nxënësi merr pikë edhe nëse e konkretizon përgjigjen me shembull.

Nxënësi fiton:
3 pikë Nëse shkruan saktë tri kategori;
OSE
2 pikë Nëse shkruan saktë dy kategori;
1 pikë Nëse shkruan saktë një kategori;

1 23 Qershor 2017

Qytetari (faqe 1)

Skema e vlerësimit të testit Qytetari

Pyetja 12 **3 pikë**

- Pushteti legjislativ ushtrohet nga Kuvendi, ndërsa pushteti gjyqësor ushtrohet nga gjykatat e Republikës së Shqipërisë. Personat që kryejnë detyrën e gjyqtarit nuk mund të ushtrojnë njëkohësisht detyra të tjera, qofshin ato publike apo private.
- Kuvendi është organi që miraton ligjet e një shteti dhe gjykatat janë të detyruara të zbatojnë këto ligje në zgjidhjen e çështjeve që paraqiten para tyre. Kjo nuk do të thotë që Kuvendi/Parlamenti mund të kontrollojë veprimtarinë e gjykatave.
- Në rast se një ligj i miratuar nga Kuvendi konstatohet si antikushitetues, Gjykata Kushtetuese ka të drejtë të gjykojë mbi kushtetueshmërinë e tij.
- Pushteti legjislativ dhe ai gjyqësor janë të pavarur nga njëri-tjetri. Asnjë prej tyre nuk mund të ushtrojë kontroll mbi tjetrin.
- Anëtarët e Gjykatës së Lartë në Republikën e Shqipërisë emërohen me pëlqimin e Kuvendit, por kjo nuk do të thotë që gjatë ushtrimit të funksionit të tyre, këto gjyqtarë do të marrin udhëzime apo do të kontrollohen nga Kuvendi. Pasi emërohet në detyrë, gjyqtari kryen një funksion të pavarur. Asnjë nga pushtetet e tjera nuk mund të ketë kontroll mbi veprimtarinë e gjykatave.

Nxënësi fiton:
3 pikë Nëse shkruan tre elemente;
OSE
2 pikë Nëse shkruan dy elemente;
1 pikë Nëse shkruan një element;
0 pikë Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.

Pyetja 13 **3 pikë**

Pikaja masive e popullsisë që shoqërohet me:

- pakësimin e fuqisë punëtore në tregun e punës;
- ritjen shpenzimeve për pensionet/kujdesit për të moshuarit;
- pakësimin e numrit të nxënësve/ fondeve publike;
- ritjen e shpenzimeve për shëndetësinë, etj.

Nxënësi fiton:
3 pikë Nëse shkruan tre pasoja;
OSE
2 pikë Nëse shkruan dy pasoja;
1 pikë Nëse shkruan një pasojë;
0 pikë Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.

Pyetja 14 **3 pikë**

- njohja/ respektimi/zbatimi i rregullores së shkollës;
- përmbyshja e detyrimeve ndaj shkollës;
- pajjsja me mjete shkollore të domosdoshme për orën e mësimi;
- respektimi orarit;
- frequentimi i rregullt i procesit mësimor;
- përgjegjësia për mirëmbajtjen e mjediseve dhe mjeteve shkollore;
- respektimi i figurës së mësuesit/personelit shkollor;
- respektimi i nxënësve të tjerë, etj.

Nxënësi fiton:
3 pikë Nëse shkruan tri përgjegjësi;
OSE
2 pikë Nëse shkruan dy përgjegjësi;
1 pikë Nëse shkruan një përgjegjësi;
0 pikë Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.

2 23 Qershor 2017

Qytetari (faqe 2)

Skema e vlerësimit të testit Qytetari

Pyetja 15 **3 pikë**

- Parimi i kujdesit është marrja e vendimeve dhe e veprimeve të nevojshme për të pakësuar rrezikun mjedisor, për të parandaluar dhe pakësuar në kohën e duhur çdo dëmtim të ardhshëm të mjedisit.
- "Parimi i parandalimit" është përzgjedhja dhe miratimi i variantit më të mirë, që në fazën fillestare të vendimmarrjes, për të shmangur ndikimet e dëmshme të një veprimtarie në mjedis.
- "Parimi i riaftësisimit" është domosdoshmëria për të riparuar dëmet mjedisore të shkaktuara nga vetë personat fizikë e juridikë dhe për të përtëritur dhe riaftësuar mjedisin e dëmtuar.
- Parimi "Ndalësi paguan?" nënkupton koston që paguan ndalësi për përmirësimin e një mjedisi të ndotur dhe për kthimin e tij në një gjendje të pranueshme.

Nxënësi fiton:
3 pikë Nëse shkruan domethënie të tre parimeve;
OSE
2 pikë Nëse shkruan domethënie të dy parimeve;
1 pikë Nëse shkruan domethënie të një parimi;
0 pikë Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.

Pyetja 16 **3 pikë**

a) Një gjendje e mirëqenies fizike, mendore dhe shoqërore, në të cilën individi mund të përballojë sëmundjen, dhimbjen apo paafësinë.

b)

- E drejta për të gëzuar shëndet është një e drejtë e çdo individi pasi përbën një ndër të drejtat themelore të njeriut. Kjo e drejtë është e garantuar dhe e mbrojtur nga Kushtetuta e vendit tonë si dhe nga akte të tjera ndërkombëtare të cilat mbrojnë të drejtat e njeriut. Për shkak të rëndësisë që përfaqëson kjo e drejtë, sipas ligjit shteti është i detyruar që nëpërmjet organeve të tij dhe akteve ligjore që ai mirret, të sigurojë mbrojtjen e shëndetit të çdo qytetari.
- Çdo qytetar ka të drejtën të përfitojë nga sigurimet shëndetësore dhe kësaj të drejte i përgjigjet detyrimi që ka shteti për ta garantuar atë. Një nga mënyrat si shteti garanton të drejtën e qytetarëve për shëndet, është nëpërmjet sigurimeve shëndetësore, e cila mundëson një përkujdesje për shëndetin.
- Shteti mbrojt të drejtën e shëndetit të qytetarëve nëpërmjet detyrimit për të ofruar të shërbim shëndetësor falas.

Nxënësi fiton:
3 pikë Nëse shkruan saktë përkufizimin dhe dy aspekte nga mbrojtja **OSE**
2 pikë Nëse shkruan saktë përkufizimin dhe një aspekt nga mbrojtja
1 pikë Nëse shkruan saktë dy aspekte nga mbrojtja;
0 pikë Nëse shkruan përkufizimin;
1 pikë Nëse shkruan një aspekt nga mbrojtja;
0 pikë Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.

Pyetja 17 **3 pikë**

- Informacion mbi ushqimin e shëndetshëm. (Duhet të jemi të informuar për ushqimet që na bëjnë mirë dhe për ato që janë të dëmshme.
- Kontrolli i cilësisë së ushqimit. (Është shumë e rëndësishme që të përzgjedhim ushqimet më të shëndetshme për organizmin tonë. Këtë duhet ta bëjmë pavarësisht planeve të momentit për t'u dobësuar apo shëndoshur. Është e nevojshme të konsumojmë një shumëllojshmëri ushqimesh çdo ditë, për të siguruar maksimumin e lëndëve ushqyese.)
- Kontrolli i sasisë së ushqimit që konsumohet. (Është e rëndësishme të kontrollohet sasia e ushqimit që konsumohet gjatë ditës. Organizmi i njeriut ka nevojë për të gjitha llojet e ushqimeve; e rëndësishme është të mbahet nga kontrolli sasia e konsumuar për të parandaluar problemet me shëndetin.)
- Ruajtja e intervaleve kohore midis vaktëve që konsumohen. (Specialistët rekomandojnë që të konsumohet ushqim disa herë gjatë ditës dhe në sasi të vogla, në mënyrë që organizmi të jetë në kushte pune gjatë ditës. Kjo gjithashtu, parandalon krijimin e ndjenjës së urisë, e cila do të sillte konsumimin e sasive të mëdha të ushqimit.)

3 23 Qershor 2017

Qytetari (faqe 3)

Skema e vlerësimit të testit Qytetari

Nxënësi fiton:
3 pikë Nëse shkruan tre prej pikave të mësipërme;
2 pikë Nëse shkruan dy prej pikave të mësipërme;
1 pikë Nëse shkruan një moment pikave të mësipërme;
0 pikë Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.

Pyetja 18 **3 pikë**

- sinjale të përparësisë/ me forma(njytira) të ndryshme;
- sinjale të ndalimit/ forma rrethore me kontur të kuq, me sfond të bardhë;
- sinjale të detyrimit/ të ndalimit/ forma rrethore me kontur të kuq, me sfond blu;

Shënim: Nxënësi merr pikë edhe nëse shprehet me nga një shembull për secilin kërkës.

Nxënësi fiton:
3 pikë Nëse shkruan saktë të tre sinjalet e kërkuara;
OSE
2 pikë Nëse shkruan saktë dy nga sinjalet e kërkuara;
1 pikë Nëse shkruan saktë një nga sinjalet e kërkuara;
0 pikë Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.

Pyetja 19 **3 pikë**

- e drejta për dëmshpërblim;
- e drejta e edukimit;
- e drejta e marrjes së informacionit;
- e drejta e përdorimit të shërbimeve publike;
- e drejta e mbrojtjes ligjore;
- e drejta e organizimit në shoqata ose bashkime për mbrojtjen e interesave të konsumatorëve/ e drejta e përfaqësimit në organet vendimmarrëse.

Nxënësi fiton:
3 pikë Nëse shkruan tri nga të drejtat e kërkuara;
OSE
2 pikë Nëse shkruan dy nga të drejtat e kërkuara;
1 pikë Nëse shkruan një nga të drejtat e kërkuara;
0 pikë Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.

Pyetja 20 **3 pikë**

- lidhja e saj me politika të caktuara ndaj imigrantëve;
- mungesa e profesionalizmit të gazetarëve;
- paragjykimi i vetë medias për besimin mysliman;
- nxitja nga qarqe dashakeqëse ndaj besimit mysliman;
- interesat e biznesit të medias, etj.

Nxënësi fiton:
3 pikë Nëse shkruan tri nga arsyet;
OSE
2 pikë Nëse shkruan dy nga arsyet;
1 pikë Nëse shkruan një nga arsyet;
0 pikë Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.

4 23 Qershor 2017

Qytetari (faqe 4)

REPUBLIKA E SHQIPËRIË
MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SPORTIT
QENDRA E SHËRBIMEVE ARSIMORE

PROVIMI ME ZGJEDHJE I MATURËS SHTETËRORE 2017

SKEMA E VLERËSIMIT TË TESTIT

Lënda: Sociologji
Udhëzime të përgjithshme

- Testi përban në total 40 pikë.
- Testi ka 20 pyetje: 10 me zgjedhje dhe 10 me zhvillim.
- Për pyetjet me zgjedhje përgjigja e saktë vlerësohet me një pikë.
- Për pyetjet me zhvillim janë dhënë modele përgjigjesh të sakta.

Pyetjet me zgjedhje

Numri i Pyetjes	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
Përgjigja e saktë Varianti A	A	C	B	D	C	A	A	A	B	B
Përgjigja e saktë Varianti B	A	A	A	B	B	A	A	C	B	D

Pyetjet me zhvillim

- Në skemën e vlerësimit të testit, për pyetjet me zhvillim janë dhënë modele përgjigjesh të sakta. Nxënësi do të marrë pikët e merituar edhe nëse ai ka dhënë përgjigje me fjalë të tjera, por që janë brenda kontekstit të përgjigjes së saktë dhe që komisioni i vlerësimit e gjykon të tillë.
- Në pyetjet me zhvillim, ku kërkohen dy, tre apo katër nga të gjitha përgjigjet e sakta të mundshme, në rast se nxënësi ka dhënë sa përgjigje të sakta sa i kërkohen nga pyetja, atëherë atij do t'i jepen të gjitha pikët maksimale me të cilat është vlerësuar pyetja.
- Nxënësi do të marrë sa pikë sa është vlerësuar pyetja edhe në rast se ai ka dhënë më shumë përgjigje të sakta nga sa i kërkohen.
- Nxënësi merr pikë duke dhënë përgjigje sipas formimit të tij edhe nga lëndët e tjera. Kalimi nga njëra pikë e një problemi të tjetra, nuk e ndëshkon në pikëzim.

Pyetja 11 **2 pikë**

a) Njerëzit janë qenie që ndiejnë dhe mendojnë/sjelljet (ngjarjet) shoqërore janë shumë komplekse/në rrethana (kohë) të ndryshme ato kanë pasojë të ndryshme;

b) Është i kufizuar/për të njohur rregullat e funksionimit të dukurive shoqërore - ato nuk ndihmojnë drejtpërdrejt/ndihmojnë tërthorazi/nëse ka shirimin e një ngjarjeje, mund të reflektojë më thellë rreth përmbajtjes së saj.

Nxënësi fiton:
2 pikë Nëse shpjegon dy veçori;
OSE
1 pikë Nëse shpjegon një veçori;
0 pikë Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.

1 23 Qershor 2017

Psikologji (faqe 1)

Skema e vlerësimit të testit Sociologji

Pyetja 12 **2 pikë**

- respekt dhe nderim i veçantë për mikun/në mungesë të nëpunësve të organeve shtetërore, miku kryente funksione shoqërore të rëndësishme:
- në fejesa/martesa të të rinjve;
- në zbutje/kapërcim të konflikteve/falje gjaku;
- për burim informacioni;
- këshillues për vendime të rëndësishme;
- zgjidhja e bashkëjetesës/mbijetesës në bashkësitë fshatare vetëqeverisëse;
- organizator në veprimtaritë të përbashkëta, si ndërtim urash/lutje kundër pushtuesve, etj.

Nxënësi fiton:
2 pikë Nëse shkruan dy lloje të ndikimit;
OSE
1 pikë Nëse shkruan një lloj ndikimit;
0 pikë Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.

Pyetja 13 **4 pikë**

- Shtresëzimi shoqëror vazhdon gjatë disa brezave;
- Përgjithësisht njerëzit trashëgojnë disa karakteristika të pozitës shoqërore nga prindërit dhe ua përcjellin fëmijëve;
- Karakteristikat e klasës shoqërore trashëgohen së paku deri kur fillon punë;
- Levizshmëria shoqërore, si ndryshim i pozitës shoqërore brenda një sistemi shtresëzimi shoqëror, qoftë nga shtresat e ulëta në shtresat më të larta, qoftë nga shtresat më të larta në shtresat më të ulëta;
- Të gjitha shoqëritë kanë shtresëzim, pavarësisht nga shkalla e zhvillimit;
- Shoqëria garanton shtresëzimin.

Nxënësi fiton:
4 pikë Nëse shkruan katër aspekte nga kohështrirja e shtresëzimi shoqëror;
OSE
3 pikë Nëse shkruan tre aspekte nga kohështrirja e shtresëzimi shoqëror;
2 pikë Nëse shkruan dy aspekte nga kohështrirja e shtresëzimi shoqëror;
1 pikë Nëse shkruan një aspekt nga kohështrirja e shtresëzimi shoqëror;
0 pikë Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.

Pyetja 14 **4 pikë**

a) Pasi një person etiketohet si devijues, ky karakterizim bëhet pjesë e vetëpërciptimit, e identitetit të tij. Në përgjigje ndaj një imazhi të tillë, ai mund të kryejë sjellje të tjera deviante. Kjo është deviancë dytësore. Realizimi i saj shënon fillimin e karrierës deviante. Njerëzit fiten në rrugën e karrierës deviante pasi atyre u është ngjitur një nofkë përcësuese.

b) Është etiketim shoqëror negativ/ndryshon rëndësisht vetëkonceptimin e një personi (identitetin shoqëror të tij)/vë në dukje një të metë të personit që i adresohet/ shpërfill shumë cilësi pozitive të personalitetit të personit të cilit i adresohet/ sajohet nga të tjerët.

Shënim: nxënësi merr një prej pikëve edhe duke dhënë një shembull.

Nxënësi fiton:
4 pikë Nëse arsyeton saktë plotësisht sa në sipër për kërkesën a) dhe b);
OSE
3 pikë Nëse arsyeton saktë plotësisht për kërkesën a) dhe b);
2 pikë Nëse arsyeton pjesërisht për kërkesën a) dhe b);
1 pikë Nëse arsyeton pjesërisht për njërin kërkesë;
0 pikë Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.

2 23 Qershor 2017

Psikologji (faqe 2)

Skema e vlerësimit të testit Sociologji

Pyetja 15 **3 pikë**

- Është faza e tretë e zhvillimit të familjes;
- grup i vogël personash (1-5 anëtarë);
- ndikohet pak/aspak nga lidhjet fisnore;
- është rritur pesha specifike e saj;
- anëtarët janë shumë të lidhur emocionalisht me njëri-tjetrin;
- ndjenja e dashurisë luan rolin vendimtar në përzgjedhjen e partnerëve.

Nxënësi fiton:
3 pikë Nëse shkruan tre tipare;
OSE
2 pikë Nëse shkruan dy tipare;
1 pikë Nëse shkruan një tipar;
0 pikë Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.

Pyetja 16. **2 pikë**

- është procesi nëpërmjet të cilit anëtarët e pakicave ndryshojnë mënyrën e tyre të jetesës për t'u përshatuar modeleve të kulturës sunduese të shoqërisë;
- njerëzit ndryshojnë emrin dhe mbiemrin e tyre/mënyrën e veshjes/vlerat dhe normat kulturore/gjuhën/fenë, etj;
- ka edhe përshatje ndaj kulturës (grupit) sunduese;

Nxënësi fiton:
2 pikë Nëse shkruan dy aspekte;
OSE
1 pikë Nëse shkruan një aspekt;
0 pikë Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.

Pyetja 17 **3 pikë**

a) perënditë/ personazhet kryesore përfytyrohen si meshkuj;
b) anëtarësia është më shumë meshkuj;
c) në pjesën më të madhe drejtuesit janë meshkuj.

Nxënësi fiton:
3 pikë Nëse shkruan tre nga të mësipërmet;
OSE
2 pikë Nëse shkruan dy nga të mësipërmet;
1 pikë Nëse shkruan një nga të mësipërmet;
0 pikë Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.

Pyetja 18 **4 pikë**

- përzjerja e madhe e popullsisë me përkatësi racore dhe etnike të ndryshme;
- ndojta e madhe mjedisore;
- ritja e kriminalitetit;
- mungesa e sipërfaqeve të gjera për ndërtimin e shtëpije të mëdha.

Nxënësi fiton:
4 pikë Nëse shkruan katër faktorë;
OSE
3 pikë Nëse shkruan tre faktorë;
2 pikë Nëse shkruan dy faktorë;
1 pikë Nëse shkruan një faktor;
0 pikë Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.

3 23 Qershor 2017

Psikologji (faqe 3)

Trukimet, Skënderbeut i hiqet titulli, gjobë dhe zbritje pikësh

Zyrtarisht ekipi i Skënderbeut shpallet fajtor për trukimin e disa ndeshjeve dhe i hiqet titulli kampion për edicionin e kaluar, ndërsa këtë edicion i zbriten 12 pikë në renditje. Komisioni i Etikës në FSHF pas disa muajsh hetime ka vendosur që përpos heqjes së titullit edicionin e kaluar dhe zbritjes së pikëve këtë edicion, Skënderbeu të dënohet edhe me 2 mln lekë gjobë. Skënderbeu me heqjen e 12 pikëve këtë edicion nuk rrezikon zbritjen nga Kategoria, por as pjesëmarrjen në Europë duke i shpëtuar një ndëshkimi më të rëndë, që mund ta zbriste nga Superiorja. Pas zbritjes së 12 pikëve, Skënderbeu e mbyll sezonin në kuotën e 60 pikëve, duke mos e rrezikuar vendin e tretë në klasifikim, pasi Luftëtari i vendit të katërt ka 44 pikë. Kështu Skënderbeu do të luajë në Europa League përballë ekipit nga Andora. Skënderbeu u dënua, pasi akuzohet nga Komisioni i Etikës në FSHF për trukimin e disa ndeshjeve brenda vendit, por edhe në Europë.

PARTIZANI KAMPIONI I SEZONIT TË KALUAR

Me vendim e djeshëm të Etikës, Partizani është kampion i Shqipërisë për edicionin e kaluar, thjesht i duhet të presë zyrtarizimin nga ana e FSHF-së. Sipas rregullores vendimi i takon Komisionit të Disiplinës pranë FSHF-së, Edicioni 2015-16 ishte mjaft i luftuar mes dy ekipeve brenda fushe, por edhe jashtë tij me deklarata të forta nga ekipi i Partizanit për trukim. Kujtojmë se UEFA e përjashtoi edicionin e kaluar Skënderbeun nga Champions League ishte e qartë që nuk e njihnin si kampion të Shqipërisë. Partizanin e zëvendësoi Skënderbeu edicionin e kaluar. FSHF-së i është dashur më shumë se një vit kohë për të analizuar raportet e dërguara nga UEFA për ta shpallur fajtor ekipin e Skënderbeut.

MERKATO

Chelsea, 115 milionë euro për Bonuçi e Alex Sandro

Antonio Conte kërkon të bëjë pazar te Juventus. Sipas tabloidit britanik "The Sun", trajneri i Bluve të Londrës ka vënë në shënjestrën e tij mbrojtësit Leonardo Bonuçi dhe Alex Sandro, për të cilët kampionët e Anglisë janë gati të ofrojnë 115 milionë euro. Leonardo Bonuçi prej kohësh është vënë në krye të listës së dëshirave të trajnerit Antonio Conte, i cili është gati të bëjë gjithçka ka në dorë për t'ia rrëmbyer atë Juventusit. Futbollisti nga ana e tij ditët e fundit nuk ka bërë gjë tjetër veçse nëpër media të ndryshme ka mohuar zërat që flisnin për përçarje në skuadër si dhe një largim të mundshëm të tij nga Torino. Por, kjo nuk e ka frenuar aspak interesimin e Chelsea, që në fakt i ka dyfishuar përpjekjet e tij duke kërkuar edhe Alex Sandron. Juventusit në të

Reagon klubi korçar: Do ta ankimojmë në CAS. Titulli kampion i sezonit të kaluar pritet t'i kalojë Partizanit



Ekipi i skënderbeut duke festuar titullin në vitin 2016

DREJTORI I PARTIZANIT: TË PASTROHET KAMPIONATI NGA TRUKIMET

Në një lidhje telefonike për Report Tv, drejtori i klubit të Partizanit, Genc Tomorri shprehet se me vendimin e FSHF, ekipi i kuq është edhe zyrtarisht kampion, pavarësisht se UEFA e kishte njohur që edicionin e kaluar, pasi zëvendësoi Skënderbeun në Champions League. "Kjo ka qenë që vjet që morëm pjesë në Champions League, tregonte se UEFA na njihnte si kampion, kjo ishte masë e FSHF. Vendimi pa dyshim është detyrë e FSHF për të dhënë masa të tjera. Bashkëpunimi mes UEFA dhe FSHF duhet të jetë, pasi UEFA na njohu kampion, sot e bëri edhe

FSHF. Kjo është gjë e mirë, për të pastruar futbollin shqiptar. Të gjitha ekipet duhet të mendohen mirë tani, pasi do të ketë drejtësi për të marrë atë që i takon. Ky është rasti i parë si nga UEFA dhe FSHF, pasi kampionati duhet të jetë i pastër, për të mos pasur më kontestime, secili duhet të marrë atë që i takon" tha ai.

SKËNDERBEU: VENDIMIN E ANKIMOJMË NË CAS

Klubi i Futbollit "Skënderbeu" reagon ashpër kundër vendimit të Komisionit të Etikës në FSHF, që i hoqi atyre titullin kampion të vitit të klauar. Zyrtarët e Skënderbeut paralajmërojnë ankimin e këtij vendimi në Gjykatën e Arbitrazhit

Sportiv (CAS). Në deklaratën e shpërndarë për mediat, ata theksojnë se dënimi është bërë pa prova. Klubi i Futbollit "Skënderbeu" bën me dije tifozërinë Korçare dhe opinionin sportiv se, menjëherë pas vendimmarrjes së Komisionit të Etikës të FSHF, është kërkuar zyrtarisht argumentimi i vendimit, si hapi procedural paraprak për ankimin në Gjykatën e Arbitrazhit Sportiv (CAS-TAS). Vendimi i ditës së sotme nga ky pseudo-organ juridik është një akt i paprecedent, i denjë për katedrat e universiteteve të drejtësisë. Vetëm një organ i FSHF mund të transformonte një vendim administrativ në një vendim disiplinor, pa pasur qoftë edhe një

provë të vetme të drejtpërdrejtë apo indirekte mbi të akuzuarin. Vetëm një organ i FSHF mund të procedonte ndaj një subjekti pa i komunikuar atij akuzën, provat mbi të cilat ajo mbështetej apo subjektin akuzues. Vetëm Komisioni i Etikës i Federatës Shqiptare të Krimit në Sportin e Futbollit mund të jepte një vendim ku vërtetësia e fakteve nuk ka asnjë relevancë. Klubi i Futbollit "Skënderbeu" siguron tifozërinë Korçare se ky cënim dhe kërcënim që na është bërë sot nga ana e Komisionit të Etikës, veçanërisht me heqjen e një titulli kampion të cilën vetë UEFA e ka konsideruar mëse të merituar, do të ankimohet në çdo gjërmë të tij, pasi jemi të sigurt në pafajësinë tonë të pakundërshtueshme".

AGOSTINELLI DO TITULLIN VAKANT PËR PARTIZANIN

Sezonin 2015-2016 e mbylli i emocionuar mes thirjeve të tifozëve të Partizanit ju jeni kampionë. Andrea Agostinelli e konsideroi veten kampion moral në drejtimin e të kuqeve ku luftoi deri në javën e fundit për trofeun që atë kohë shkoi për Skënderbeun ku do të shkonte pas asaj vere. Tani pas vendimit të Etikës, trajneri italian e mirëpret mundësinë që ai titull ti jepet Partizanit. "Të fitoja titullin do të ishte dicka e rëndësishme, tani pres zyrtarizimin. Natyrisht që ndihem i kënaqur pasi ne që jemi në këtë zana punojmë për tu vlerësuar, dhe nëse do të fitoja këtë titull do të ishte dicka e rëndësishme". Agostinelli në përfundim të atij sezoni deklaronte se Partizani e meritonte atë titull dhe sot përgjigjet në këtë mënyrë nëse e ndien se ju është marrë në mënyrë të padrejtë nga Skënderbeu. "Kam thënë se atë vit meritoni të fitoni kampionatin, atë e kam thënë dhe e përsëris, por për fat të keq arriti i pari Skënderbeu. Pastaj nëse kishte parregullsi nuk është detyra ime ta verifikoj, por them se atë vit për një mijë motive meritoni të fitoni titullin. Tani pres zyrtarizimin pasi për karrierën e një profesionisti të fitosh është e rëndësishme".



Leonardo Bonuçi

vërtetë e ka refuzuar një ofertë për brazilianin që kapte shifrën e 60 milionë eurove, por nëse Sandro do të kërkojë largimin nga skuadra, atëherë klubi torinez nuk do ta pengojë atë të shkojë diku tjetër.

PORTIERI

Donnarumma, rinovimi me Milanin mundësi konkrete

Pasi i tha jo rinovimit të kontratës me Milanin, Gianluigi Donnarumma është gati të bëjë prapakthehu. Portieri i talentuar dhe klubi kuqezi po afrohen sërish pak nga pak. Për këtë ka mjaftuar vizita e trajnerit Vincenzo Montella te familja e Donnarummës, me këtë të fundit që duket se ka ndryshuar mendim dhe në ditët e ardhshme mund të rinovojë zyrtarisht kontratën e tij me 7-herë kampionët e Europës për të dhënë fund kësaj torture dhe për të bërë sërish të lumtur tifozët kuqezinj. Pas përfundimit të Europianit të 21-vjeçarëve ku Donnarumma është i im-

penjuar me përfaqësuesen italiane, ai do të marrë vendimin përfundimtar se çfarë do të bëjë me të ardhmen por gjasat më të mëdha tashmë janë që 18-vjeçari të qëndrojë te Milani. Sinjali i parë për qetësimin e gjakrave mes palëve e ka dhënë vetëm klubi kuqezi që ka ulur interesimin për të kërkuar një portier të ri. Vizita e trajnerit Montella te familja e futbollistit ka patur ndikimin e saj, pasi Gianluigi Donnarumma është më afër Milanit dhe shumë shpejt mund të zgjasë marrëveshjen e tij me klubin e cila skadon në verën e vitit 2018.



MUHARREM NEZIRI
TIRANE

Kalaja e Micojit, me emrin Kalaja e Re në Dukagjin, ndodhet në veriperëndim të qytetit të Fushë-Arrëzit, rreth tri kilometra sipër tij. Është ndërtuar nga pushtuesit turq rreth vitit 1547 për të ruajtur kalimin kolonave ushtarake e tregtare nga Prizreni për në Shkodër.

Është fakt se popujt e Dukagjinit kanë pasur shtrirje në anën e majtë të Drinit nga Spasi në lindje e deri në Vat ë Dejës në Përëndim, duke përfshirë Pukën e sotme, Mirditën deri në Mat. Edhe pse pushtimi turk ishte kryer që më 1502, kjo krahinë asnjëherë nuk është nënshtruar. Ka bërë herë pas here kryengritje kundër pushtuesve: u dilnin në rrugë, i vrisnin e nuk i linin asnjëherë të qetë...

Sipas dokumentave osmane e disa shkrime, flitet se kryengritjet kanë qenë njëra-pas tjetrës. Më e rëndësishme është ajo e vitit 1565, në të cilën pjesëmarrja ka qenë shumë e gjerë nga Puka, Fani, Iballja, Spasi, Mali i Zi (sot me Kuksin) e tj.

Frang Bardhi, duke i përshkruar njerëzit e kësaj zone shkruan: "Vendet ku banojnë këta i kanë shumë të forta e shumë të ashpra; kështu edhe ata janë shumë të fortë e prej natyre shumë të shpejtë, fluturojnë nëpër male e nëpër shkëmbinj, sit ë qenëkëshin kaproj, e durojnë urinë, etjen, të ftohtit, të nxehtit dhe të gjitha vuajtjet. Nën zotërimin e turkut në Europë nuk gjenden as nuk janë gjetë gjind (njerëz) si këta që kaq rrënim t' u kenë sjellë turqeve, se sa këta popujt e Dukagjinit, dhe prandaj në Europë nuk gjenden burra armësh më të mirë se këta kundër turkut, sepse 100 kësishvlejnë sa njëmijë turq, ose shqiptarë të fushës. Dhe jo fshehtas, ose së lkargu me zjarr, por ballë për ballë dhe shpatë për shpatë, një i vetëm shkon me guxim e futet në mes 15-20 vetëve, gjë e pa besueshme për ato që nuk e dinë me siguri". Dhe vazhdon: "Bardhetasit janë në punë armësh më të zotët e të gjithë Pukë". Kjo vlen për të treguar se prej këndeje kanë dalë udhëheqës me rëndësi të kryengritjes. "Asnjë komb në Europë që gjindet nën këmbë të turkut nuk mund të flaës me zyrtarët turq me armë në brez e në dorë ashtu si flasin me guxim e ndejun Dukagjinasi dhe popujt e Shqipërisë malore. Pushtuesit, pikërisht, duke e vlerësuar si shumë të rrezikshme këtë zonë, në thellësi të saj, aty në fshatin Vilë (Micoji i sotëm), ndërtuan një kala që të shërbente për sigurinë e Udhës së Madhe nga ku kalohej për në Shkodër dhe anasjelltas.


Kalaja është vendosur në maje të një kodre në lartësinë 750 metra mbi nivelin e detit. Ka pjerrësi dhe

vështirësi për të dalë ku ajo ishte ndërtuar. Sipërfaqja brenda mureve është 3600 m². Muret kanë qenë të gjitha prej guri, sjellë nga lumi i fshatit e nga shpatet e maleve

për rreth. Sot janë vetëm themelet. Në anën verilindore ka pasur rrëshqitje dhe për këtë shkak nuk ekzistojnë themelet. Nga ana perëndimore është një qafë nga ku

mund të dilje në hyrje të kalasë. Aty ka qenë edhe një kullë që shërbente për vrojtim. Kjo ka ekzistuar deri më 1950. Ngjitur me të ka qenë porta e hyrjes. Sipas Frang Bardhit


aty kishte edhe shtëpi banimi. Prej kalasë kontrollohej me sy gjithë zona nga Kryeziu e Qafa e Malit, Bardheti, Lumardhi, Fushë-Arrëzi, Bicaj, Bregu, deri në Rrape. Maja



HISTORIA

KALAJA E MICOJIT OSE QYTETJA E RE E DUKAGJINIT

Historia e veçantë e kalasë së ndërtuar nga pushtuesit turq rreth vitit 1547 për të ruajtur kalimin kolonave ushtarake e tregtare nga Prizreni për në Shkodër...



thellë në male në drejtim të veriut (Iballe, Berishë). Tokat e shpopulluara prej Qafë-Malit, Kryeziut e Lumardhit iu dhanë shpërblim për shërbim zotërive Kabashas që u bënë pronarë e u vendosën në Kryezi, ndërsa Fushë-Arsi, Bregu e deri në Shkozë iu dha zotërive të Pukës. Fillimisht në këto toka erdhën banorë si çipçi e më vonë u bënë pronarë.

Bardhi shkruan se kalaja rrethohet nga kroje të freskët. Edhe sot rreth kësaj kodre ku ka qenë kalaja janë disa kroje me ujë shumë të ftoftë që quhen: Kroni i Marvatës, Kroni i Arrës, Kroni i Fetah Hyseës, Kroni i Gdhënit, Kroni i Osman Hasanit, Kroni i Musajve. Rreth kalasë edhe sot ekzistojnë toponime, si, Suka e Kalasë, Suki i Marvatës, Qafa e qytetës, Arat e qytetës, Kroni i qytetës. Në të folurën e vendasve ruhen shprehjet: "MOs e preknë kalanë se vranësohet moti e ju vret rrufeja", "se në rrënojat e saj ka para të fshehura e tj.

Për kalanë e Micoit kanë shkruan studiuesit Kolë Luka, Kahrreman Ulqini, Xhemal Meçi. Studiuesi Jaho Braha ka bërë disa gërmime. Unë në një session shkencor për kalatë që është mbajtur më 1982 kam kumtuar për këtë kala. Po në vitin 1982 i kam dërguar një letër Institutit të Historisë dhe të Monumenteve dhe kanë ardhur nga Tirana Profesor Apollon Baçe dhe studiuesi Lazër Papajani. Kanë gjetur dhe marrë disa fragmente poçerie gjë që tregon se kalaja ka qenë e banueshme. Nga Tirana njoftuan se Kalaj e Micoit është shpallur Monument Kulture.

Inxhinieri arkitekt Seit Cufaj dhe topografi Agim Hyseni nga fshati Micoi kanë bërë punë shumë serioze për rivelimin e kalasë. Një kopje të këtij punimi i bashkëngjitet këtij shkrimi.

Është me rëndësi që studiuesit të thellohen edhe më në njohjen e kryengritjeve të Dukagjinaseve, të cilët përmendën, por nuk dihet se kush i ka udhëhequr; njëkohësisht të ngrihen ekspedita studimore për kalanë e Fletit për të cilën ka shkruar Gjon Muzaka, për kalanë e Bregu, të Blinishtit, tforcojat e kryeziut, kalanë e Tuçit e tj.

Në këtë vit mbushen 370 vite nga vizita e Frang Bardhit, ipeshkv i Zadrimës, në disa prej fshatrave të rrethit të Pukës. Puna dhe vepra e tij është me vlera të jashtëzakonshme historike, religjioze, etnografike dhe gjuhësore. Populli i kësaj krahine, intelektualët përlulën me respekt para veprës së tij duke çmuar lart emrin dhe dinjitetin e tij. Në Pukë ia vlen të ngrihet një monument dhe t'i jepet titulli "Nderi i Kombit".

LITERATURA:

1. Frang Bardhi. Relacione mbi gjendjen e Shqipërisë Veriore e të Mesme në shekullin e XVII. Vëllimi i dytë f.79-81.
2. Kolë Luka: Etnografia Shqiptare nr. 11, f. 269.
3. "Studime Historike nrf. 2 1981, f172-195.
4. Xhemal Meçi, Kalaj e re e Dukagjinit, dorëshkrim, 1975.
5. Evlia Çelebi. Kronika për kështjellat shqiptare f 167-168.

e Malit të Arsit ka shërbyer si pikë vrojtimi si edhe për të lëshuar kushtimin për të thirrur forcat ushtarake të kalsae.

Bardhi e përshkruan: "Kjo qytezë është ndërtuar në një lugninë të madhe ndër male, në mes të popujve të Dukagjinit, në një vend shumë të bukur dhe me ujëra të ftoftë. Kalaja që ndërtuar prej një turku të fuqishëm, pothuaj sot e 80 vjet më parë, emrin e të cilit nuk mundia ta dijë, pastaj që rrënuar prej mirditasve dhe popujve të tjerë të Dukagjinit... që aso kohe ishin kryengritës kundër turkut, pastaj sot 29 vite (1608) që rindërtuar po prej një turku të atij kombi nga qyteti i Dukagjinit i Prizrendit i quajtur Magaroli, aso kohe sanxhakbe i Dukagjinit. Tash kjo qytezë, në gjuhën shqipe epirotike quhet qutetja e Re ndugagin që don më thënë Qytezja e Re në Dukagjin".

Kryengritja e 1565 pati përmasa të mëdha sa që tronditi edhe përandorin turke. Beu i Dukagjinit u urdhërua që, në bashkëpunim me forcat e sanxhakut të Shkodrës dhe azapët e sanxhakëve të Ohrit dhe të Elbasanit, të shtypte këtë kryengrit-

je. Urdhëri që i prerë për të gjitha këto vise: "Ata, të pagëdhëndurit e fshatrave që nuk do bindëm, t'i shkonin në shpatë, fëmijët e gratë e tyre t'i bëni robër, kurse pasuri e plaçkat t'ua grabisni dhe t'ua prishni krejt". Urdhëri përsëritet edhe një ditë më vonë me këto fjalë: "Për të nxitur ushtrinë në kohën e sulmit, të kapen robërit e fëmijët e tyre, e në se nuk plotësohet si duhet numri i ushtrisë, merrni nga garda ime...". Këto urdhëra dëshmojnë për një kryengritje të madhe të masave popullore. Edhe sot në rrugën që kalon nga Kryeziu në Flet është Kroji i Azapëve; ose në afërsi të Dardhës, Fusha e Azapëve. Këto toponime flasin për vendët ku ishte përqëndruar ushtria turke kundër kryengritësve. Ushtria me të gjitha llojet e armëve të kohës, u turr mbi Bardhetin, ku ishte qendra e Kryengritjes, mbi Arstin, Vilën, Rrapën, Pukën, Qerretin që ishin buza rrugës që të çonte në Shkodër. Përdori të gjitha llojet e dhunës, vrasje deri fëmijët në djep, djegie të shtëpive, shfarosje të popullsisë, marrje skllav. Natyrisht, disa mundën të largohen e të ngjiten

Në fokusin e lexuesit online

[SHQIPTARJA.com]

LAJMET MË TË LEXUARA DJE

- Foto/Berisha e ha "karremin" FRESH-ët e nxjerrin bllof 13900 Lexime
- VD me dron/Edhe Tirana braktis PD, dështon mitingu i Bashës 12175 Lexime
- Financial Times: Meta pengoi Ramën dhe reformën në drejtësi 10425 Lexime
- 'Shullazi', mund të ketë arrestime Beqja zbulon të tjerë kërcënues
- Faltshoret: Njerëz të PD erdhën me makina të blinduara për Bashën
- Berisha ndjek mitingun e PS në Tiranë, ja prova
- Kurti: Nëse qeveris, referendum projekt bashkimi me Shqipërinë
- Buffon e la për gazetaren sportive flet ish-gruaja: Si e mësova tradhëtinë
- I akuzuar për vrasje lirohet me kusht ish drejtori i ALUIZNI-t
- Porositën vrasjen e Artan Cukut në kërkim një fierak e një vlonjat

LAJMET MË TË KOMENTUARA

- Tritol zyrës elektorale të LSI në Durrës. Nuk ka të lënduar/Foto
- Rama: Koalicioni me PD skenar i hapur, përjashtojmë LSI
- Kurti: Nëse qeveris, referendum projekt bashkimi me Shqipërinë
- "Ishallah nuk bie", por e humbi shansin djali i LSI
- Lefter Koka: Vepër e Rilindjes nuk na ndalin zagarët/Video

VIDEOT MË TË KLIKUARA

Ekskluzive/Nëna e Eda Zarit: Vajza më rrahu e më la pa bukë

Frika ime më e madhe..., Rama një rrëfim për Rai.it

Basha: Iki si kryeministër nëse s'hap tunelin e 'Arbrit' për 2 vite

Për të parë videon në smartphonin tuaj skanoni QR CODE me APP të REPORT TV që shkarkohet falas

SONDAZHI IDITES

Duke ndjekur tendencën e sondazheve parazgjedhore, mendoni se janë:

Rezultati i Sondazhit

- Shumë të vërteta 28.16%
- Mesatarisht të vërteta 23.06%
- Jo të vërteta 48.78%

SHËNIM:

Sondazhet online të Shqiptarja.com, nuk kanë vlerë statistikore. Bëhet fjalë për pyetje që u bëhen të gjithëve dhe jo kampionëve të përpunuar në mënyrë shkencore. Pra, kanë si qëllim të vetëm të lejojnë lexuesit të shprehin mendimin e tyre rreth temave të aktualitetit. Megjithatë, çdo lexues, mund të votojë vetëm një herë në ditë



2.613 | 332186
KOMENTET E DJESHME | TOTALI LIKE

Zbutet Britania, nuk do të dëbojë qytetarët e BE

Brukseli vendos për zgjatjen e sanksioneve ndaj Rusisë edhe gjashtë muaj

Duke përshëndetur kompromisin për qytetarët europianë, Merkel u tregua e kujdesshme të sqaronte se ka ende shumë pyetje mbi “Brexit” që presin përgjigje. “Ky është një fillim i mbarë, por dy vite negociatash që na presin përpara do të përfshijnë edhe mjaft çështje të tjera. Më të rëndësishmet e tyre janë paratë që Britania duhet të shlyejë për largimin dhe situata kufitare me Irlandën, gjë që nënkupton se mbetet ende shumë punë për të bërë”, tha Merkel.

Kancelarja këmbënguli sidoqoftë se, shkëputja e Britanisë nga BE-ja nuk ishte fokusi i samitit të Brukselit dhe se negociatat për të janë duke u zhvilluar veçmas.

Theresa May parashitri në Bruksel planin e hartuar për qytetarët e BE-së, i cili i duket një fillim i mirë Kancelares gjermane Angela Merkel.

Shtetasve nga vendet e bllokut, që kanë jetuar për 5 vite në Mbretërinë e Bashkuar, do t’iu ofrohet një status i veçantë, i cili i lejon ata të qëndrojnë e të kenë qasje në shërbimet shëndetësore, ato arsimore, e të përfitojnë edhe shërbime të tjera.

Plani i May prek 3.2 mil-

LONDRA

Shtetasve nga vendet e Bashkimit Evropian, që kanë jetuar për 5 vite në Mbretërinë e Bashkuar, do t’iu ofrohet një status i veçantë, i cili i lejon ata të qëndrojnë e të kenë qasje në shërbimet sociale

ionë qytetarë europianë që jetojnë aktualisht në Britani. Të drejtat e tyre dhe ato të britanikëve të zhvendosur në pjesë të tjera të Bashkimit Evropian përbënin një prej çështjeve më delikate e të vështira të negociatave të

MBROJTJA

BE ka arritur në një marrëveshje për bashkëpunim ushtarak dhe intensifikimin e përpjekjeve kundër luftëtarëve të huaj edhe me bashkëpunimin e kompanive online. Ky konsiderohet si një hap historic

“Brexit”, krahas faturës së lartë të “divorcit” të Londres dhe kufirit me Irlandën e Veriut.

Në takimin e nivelit të lartë, udhëheqësit e Bashkimit Evropian gjetën gjuhën e përbashkët mbi masat e

antiterrorit, që kanë përbërë temën qëndrore të ditës së parë të samitit të krerëve të shteteve të 27 vendeve anëtare të bllokut.

EVROPA

Këshilli European vendosi zgjatjen e sanksioneve ekonomike për Rusinë, me 6 muaj të tjerë. Lajmin e njoftoi në rrjetin social Twitter, presidenti i Këshillit, Donald Tusk, ndërsa samiti i 28 vendeve anëtare po vazhdonte. Kancelarja gjermane Angela Merkel dhe presidenti francez Emanuel Macron, informuan kolegët mbi situatën në Ukrainë dhe implementimin e marrëveshjes së Minskut. Në mungesë të zbatimit të plotë të saj, u vendos zgjatja e sanksioneve.



Theresa May dhe Angela Merkel

Udhëheqësit e 28 vendeve anëtare, arritën në Bruksel një marrëveshje sa i përket luftës kundër terrorizmit ndërkombëtar.

Ujdia parashikon më shumë bashkëpunim ushtarak dhe intensifikimin e përpjekjeve kundër luftëtarëve të huaj edhe me bashkëpunimin e kompanive online. Marrëveshja konsiderohet si një hap historik drejt objektivit të një mbrojtje të përbashkët europiane.

Kancelarja gjermane Angela Merkel vlerësoi progresin e bërë sa i përket bashkëpunimit në fushën e mbrojtjes, në ditën

e parë të samitit dy ditor. “Të gjithë janë në një mendje se krijimi i një strukture të përbashkët mbrojtjeje, nuk është kundër NATO-s, por është plotësuese e aleancës. Megjithatë kjo na jep mundësinë të krijojmë marrëdhënie më të strukturuar në fushën e mbrojtjes, me ato vende që nuk janë anëtare të NATO-s”, tha Merkel.

Edhe presidenti i ri francez Emanuel Macron, në samitin e tij të parë të BE-së, që kur u shpall kreu i Elizësë, i cilësoi historike hapat e vendeve europiane, drejt mbrojtjes së përbashkët.

SHBA/ OBAMA KRITIKA PËR KTHESËN NË SHËNDETËSI

Donald Trump ve në dyshim paanshmërinë e prokurorit special

Edhe pse e ka quajtur atë si një “njeri të nderuar”, presidenti Donald Trump ka ngritur dyshime mbi neutralitetin e Robert Mueller, prokurori special që po heton ndërhyrjen ruse në zgjedhjet presidenciale amerikane të vitit të kaluar. Trump tha se miqësia e Mueller me James Comey, i cili kryesonte hetimin deri në momentin që u shkarkua nga posti i drejtorit të FBI-së, është “e bezdisshme”. I pyetur nga “Fox Neës”, nëse Mueller duhet të tërhiqet gjithashtu, Trump tha se “do të na duhet të presim e të shohim”. Mueller u përcaktua si prokuror special nga Departamenti i Drejtësisë për të udhëhequr hetimin ndaj ndërhyrjes së pretenduar të Rusisë, pas shkarkimit të Comey më 9 maj. Ai nuk ka dhënë detaje mbi hetimin e tij deri më tani, por mediet amerikane kanë raportuar se po e heton Trumpin për pengim të mundshëm të drejtësisë, qoftë në momentin e shkarkimit të James Comey, ashtu edhe për përpjekjen e Trump për t’i dhënë fund hetimit ndaj ish-këshilltarit të tij për Sigurinë Kombëtare, Michael Flynn. Presidenti Trump ka mohuar vazhdimisht bashkëpunimin me Rusinë, duke e quajtur këtë akuzë një “gjueti shtrigash”. E

të njëjtën gjë konfirmoi edhe në intervistën për “Fox & Friends” këtë të premte, kur tha se “nuk ka ekzistuar asnjë pengim dhe asnjë bashkëpunim”. Ai e ka quajtur akuzën për pengim të drejtësisë si “qesharake”. I pyetur nëse Mueller duhet të tërhiqet vet nga hetimi për shkak të miqësisë me Comey, Trump u shpreh se “po, ai është mik i mirë me Comey, e kjo është diçka bezdisëse. Por ai është edhe... na duhet të presim e të shohim”. Më tej, Trump ka theksuar se “njerëzit që janë emëruar për këtë çështje kanë qenë që të gjithë mbështetës të Hillary Clintonit”. Ditën që u

emërua Mueller, Trump thuhet të jetë xhindosur, por prokurori special fitoi shumë shpejt lavdërimet nga republikanët e nga demokratët. Gjithsesi, pak më vonë, disa prej konservatorëve me më shumë ndikim kanë përshkallëzuar sulmet e tyre, duke bërë haptazi thirrje për shkarkimin e Mueller.

OBAMA

Ndërkohë, Barack Obama kritikoi ashpër planin për shëndetësinë që u publikua të enjten nga republikanët në Senat, duke e cilësuar atë si një transfertë masive parash të të pasurit, në kurriz të amerikanëve të varfër

dhe të shtresës së mesme. Në një postim në “Facebook”, pasi propozimi u bë publik, ish-presidenti amerikan bëri disa nga komentet më të forta që kur la detyrën, për të mbrojtur atë që cilësohet si arritja e tij më e madhe në dy mandate. “Projektligji i Senatit nuk është një ligj për shëndetësinë. Fare thjesht, nëse ka një mundësi që të sëmurësh, plakësh apo krijosh një familje, ky ligj të dëmton”, shkruan Obama, duke theksuar se propozimi parashikon ulje taksash për fituesit e mëdhenj, si kompanitë e ilaçeve dhe sigurimeve, ndërsa heq sigurimin për sëmundje të mëparshme,



Donald Trump

shtatzëninë dhe shëndetin mendor. Obama theksoi se ndryshimet estetike nuk e eliminojnë dot keqdashjen e ligjit, ndërsa u kërkoi republikanët që të mos nxiten nga përmbushja e një premtimi të fushatës, por të mendojnë për miliona amerikanë që do të humbasin

sigurimet shëndetësore. Sipas medieve vendase, zyra e Buxhetit të Senatit pritet të shqyrtojë javën e ardhshme këtë ligj, i cili është miratuar në Dhomën e Përfaqësuesve dhe do të lërë 23 milionë amerikanë pa sigurime shëndetësore gjatë 10 viteve të ardhshme.

BLLOKADA/ AKUZA PËR FINANCIM TERRORIZMI SOLLI KRIZË TË RËNDË

Katarit i bëhet ultimatum nga katër vende arabe fqinje



Katër shtete arabe i kanë dërguar Katarit një listë me 13 kërkesat që duhet të përmbushë, nëse dëshiron heqjen e bllokadës. Arabia Saudite, Egjipti, Emiratet e Bashkuara Arabe dhe Bahreini kanë parashtruar një sërë pretendimesh, ndër të cilat edhe atë të mbylljes së “Al Jazeera”-s, rrudhjen e marrëdhënieve me Iranin dhe mbylljen e një baze ush-

tarake turke. Të gjitha këto duhet të ndodhin brenda 10 ditësh. Lista u shpall pasi Sekretari amerikan i Shtetit, Rex Tillerson i nxitu fqinjët e Katarit të dalin me kërkesa të arsyeshme dhe të zbatueshme. Uashingtoni, që po përpiqet të ndërmjetësojë për zgjidhjen e ngërçit, është i pakënaqur me kohën që u është dashur sauditëve dhe vendeve të tjera për të formalizuar pretendimet e

tyre. Situata u përshkallëzua befasisht muajin e kaluar, kur Arabia Saudite, Egjipti, Emiratet e Bashkuara Arabe dhe Bahreini i ndërpreu marrëdhëniet me Dohan e akuzuar prej tyre si financuese e terrorizmit. Mosmarrëveshja e zhyti Katarin në kaos e nxiti krizën më të rëndë diplomatike të Gjirit, që prej luftës së vitit 1991 kundër Irakut. Ky shtet është kritikuar vazhdimisht për mbështetjen

e supozuar të atij që njihet më parë si “Fronti al-Nusra”, i përfshirë aktualisht në luftime me trupat e Bashar al-Assadit në Siri. Prej Katarit kërkohet ndër të tjera të ndërpresë të gjitha lidhjet me “Vëllazërinë Myslimane”, të dorëzohet të gjithë individët e kërkuar për terrorizëm nga të 4 shtetet firmëtare, e të paguajë si kompensim edhe një shumë të papërcaktuar parash.

FJALËKRYQESH

NGA **KADRI VOKOPOLA**



FJALËKRYQI PA SKEMË

DUHET TË NXINI **35** KUTI

	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	14	15	16	17
1																	
2																	
3																	
4																	
5																	
6																	
7																	
8																	
9																	
10																	
11																	
12																	

HORIZONTAL

- Qe mbretëreshë e ostrogotëve.
-Clark Kent
-Festa pa fe
- Të famshme ato të Zenonit.
-... la vista e Petro Markos.
-Satelit i Uranit
- Një repart për veshët
-John që qe fizikan.
- Le Bon i Duran Duran
-Janë të shumta në sport.
- Janë tek në teste.
-Ka shumë reparte për vizita një e tillë.
- Në fund të pritjes.
-Janë ortodoksë të tillë me igumenë.
-Fillojnë aktivitetin
- Skuadra merengue.
-Dashuron Izolden.
-Pak stabilitet.
- Frekuentohen nga shumë pushues në verë.
-Ai dhe ajo
- Qytet në Japonin.
-Vetmi pa kufij
-Njoftohej nga Tellalli
- Predikojnë në sinagoga të tillë.
-Fillojnë tekstin
-Gjysmë morali
-Rajon Urban Lezhw
- Njëllor për latinët.
-Një mund të jetë fetar.
-U vra në banjë nga Charlotte Corday.
-Fund janari
- Qe fallxhor i famshëm
-Janw tw dhenat e makinerisw

VERTIKAL

- Është e kundërt e a priori.

PËRGJIGJE E FJALËKRYQIT PA SKEMË

S	A	G	A	H	E	N	G	K	L	A	U	S	M			
E	N	I	G	M	A	T	I	K	O	A	T	A				
M	A	R	I	A	N	T	E	P	M	P	B	U	S	T		
A	T	L	A	N	T	A	H	I	P	O	K	R	A	S	T	
F	O	L	N	D	S	M	A	N	A	S	T	I	R	E		
O	L	F	A	P	A	P	A	S	T	E	R	T	I	A		
R	E	L	E	M	A	L	A	K	I	A	E	N				
A	M	O	J	I	T	O	R	E	T	E	F					
K	A	T	R	I	N	A	T	I	N	B	A	R				
T	R	A	R	E	O	P	E	R	E	T	A	T	I			
G	J	A	K	T	A	R	I	K	A	T	E	M	O	N		
V	E	T	I	A	R	O	M	A	K	E	T	A	M	A		

- Henrio që qe piktor
-Gjysmë sadist
- Një erë kafeje.
-Shkruajnë nga e djathta në të majtë
- Kujtim që qe kompozitor.
-... Greco që qe piktor
-Räikkönen pilot
- E dashura e Nemorino-s.
-Peter që humbi hijen.
- Tri të parat në sondazh.
-Motel pa çifte.
-Është nusja me vello.
- Union Komëtar Operativ.
-Kush ka... është i kamur.
-Janë në vizë.
- Kufijtë e njohjes.
- Gaetano që qe kompozitor.
- Fillojnë temën.
-I vjetër, antik.
- Fillojnë atletikën.
-Një diellor me yll
- Ushtrohet një me imponim.
-Shahu i fundit
- Charlie i Charlot.
-Thomas i Utopia.
- Është edhe ai i misrit
-Një shtet aziatik.
- Një sezon.
-Alberto Lattuada.
- Kufizojnë takimin
-Oliver regjisor.
- Parashtesë zmadhuuese.
- Film i parë shqiptar.
-Mustafa Kemal...
- Ka privilegjin e jetës.
-Nastase ish-tenist
- Gjysmë taktik.
-Një gjuhë në Afrikë.
- Janë të ftata ato të pritjes.
-Janë ekstreme ato kapitale.
- Qenë gjigantë si Hiperion.
-Institucione Lokale Rùmune.
- Mbyllin akte.
-Polanski regjisor.
-Është top player
- Pinci i Dy herë mat.
-Janë titujt në ekran.
-Mbyllin fushatat

FJALËKRYQI SPORTIV

	1	2	3	4	5	6	7	8	
9	10			11		12			
		13		14	15		16	17	18
		19					20	21	
22		23	24	25					
	26							27	
	28		29		30	31	32	33	
	34		35		36	37		38	
39	40		41		42	43		44	
45									

PËRGJIGJE E FJALËKRYQIT SPORTIV

L	A	L	A	I	N	E	L	A							
I	T	A	P	E	R	S	O	N	A	L	E				
T	E	R	R	E	N	E	T	I	N	A	K	E	N	D	
F	E	R	M	I	P	E	N	E	L	I	A	O	D	E	
I	L	A	T	I	E	M	I	L							
D	I	M	A	R	I	O	I	L							
A	E	L	E	H	T	E	A	S	A						
A	N	T	O	N	I	O	C	O	N	T	E				

HORIZONTAL

- Franka Potente.
- Tare që hidhte diskon.
- Një pjesë e amerikanëve.
- Një Altin ish-mesfushor.
- Mbyllin një koment.
- Skuadra e Los Blancos.
- Janë tipat... tipografikë.
- Fillojnë tokëzimin
- Pret për Bayern Mynih.
- Fillojnë matanë.
- Personazhi në foto.
- Bujari që priste për bardheblutë.
- Në krye të tabelës.
- Gjysmë tetari.
- Kufizojnë takimet.
- Mund të jetë vrastare.
- Mirë në qendër.
- Fillojnë matjet.
- Fabian këngëtare
- Institucione Doganore Lokale.
- Është njeriu që është në rrgull
- Roth aktor.
- Personazhi në foto.
- Pacino aktor.
- Qe skuadra e Sokol Kushtës.
- Janë parakalime ushtarake.
- Skuadra e Erick Thohir.
- Një birrë e jona.
- Iniciale e Einstein.
- Alessandro sulmues italian.
- Një koeficient shahistësh.
- Aktualisht kryesojnë.
- Panik pa ekstreme.
- Është lartësi.
- Rinon pa çifte.
- Zanore për terezzi.
- Dueti kur nuk...di.
- Është edhe ajo mistral.
- Leo te Barça.
- Këndon Dov'ë l'amore.
- Pak latinisht.
- Në krye të armatës.
- Është edhe ai fosbury.
- Rikard Ljarja.
- Juan, mesfushor spanjoll.
- Fillojnë greke.
- Pak monotone.
- Vanessa violiniste.
- Bel i Maupassant.
- Djeg kur nuk je.
- Nick Nolte
- Iniciale e Duras.
- Iniciale e Bunuel.

SUDOKU

PLOTËSONI VENDET BOSH NË MËNYRË QË ÇDO RRESHT E KOLONË TË KETË NUMRAT NGJA 1-9

PËRGJIGJE

3	2	7	1	5	8	9	4	6
6	1	9	4	3	7	5	8	2
5	4	8	9	6	2	7	1	3
1	8	6	5	7	4	3	2	9
4	3	2	6	8	9	1	5	7
9	7	5	3	2	1	4	6	8
7	6	4	2	1	3	8	9	5
8	5	1	7	9	6	2	3	4
2	9	3	8	4	5	6	7	1

1								9
	4		2	6	1			3
	6			5				1
		5	6		3	4		
8	1	4	7		5	3	9	6
		9		1		7		
			9	3	4			
4	8		5	7	2		6	3
3								5

HOROSKOPI

DASHI

Një situatë do t'ju vërë në pritje. Në punë duhet të jeni të saktë dhe të shpejtë. Në dashuri mund t'i besoni pa frikë partnerit/es tuaj. Beqarët do kenë një ditë premtuese dhe plot ngjyra të cilën duhet ta shfrytëzojnë sa të mundin. Nëse buxhetin nuk e menaxhoni me kujdes shumë shpejt do fillojnë problemet.

LUANI

Nuk do zgjoheni me humor shumë të mirë sot ju të dashuruarit, por gjithçka do ndryshojë pas mesdite. Partneri/ja do ju surprizojë dhe do ju mbushë me dhurata fantastike. Beqarët nuk do e kenë të lehtë ta gjejnë princin e tyre të kaltër edhe pse do mundohen shumë. Me shpenzimet duhet të jeni ende të matur.

SHIGJETARI

Do të jeni më kokëfortë se zakonisht për të mbrojtur argumentet tuaja. Në ambientin e punës do të shuani tensionet dhe do të jeni më të pavarur. Beqarët do realizojnë disa takime të papritura, por që sa hap e mbyll sytë do ua ndryshojnë jetën njëherë e mirë. Financat nuk do jenë të këqija, por gjithsesi kujdes me shpenzimet.

DEMI

Do të kuptoni që një person i dashur do t'ju thotë gënjeshtër dhe kjo do t'ju bëjë dyshues tek të gjithë. Në ambientin e punës do të jeni të favorizuar. Juve që jeni në një lidhje nuk do keni asgjë për çfarë të qaheni sot sepse partneri/ja do ju mbajë gjithë kohës në pëllëmbë të dorës.

VIRGJËRESHA

Do të jeni më të egër se zakonisht, kjo sepse ndiheni të sulmuar nga dikush që nuk e prisni. Në dashuri do të jeni pak sipërfaqësorë. Beqarët do bëjnë mirë te tregohen te kujdesshëm dhe te mos bien pre e intrigave te disa personave. Kujdes duhet të tregoni me shëndetin.

BRICJAPI

Do të keni shumë iniciativë. Në punë do të merrni vendimet e duhura dhe nuk do t'ju shfaqen probleme. Në dashuri ambienti do të jetë në favorin tuaj. Partneri/ja do angazhohet që t'ju surprizojë në mbrëmje. Shëndeti do të jetë i mirë, nuk ka arsye për tu shqetësuar.

BINJAKËT

Duhet të bëni kujdes me durimin për të shmangur problemet në aspektin profesional. Në dashuri do të ndjeni frytet e punës. Si ju ashtu edhe ai që keni në krah do dini t'ia bëni qejfin njeri-tjetrit. Beqarët nuk do ndihen ende gati për të hedhur hapa.

PESHORJA

Sot do të bëni një analizë të personave që ju rrethojnë, sidomos të atyre që njihni prej një kohe shumë të gjatë. Ata që janë në çift do mendojnë për ndryshime dhe për çdo gjë do mundoheni te flisni hapur me atë që keni ne krah. Financat do mbeten te kënaqshme sepse gjithmonë do dini çfarë hapash te hidhni.

UJORI

Yjet ju këshillojnë që të bëni kujdes më mënyrën se si komunikoni me një nga eprorët tuaj sot. Në fushën e ndjenjave do të jeni shumë të gatshëm për ndryshime, por beqarët më mirë le të presin edhe pak kohë para se të tentojnë të joshin dikë. Në planin financiar yjet do jenë në anën tuaj.

GAFORRJA

Natyrë e saj ose e tij duket sikur ju ngjall bezdi. Duhet të qartësohet veten. Por do të ndiheni të lumtur në fushën e ndjenjave. Beqarët do realizojnë disa takime interesante dhe për disa persona zemra do ju rrahë më fort se kurrë ndonjëherë. Në planin financiar do keni një ditë të mbushur me surpriza.

AKREPI

Yjet ju këshillojnë që të ruani qetësinë dhe të jeni më mirëkuptues me personat që ju rrethojnë në ambientin e punës, si dhe me njeriun tuaj të zemrës. Veçanërisht në ambientin e punës mbajni sytë hapur për të shmangur armiqësitë. Financat mund të jenë disi delikate. Mundohuni të shpenzoni me kujdes.

PESHQIT

Do të jeni të gatshëm të përballeni me një mikut tuaj. Jepni të gjithë mbështetjen dhe mirëkuptimin tuaj sepse është në një moment shumë të vështirë. Ju të dashuruarit sot do i keni gjërat shumë të qarta dhe për shumë gjëra do e kuptoni se keni vepruar gabim. Mos u druani te flisni hapur me partnerin/en sepse ai do ju kuptojë dhe do ju falë.

PËRGJIGJE

K	E	R	K	E	S	E	E	K	H	S	
A	R	A	M	E	T	A	L	I	K	E	T
T	A	P	E	L	I	K	A	N	I	A	
U	H	E	T	I	M	O	R	E	H	N	
L	U	T	E	N	O	R	E	P	I		
I	A	R	O	L	D	H	O	N	I		
K	R	I	M	O	P	A	L	M			
A	L	E	T	I	G	P	R	I	M	A	
T	E	N	I	S	T	E	K	A	P	O	
R	A	R	R	O	B	E	R	T			
D	I	T	P	A	G	A	N	E	T	O	
U	K	R	A	U	L	I	L	A	P		

SHKRONJA E NJËJTË PËR NUMËR TË NJËJTË

FJALËKRYQI I KRIPTOGRAFUAR

9	D	6	9		3	4	10	1	18	2		4	9
2	I	7	2	5		15		11	2	9	2	15	2
3	K	6	15		4		9	2	8	1	11	4	12
5	U		3	4	7	12	6	8	2	10	4	12	
		3	5	8	12	5	7	1		12	11		7
9	4	12		1	12		18	4	2		4	4	
4	18	2		7	4	17	6	7	12	1	12		
10	1	11		2	12		8	8	1	7	8	12	
4	7	1	10	1			4	1	12		8	5	
1	11	12	4	12		7		15	2		2	9	
	4		12		17	5	15			8	1	6	
4	12	8	4	10	12	8	9	4		5	7	4	



VOTONI!



ËSHTË E DREJTA JUAJ TË ZGJIDHNI!

ZGJEDHJE PËR
KUVENDIN E SHQIPËRISË 25.06.2017

Në vëmendje!

Shkelja e rregullave që garantojnë fshehtësinë e votimit nga ana e zgjedhësit përbën vepër penale dhe dënohet me ligj.

Ofrimi ose dhënia e të hollave apo të mirave materiale, bërja e premtimeve për vende pune ose për favorizime të tjera në cilëndo formë, për të votuar në një mënyrë të caktuar apo për të marrë pjesë ose jo në votime, përbën vepër penale dhe dënohet me burgim nga një vit deri në pesë vjet.

Kërkimi apo pranimi i të hollave, të mirave materiale, ose favorizimeve të tjera për të votuar në një mënyrë të caktuar, apo për të marrë pjesë ose jo në votime, përbën vepër penale dhe dënohet me burgim nga një vit deri në pesë vjet.

Kanosja që i bëhet zgjedhësit për të votuar në një mënyrë të caktuar, apo për të marrë pjesë ose jo në votime, përbën vepër penale dhe dënohet me burgim nga gjashtë muaj deri në tre vjet.

Pengimi i zgjedhësit për të votuar në qendrën e tij të votimit, duke shkelur rregullat e votimit, duke i marrë apo dëmtuar dokumentin e tij të identifikimit, apo në çdo formë tjetër, dënohet me burgim nga një vit deri në pesë vjet.

KUJTESË!

- ! NJË VOTUES - NJË FLETË VOTIMI
- ! NJË VOTUES NË DHOMËN E FSHEHTË
- ! VOTIMI FAMILJAR DHE NË GRUP ËSHTË I KUNDRALIGJSHËM
- ! VOTIMI ME DOKUMENTA IDENTIFIKIMI TË RREMË, VOTIMI PËR PERSONA TË TJERË, APO DUKE PËRDORUR DOKUMENTA TË ZGJEDHËSVE TË TJERË, PËRBËN VEPËR PENALE DHE DËNOHET ME BURGIM NGA NJË DERI NË TRE VJET
- ! DOKUMENTIMI I MËNYRËS SESI KENI VOTUAR, PËRMES FOTOGRAFIMIT, FILMIMIT TË FLETËS SË VOTIMIT DHE SHFAQJA E TYRE TEK PERSONA TË TJERË, PËRBËN VEPËR PENALE DHE DËNOHET ME BURGIM NGA GJASHTË MUJ DERI NË TRE VJET

KUJDES!

NË MJEDISËT E QENDRËS SË VOTIMIT

NUK LEJOHET TË QËNDROJË ASNJË PERSON I ARMATOSUR
NUK LEJOHET PËRDORIMI I CELULARËVE APO PAJISJEVE VIDEO RREGJISTRUESE



Për më shumë informacion vizitoni faqen e internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve:

www.cec.org.al

Informohu dhe raportu përmes celularit shkarko aplikacionin **VOTO 2017**